



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 14.07. 2011**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
14. 07. 2011. GODINE**

**KORRIK – JULI
2011**

E enjte, më 14.07.2011, ora 12:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në mbledhje janë të pranishëm 67 deputetë, andaj fillojmë me punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Kemi vetëm një pikë të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me dialogun e Qeverisë të Republikës së Kosovës me Republikën e Serbisë dhe marrëveshjet e arritura në këtë dialog, sipas kërkesës së grupeve politike të Lidhjes Demokratike, të “Vetëvendosjes” dhe të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës

Tri grupe parlamentare, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” dhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës kanë paraqitur kërkesë për seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar lidhur me dialogun e Qeverisë së Republikës së Kosovës me Republikën e Serbisë në marrëveshjet e arritura në këtë dialog.

Ftoj deputetin Ismet Beqiri, që në emër të propozuesit ta arsyetojë kërkesën për këtë debat.

ISMET BEQIRI: I nderuari zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Se sa është e rëndësishme kjo seancë e jashtëzakonshme, që në start fatkeqësisht po më duhet ta them, për kryeministrin edhe zonjën Tahiri, po shihet. Sidoqoftë, duke mos dëshiruar në asnjë mënyrë të marr kohë, me qenë se tekstin e kërkesës dhe arsyetimin e keni në emër të tri grupeve parlamentare, unë nuk do të marr më shumë kohë se sa t’ju them që i keni të shkruar dhe ne tri grupet parlamentare, pas diskutimeve që do t’i kemi secili grup parlamentar, shefat e grupeve dhe të tjerët, do të dalim me një rekomandim dhe për atë, do të thotë, pas fjalës që do ta kemi në vazhdim, nuk dëshiroj të marrë më shumë kohë as për të arsyetuar, sepse e keni arsyetimin me shkrim, duke çmuar kohën e juaj, kjo është ajo që unë kam për të thënë në emër dhe në bashkëveprim edhe me dy kolegët e dy partive tjera politike opozitare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Qeverisë, a do dikush fjalën? Nëse jo, kalojmë në grupet parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar kryetari Adem Grabovci. Nuk është. Mirë, atëherë ia kalojmë kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetit Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, edhe me rastin e fillimit të këtyre bisedimeve ka shprehur rezervat e tij me mënyrën e fillimit, zhvillimin, por edhe me rezultatet nëse i kemi ato të pritura të këtyre bisedimeve.

Edhe një herë theksojmë se bisedimet e filluara kanë qenë dhe janë të papërgatitura mirë nga ana e Qeverisë dhe me pasoja të paparashikueshme politike për Kosovën. Këto bisedime nga përfaqësuesit tonë qeveritarë cilësohen si teknike, por nga zhvillimet, besa edhe cilësimet nga ndërkombëtarë, po cilësohen si bisedime politike, gjë që heq maskat e asaj çfarë aktualisht po ndodhë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimi i këtyre bisedimeve ishte me pompozitet, reklamë e propagandë nga Qeveria, veçmas nga zoti Thaçi, zonja Tahiri dhe mediat e caktuara të kontrolluara nga Qeveria.

Në fillim të korrikut u tha se u arritën rezultatet e para të këtyre bisedimeve, si marrëveshje për disa çështje: Ky Kuvend nuk u informua se çfarë u arrit, marrëveshje, konkluzë apo diçka tjetër. Një herë u tha marrëveshje, pastaj kryeministri doli dhe tha - nuk janë marrëveshje, por konkluzë. Për ne, kjo është e parëndësishme. E rëndësishme për Lidhjen Demokratike të Kosovës është përmbajtja çfarë ka në përmbajtjen e tyre. E rëndësishme për Lidhjen Demokratike të Kosovës është se a janë ato produkt i bisedimeve ndërmjet dy shteteve sovranë dhe se në arritjen e këtyre dokumenteve Kosova a është përfaqësuar si shtet i pavarur dhe sovran?

Ishte Lidhja Demokratike e Kosovës ajo që kushtëzoi, në mes tjerash, rezolutën për bisedime me nevojën e ratifikimit të marrëveshjeve që dalin nga ato bisedime dhe atë me dy të tretat e votave të deputetëve, ashtu siç e parasheh Kushtetuta e vendit tonë.

Zoti Thaçi, pas dy muajsh nga fillimi i bisedimeve pranoi dhe deklaroi këtu në një seancë se marrëveshjet duhet të ratifikohen me dy të tretat e deputetëve të Parlamentit. Për t'i ikur kësaj, ishte pikërisht zoti Thaçi ai që degradoi dhe theksoi se këto tash nuk qenkan marrëveshje, por konkluzë. Ne mendojmë se ky është një deklaram i gabuar, i pavërtetë dhe i papërgjegjshëm.

Zbritja e marrëveshjeve në nivel të konkluzioneve ose zotimeve, siç thuhet, të palës së Kosovës dhe asaj serbe, në njërën anë dhe të dyja këtyre palëve bashkërisht ndaj Bashkimit Evropian, në anën tjetër, është e pakuptimit dhe shumë indikative.

Kosova dhe Serbia nuk janë një palë, në një anë, dhe Bashkimi Evropian një palë, në anën tjetër. Por Kosova në të gjitha variantet e bisedimeve dhe marrëveshjeve është dhe duhet të jetë si palë, si shtet i pavarur ndaj Serbisë, si shtet tjetër i pavarur.

Nga deklaratat e zonjës Tahiri shihet se ajo nuk e ka të qartë çfarë është duke bërë, ose e ka të qartë, por atë e fshehë nga Kuvendi, të cilit ajo me ligj dhe kushtetutë duhet t'i përgjigjet. Në njërën anë, ajo në duet me zotin Thaçi i japin vlerësimet se këto bisedime

janë teknike. Ndërkaq, po ashtu deklarohet se konkluzat e arritura janë hap i Serbisë drejt njohjes së pavarësisë së Kosovës. Deri më tani nuk kemi njohuri që një shtet e ka njohur shtetin tjetër me konkluzat të panënshkruara dhe me bisedime teknike. Këtu dikush po gënjen dhe besa po gënjen fort! Lidhur me këto dëshiroj të qartësoj qëndrimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Qëndrimi parësor i LDK-së lidhur me procesin e dialogut qysh nga fillimi ka qenë që për çka do që merren vesh Republika e Kosovës dhe Republika e Serbisë, ajo duhet të ratifikohet në Parlament. Nëse heqim dorë nga kjo kërkesë esenciale atëherë rrezikojmë që Qeveria në emër të Kosovës të pajtohet për çështje edhe më kritike, e mos të vijë fare në parlament për t'u shqyrtuar kjo.

Argument i vetëm i Qeverisë është se meqë këto marrëveshje nuk kanë nënshkrim, ato nuk kanë nevojë të vijin në parlament për ratifikim. Por nënshkrimi nuk është relevantë aspak, sepse e drejta ndërkombëtare nuk kërkon që marrëveshjet ndërkombëtare domosdo të nënshkruhen për të krijuar obligime për palët. Me rëndësi është të ekzistojë pajtimi i vullnetit mes dy shteteve sovraane. Pra, pyetja e vërtetë është - a ka vepruar Kosova si shtet sovran në raport me Serbinë? Kur janë dakorduar për këto çështje?

E drejta ndërkombëtare parasheh dy kushte për ekzistimin e një marrëveshje ndërkombëtare.

Në një, të ketë pajtim të shprehur qartë nga ana e palëve,
Nën dy, të jetë e lidhur mes dy apo më shumë shteteve sovraane.

Qeveria e Kosovës, si arsytim për mos sjelljen e këtyre marrëveshjeve në parlament, përmend faktin se ato nuk janë nënshkruar. Prandaj, sipas Qeverisë, ato nuk janë marrëveshje ndërkombëtare dhe s'kanë nevojë të ratifikohen. Duke dashur t'i ikë Kuvendit, Qeveria po e përmend një argument që nuk pranohet në të drejtën ndërkombëtare. Nënshkrimi nuk është i domosdoshëm për të lidhur një marrëveshje ndërkombëtare dhe për të krijuar pasoja ligjore. Shprehja e pajtimit mund të bëhet në mënyra të ndryshme përmes deklaratave publike, siç ka qenë në rastin tonë, me mënyra të ndryshme tjera si shkëmbim të dokumentit, për të cilin janë pajtuar, siç ka ndodhë përsëri në rastin tonë, dhe me çfarëdo mënyre tjetër të shprehjes së pajtimit, për të cilën janë dakorduar palët.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në disa raste ka konfirmuar se marrëveshjet ndërkombëtare krijojnë pasoja ligjore dhe obligime edhe kur palët nuk i nënshkruajnë ato. Pra, mjafton që palët të shprehin pajtimin e tyre në një formë, për të cilën ata dakordohen. Prandaj, sa i përket aspektit formal, konkluzionet e dakorduara i plotësojnë të gjitha kushtet formale për t'u konsideruar marrëveshje. Përndryshe, nëse nuk janë marrëveshje, nuk kemi obligim t'i zbatojmë, sepse vetëm marrëveshjet krijojnë të drejta dhe detyrime.

Nëse Qeveria jonë thotë që këto nuk janë marrëveshje ndërkombëtare, atëherë rezulton se kjo Qeveri po pajtohet me qëndrimet e Serbisë, e cila thotë se ka lidhur marrëveshje me

një provincë të veten. Prandaj, çështja e vërtetë për t'u diskutuar është: Nëse në këtë dokument, sido që të quhet: marrëveshje, dakordim, pajtim, konkluzion e të tjera, Kosova dhe Serbia janë palë të barabarta, pra dy shtete, pra a është kjo marrëveshje ndërkombëtare apo ndërshtetërore. Nëse Qeveria vërtet insiston se kanë qenë palë ose ka qenë palë e barabartë dhe shtet sovranë në këtë relacion dhe si e tillë është e përfshirë edhe në këto marrëveshje, atëherë ato duhet t'i sjellë për ratifikim në Kuvend, në mënyrë që t'u japë atyre legjitimitet dhe zbatueshmëri, natyrisht, nëse i pranon Kuvendi.

Qeveria nuk mund t'i ikë ratifikimit në Kuvend duke përmendur arsye të papranueshme, sikurse është mungesa e nënshkrimit. Qeveria e anashkalon ratifikimin vetëm e vetëm nëse e pranon se nuk është paraqitur si shtet në këtë marrëveshje. Në të kundërtën, derisa thotë se ka vepruar si shtet, atëherë e ftojme që të respektojë Kushtetutën, e cila kërkon që marrëveshjet për të cilat pajtohet Kosova me shtetet tjera, pra ndërkombëtare apo ndërshtetërore, të sillen në Kuvend për ratifikim. Nëse vërtet çështjet për të cilat Kosova po pajtohet me një shtet tjetër janë në të mirë të Kosovës, atëherë Qeveria nuk ka përse t'i frikohet Kuvendit.

Trajtimi jo serioz i dialogut në Kuvend nga ana e zonjës Tahiri, e cila përqeshte kërkesat e Kuvendit për informata, nuk duhet assesi të vazhdojë. Ajo nuk po bisedon me Serbinë për çështjet e saja personale, po për interesat e Kosovës dhe popullit të saj. Prandaj, talljet e saj me kërkesat e institucionit më të lartë përfaqësues janë të papranueshme dhe të papërgjegjshme.

Prandaj, në mënyrë që të mos krijohet një praktikë e anashkalimit të organit më të lartë përfaqësues dhe mos të ndodhë nëpërkëmbja e sovranit, duhet që të sigurohet roli i Kuvendit për t'i dhënë legjitimitet dakordimeve apo marrëveshjeve që i arrin Kosova me Serbinë. Qeveria nuk mund t'i ikë këtij obligimi, thjeshtë duke mos nënshkruar, sepse me rëndësi është ajo që po merr përsipër, pra obligimet për t'i zbatuar.

Lidhur me këtë dua të nënvizoj, po ashtu, se LDK nuk e sheh të rëndësishme cilësimin e dokumenteve si marrëveshje, konkluzë, akordime apo diçka tjetër, por kërkon që për çdo rezultat të bisedimeve të njoftohet Kuvendi dhe këto rezultate të votohen në Kuvend për ratifikim, si rezultat të bisedimeve ndërmjet dy palëve shtetërore. Nëse Qeveria vazhdon të insistojë se ato nuk janë marrëveshje, por disa konkluzione jo formale, me këtë ajo dëshiron t'ia hap dyert vetit për punë të tjera edhe më të rënda, në mënyrë që të pajtohet për çka do, madje dhe për ndonjë status special të veriut, pra t'i ikin obligimit për ratifikim në këtë Kuvend, thjeshtë duke thënë - këto janë konkluzione dhe nuk kanë nënshkrime. Ne themi që, nëse Qeveria insiston se këto pajtime janë arritur mes dy shteteve, atëherë ato duhet të vinë në Kuvend për ratifikim, sepse Kosova në këto dokumente duhet të trajtohet si shtet i barabartë.

Sa i përket vetë marrëveshjeve apo konkluzioneve, duhet të theksojmë edhe këtë, mendimi ynë është ky. Me këto konkluzione Serbia qartë krijon avantazh dhe përfitime, kurse ne rrezikojmë sovranitetin tonë. Kosova nuk guxon dhe nuk mund të bëjë kurrfarë lëshimi apo kompromisi me atributet e saj shtetërore, si emri - Republika e Kosovës, dokumentet e saj zyrtare, stemën, flamurin. Formulimet të cilat dalin nga këto të

ashtuquajtura konkluzë, flasin për mosrespektim të kushtetutës, që çon në zbehje dhe zvogëlim të sovranitetit të Kosovës, zbehje të funksionimit legjitim dhe të plotë të institucioneve tona shtetërore, duke përfshirë edhe Kuvendin e Republikës.

Rezoluta e Assamblesë së Përgjithshme të OKB-së fton, bën thirrje për dialog, bisedime në mes të Prishtinës dhe Beogradit, që të ofrohen palët dhe ndihmohet bashkëpunimi rajonal dhe procesi i integritetit rajonal por njëkohësisht ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Mirë, a ka edhe shumë, sa ke kohë? Dikush prej jush ia jepni 5 minuta. Mirë, Egremit po t'i jap krejt. Vazhdoje!

ISMET BEQIRI: ... por njëkohësisht, po e përsëris, OKB-ja ka përqaftuar edhe opinionin e GJND-së për dhe rreth Kosovës.

Ecuritë e këtij dialogut, sipas bindjes tonë, i ndihmojnë Serbisë në kërkimin e statusit kandidat për BE, në dëm të shtetit tonë. Ato, konkluzionet, sikur nëpër një deriçkë të vogël përkrahin pretendimin e Serbisë ndaj Kosovës, dobësojnë sovranitetin tonë shtetëror dhe e rrezikojnë legjitimitetin e institucioneve të Republikës së Kosovës në tërë territorin e shtetit tonë.

Bisedimet nuk duhet të zhvillohen që ne t'i ndihmojmë Serbisë për të përfituar kandidimin në Bashkimin Evropian. Bisedimet nëse ka nevojë, do të zhvillohet dhe duhet të zhvillohet për t'i ndihmuar Kosovës që para Serbisë të kandidohet dhe të pranohet në Bashkimin Evropian. Nëse neve këtë e bëjmë me vetëdije apo pa të për Serbinë, ne duhet ta dimë se për një kohë të gjatë do të mbesim jashtë këtij procesi të integritetit.

Sa i përket lëvizjes së lirë, të prezantuar me këto konkluzë, ajo është kategori kushtetuese dhe e drejtë themelore e qytetarit. Si e tillë, ajo nuk mund të përcaktohet pa ratifikim nga parlamenti. Mënyra se si është trajtuar në këto dokumente, flet sikur kemi të bëjmë me lëvizje brenda një shteti, sepse me letërnjoftimet lëvizet brenda një shteti dhe jo ndërmjet dy shteteve të pavarura. Nëse kjo bëhet ndërmjet dy shteteve të pavarura, atëherë duhet të ekzistojnë marrëveshje ndërshtetërore që e rregullon këtë çështje.

Kufiri i Kosovës me Serbinë nuk është kufi administrativ. Me pranimin e këtyre konkluzioneve, Serbia sforcon pozicionin e saj se nuk e pranon shtetin e Kosovës, duke mos i njohur pasaportat e Kosovës dhe Qeveria jonë pajtohet për këtë.

Serbi dëshmon se imponon që me letërnjoftime, të cilat mund, por nuk është e obligueshme të tregohen në kufij, të kalohet kufiri i ashtuquajtur administrativ dhe në këtë formë ne heshtazi pajtohemi që kufirin shtetëror mes Kosovës dhe Serbisë ta konsiderojmë si kufi administrativ. Këtë nuk kemi të drejtë ta bëjmë.

Marrëveshje kalimtare për tabelat KS të vlejnë për 5 vjet dhe pas vitesh përsëri të bisedohet për këtë çështje, do të thotë ndryshe devalvim, mos respektim të vendimit të

mëhershëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërrimin e targave të UNMIK-ut me targa të shtetit të Kosovës RKS. Kjo do të thotë, po heqim një atribut shtetëror në vitin 2011 dhe po kthehemi pas disa vitesh ose pas disa vjet në një riprotektorat të lehtë, por qeverisë së UNMIK-ut, por jo si prodhues tani të tabelave, sepse këtë për të, domethënë për UNMIK-un, do ta bëjë Kosova, pra i heqim një punë teknike prodhuese UNMIK-ut, por me konotacione, përmbajtje dhe pasoja të pastra politike shtetërore në dëm të Kosovës.

Serbia me konkluzën për regjistrat civilë po mban ose së paku do të luajë rolin e padronit, pronarit mbi Kosovën për këtë çështje. Është rregull që pronari mbanë origjinalin, institucioni që lëshon dokumentin mbanë origjinalin, të tjerëve në këtë rast Kosovës, patën mëshirë ata, do të thotë, Serbia të na i japin kopjet. Kjo është e papranueshme. Ata regjistrat civilë i vodhën, ua morën qytetarëve të Kosovës, komunave të Kosovës, ata nuk mundën t'i marrin me vete edhe qytetet tona dhe qytetarët, kuptohet pa neve shqiptarët, sepse neve na deportuan aq sa mundën, po të mundin, edhe këtë do ta bënin, na morën atë që na takon. E tani konsiderojmë sukses që na i dhanë kopjet. Vërtet shtrohet pyetja, si mund t'i kenë dy regjistra civilë, njëri kopjen e tjetri origjinalin, dy shtete të ndryshme.

Duke pasur parasysh këto vërejtje dhe shumë të tjera që për shkak të kohës nuk mund t'i themi, para se të them rekomandimin në pajtim edhe me dy kolegë dhe dy grupet parlamentare, po i them edhe disa çështje para se të them rekomandimin finalist, që ia propozojmë Kuvendit.

”Kuvendi, gjegjësisht Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron se janë plotësuar të gjitha kushtet që të ketë pezullim të këtyre bisedimeve, derisa Qeveria me një platformë të qartë, të pranueshme nga gjithë ne këtu në Kuvend, derisa bisedimet të përgatiten mirë me platformën tonë të bisedimeve, të harmonizohen sigurisht edhe bashkërenditen edhe me SHBA-të dhe BE-në, duke mbrojtur gjithsesi interesat tona shtetërore, që data e re e bisedimeve të caktohet pas hartimit të kësaj platforme të ... bisedimeve në koordinim me BE-në dhe SHBA-të dhe pas miratimit të kësaj platforme në Kuvendin e Kosovës, pas asaj që të gjitha marrëveshjet që do të arriheshin, pas vazhdimit të bisedimeve, të ratifikohen në këtë Kuvend me dy të tretat e votave dhe konkluzat, si të tilla, edhe për LDK-në si të papranueshme, ne propozojmë, po e përsëris edhe një herë, edhe në emër të dy grupeve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që Kuvendi i Republikës së Kosovës të marrë vendim për pezullimin e bisedimeve Kosovë – Serbi dhe të mos pranohen tri të ashtuquajtura konkluzat si obligative për Kosovën. Pra, kërkojmë në fund të debatit, gjegjësisht të kësaj seance që ky propozim, gjegjësisht rekomandim i yni të hedhet në votim”. Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Zoti kryeministër, Kabinet qeverisë,

Të nderuar kolegë,

Kosova po kalon në një situatë e cila kërkon përkushtimin më të madh nga të gjithë ne në rrugën e integritit Evropian, zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale. Ne duhet të jemi koshient ndaj obligimeve dhe përgjegjësisë shtetërore që kemi, së pari, në raport me qytetarët tanë dhe, pastaj, me miqtë tanë ndërkombëtarë. Ne jemi përcaktuar për shtet demokratik, të integruar në bashkësinë evropiane, duke i ruajtur dhe kultivuar marrëdhëniet e shkëlqyera me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe miqtë tanë ndërkombëtarë.

Synimi ynë është ndërtimi i marrëdhënieve të mira me të gjitha shtetet fqinje, duke përfshirë edhe Serbinë. Ne jemi të përcaktuar për qarkullim të lirë të njerëzve, të mallrave. Jemi të përcaktuar për krijimin e kushteve të nevojshme për mirëqenie të qytetarëve.

Të nderuar deputetë,

Duke u mbështetur në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila i ka dhënë mbështetje të plotë delegacionit të Kosovës që të negociojë marrëveshjet teknike me Serbinë, vazhdojmë edhe më tej të kemi besim dhe ta mbështesim punën e këtij delegacioni.

Jemi të vetëdijshëm në ndjeshmërinë e punës dhe përmbytjes së këtyre konkluzave, të cilat janë për të mirën e dy popujve dhe dy vendeve. Por, natyrisht, jemi të kujdesshëm për ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit tonë.

Të jemi të sigurt se do të përcjellim në çdo hapë mbarëvajtjen e bisedimeve dhe nuk do të lejojmë që në asnjë mënyrë të dilet jashtë obligimeve kushtetuese dhe parimeve demokratike.

Ne, si grup parlamentar, kemi shqyrtuar konkluzionet e BE-së, ku janë pajtuar edhe delegacioni i Kosovës dhe i Serbisë. Ne qysh sot mund të konkludojmë se këto janë konkluzat që njohin de fakto pavarësinë e Kosovës. Këto nuk cenojnë aspak shtetin tonë të cilin e ndërtuam me gjak.

Të nderuar, partneriteti me miq na duhet sot, po aq sa na është deshtë gjatë rrugëtimit tonë për krijimin e shtetit. Nuk kemi dyshim në miqtë tanë, sepse sot dhe gjithmonë do të kemi nevojë për miqësi. Nëse dikush këtu mendon se Kosova nuk ka nevojë për miq e për më shumë për ata miq që bëhen të pamundur për të ndërtuar shtetin më të ri në Evropë, e ka shumë gabim. Deklarimi i SHBA-së përmes zëvendëspresidentit Bajden, dërgoi mesazhin e qartë pro këtyre konkluzave, duke na siguruar se SHBA është krah Kosovës dhe nuk merr asnjë hap që çon në rrugën e dëmtimit të shtetit të Kosovës.

Në anën tjetër, Sekretarja e Shtetit, Clinton, kërkon marrëveshje të reja. Sipas të opozitës, SHBA, investuesi më i madh i pavarësisë së Kosovës, i cili natë e ditë punon që më shumë njohje të sigurojë sa më shumë njohje për Kosovën qenka pro dëmtimit të shtetit dhe sovranitetit, për ne është e papranueshme. Edhe shteti shqiptar, gjithashtu përsëriti konkluzionet e arritura, po ashtu shqiptarët e Luginës së Presheves përmes përfaqësuesve të tyre e definuan marrëveshjen, duke quajtur dalje nga getoja. Kjo na bën më të

fuqishëm, të kemi besim në delegacionin tonë për realizimin e synimeve tona shtetërore. Kosova vazhdon të mbështetet nga miqtë tanë më të mëdhenj në historinë e saj, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe natyrisht Bashkësia Evropiane, në rolin e saj për integrimin e Kosovës në familjen e madhe Evropiane.

Të nderuar deputetë,

Seanca e sotme lidhur me konkluzat e BE-së dhe pranimin e këtyre nga Kosova dhe Serbia, si rekomandim i BE-së dhe Shteteve të Bashkuara, është e dobishme për faktin se qytetarët njoftohen me konkluzat teknike, që padyshim do të lehtësojnë jetën e tyre. Ajo që dikush po mundohet të përpiqet t'i paraqesë këto konkluzat si humbje të sovranitetit, është e paqëndrueshme. S'kemi të bëjmë këtu me humbje të elementeve të shtetësisë, siç pretendon dikush. Por, Kosova si shtet, ashtu si të gjitha shtetet tjera, po merr obligimet karshi bashkësisë ndërkombëtare dhe fqinjësisë së mirë, të cilën gjë e kanë bërë dhe e vazhdojnë ta bëjnë të gjitha shtetet që janë futur në këtë proces.

Ne dhe miqtë tanë po kërkojmë zgjidhje që të kemi mirëqenie më të mirë për qytetarët tanë, qarkullim të lirë dhe plotësim të nevojave shtetërore. Ne të gjithë do të donim që Serbia të njohë Kosovën shtet qysh sot, të njohë pasaportat e shtetit të Kosovës qysh sot, diplomat e shtetit të Kosovës, vulat e shtetit të Kosovës e kështu me radhë. Por, pavarësisht ndjenjave pozitive të secilit, janë pritje të mëdha të cilat do të zgjasin, por pa tjetër do të ndodhin. Dhe ne kemi obligim që pa e cenuar interesin shtetëror, të lehtësojmë mirëqenien e qytetarëve të shteteve tona. Dilemat duhet të hiqen dhe ne nuk do të duhej që deri sa ta njohë Serbia Kosovën, mos të kemi qarkullim të lirë të njerëzve, sidomos të mërgimtarëve tanë apo shqiptarët e Luginës së Preshevës të mos kenë të drejtën e punës, e cila u është mohuar me vite të tëra. A do të duhej ne të lejojmë që milionat e humbur nga pengesat e qarkullimit të mallrave, të vazhdojnë të humbin edhe tutje? A do të duhej që strukturat paralele t'i lëmë akoma duke vepruar në veriun e Kosovës, e ne mendojmë se këto konkluzat shënojnë fillimin e fundit të veprimit të këtyre strukturave?!

Duhet të jemi të ndërgjegjshëm në atë që themi dhe veprojmë. Konsiderojmë se konkluzat janë hap teknik drejt mirëqenies së qytetarëve, të cilat do të determinojnë hapa të tjerë politikë drejt njohjes deklarative të ndërsjellë të dy shteteve tona në një të ardhme sa më të afërt. Ne e mbështesim delegacionin e Kosovës në këto bisedime, duke e kërkuar fuqishëm respektimin e parimeve demokratike dhe Kushtetutën e vendit. Besojmë fuqishëm në rekomandimet e miqve tanë, të cilët u gjendën pranë në gjithë proceset që ka kaluar dhe vazhdon të kalojë vendi dhe populli ynë. Ju faleminderit!

KRYETARI: (Kryeministrit) - Ti, pas grupeve parlamentare, shefave të grupeve! Në emër të "Vetëvendosjes", kush e do fjalën? Visar Ymeri.

VISAR YMERI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Në secilin proces të deritashëm negociator mes Kosovës dhe Serbisë, e dimë që debati kryesor publik ka qenë i përqendruar rreth përmbytjes. Për marrëveshjen e Rambujesë,

për Rezolutën 1244, për Planin e Ahtisaarit dëgjonim shumë fjalë lavdie, miradije për përmbajtjen e tyre, e cila, sipas lavdëruesve, na i avansonte të drejtat dhe na e shtonte lirinë. Këtë radhë, megjithatë diçka ka ndryshuar. Tash shumë më shumë negociatorët po shprehin vullnet për të folur për formën e tyre. A janë ato marrëveshje, a konkluzat, konkluzat këto gjithsesi të dakorduara mes palëve? Këtë gjë e dëgjuam edhe nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, i cili më shumë se për përmbajtjen e këtyre marrëveshjeve foli për pranimin e këtyre konkluzave nga palët e ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës. Pra, foli për formën e jo për përmbajtjen. Duket se negociatorët më në fund e kanë kuptuar që një përmbajtje e dëmshme dhe e rrezikshme është e pamundur të shitet si e mirë dhe e dobishme, prandaj edhe kanë hequr dorë nga kjo çështje.

Nuk është se forma e këtyre marrëveshjeve apo konkluzave nuk është e rëndësishme dhe ka arsye pse ato nuk po quhen marrëveshje. Për shkak se po të quheshin marrëveshje, atëherë doemos do të duhej të specifikohesh se mes kujt janë arritur marrëveshjet. A janë palët Republika e Kosovës dhe Republika e Serbisë? Delegacioni i Serbisë nuk do ta pranonte kurë këtë, për shkak se ata nuk e njohin Republikën e Kosovës. Kjo marrëveshje madje do të ishte edhe marrëveshje ndërkombëtare dhe kështu Qeveria e Kosovës do të obligohej që ta sjellte atë në Kuvend për ta ratifikuar. Por, një pyetje tjetër është këtu. A janë palët Qeveria e Republikës së Serbisë dhe Kosova, pa republikë? Qeveria e Kosovës nuk do të lejonte këtë për shkak se kështu do të merrej vesh se e ka pranuar këtë status karshi Serbisë.

Prandaj, ndërmjetësuesi nxjerrë konkluzat. Ato janë kërkuar nga Serbia për shkak se ia mundësojnë asaj mosnjohjen e Kosovës, ndërhyrjen në çështjet e brendshme dhe në territorin e brendshëm të Kosovës dhe rrugëtimin e saj drejt BE-së, si dhe janë pranuar nga Kosova për shkak se ia mundësojnë Qeverisë së Kosovës ta fshehin nga publiku, nga populli i Kosovës kompromisin e bërë. Mirëpo, këto janë marrëveshje, sepse pavarësisht mungesës së nënshkrimit nga palët dialoguese, të dyja janë zotuar se do t'i pranojnë dhe zbatojnë këto pika të konkluzave. Rrjedhimisht, palët janë dakorduar për këto konkluzat, pra janë marrë vesh.

Këto 3 marrëveshje të para që mbulojnë lëvizjen e lirë, regjistrat civilë dhe diplomat universitare, janë 3 marrëveshjet më të lehta dhe më së paku të dëmshme. Prandaj, edhe janë lënë për fillim. Çka do që vjen më pastaj, do të jetë edhe më e dëmshme e edhe më rrënuese ndaj shtetësisë së Kosovës, meqenëse se kemi të bëjmë me tema të cilat drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me territorin e Kosovës dhe shtrirjen e institucioneve të Kosovës në këtë territor. Por, edhe këto 3 marrëveshje të para nuk është se nuk e cenojnë këtë sovranitet dhe këtë integritet territorial. Ato janë në kundërshtim me parimet, me germën dhe frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe jo vetëm me sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit, por edhe në kundërshtim me mundësinë që në të ardhmen të kemi sovranitet dhe integritet territorial. Pra, në vend se Qeveria e Kosovës të punojë drejt krijimit të një shteti sovran, ajo po angazhohet që ta shtyjë në kohë dhe ta ngushtojë në hapësirë këtë sovranitet.

Marrëveshja për lëvizjen e lirë dhe ajo për regjistrat civilë është antikushtetuese, pasi në mënyrë të kundërligjshme, të panatyrshme, madje antihistorike, e kthejnë Kosovën në

periudhën e para shpalljes së pavarësisë. Kjo nënkupton zhbërjen e Republikës së shpallur të Kosovës, e për pasojë dhe zhbërjen e institucioneve dhe pushteteve të saj, që burimin e marrin, siç sanksionon kushtetuta, pikërisht tek nenet 1.1 dhe 2.1 të saj. Midis marrëveshjes në fjalë dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk ka konsekuencë. Sanksionimi i marrëveshjes rrëzon Kushtetutën, për pasojë dhe Republikën, dhe besimi në Kushtetutë e në Republikë, nuk e pranon sanksionimin e kësaj marrëveshje.

Dialogu në fjalë dhe marrëveshjet që imponohen si rezultat i tij, janë në kundërshtim me pavarësinë e Kosovës tashmë të njohur ndërkombëtarisht nga 76 shtete dhe të konfirmuar ligjërisht nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Marrëveshjet e dëmtojnë Republikën e Kosovës në politikën e saj të jashtme për shkak se paraqesin një precedent politik e juridik të rrezikshëm, të ridefinimit të statusit formal të Kosovës nga palët e treta. Në këtë drejtim ato janë në kundërshtim me aspiratat integruese të Republikës së Kosovës, meqenëse janë në kundërshtim me sovranitetin si parim bazë të së drejtës ndërkombëtare, si dhe me paraqitjen e Kosovës në arenën ndërkombëtare si Republikë.

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në tekstin e konkluzës të dakorduar nga palët, thuhet se banorët duhet ta kenë mundësinë që të udhëtojnë lirshëm në territorin e tjetrit. Pra, nuk thuhet në territorin e Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, meqenëse kjo do ta cenonte Kushtetutën e Serbisë. Këtu nuk bëhet fjalë për masa reciproke, siç po kanë dëshirë ta quajnë negociatorët tanë, për shkak Kushtetuta e Kosovës nuk ka asnjë klauzolë ku e trajton territorin e Serbisë si pjesë të pandashme të Republikës së Kosovës. E njëjta gjë vlen edhe për këtë Qeverinë e Kosovës, e cila në asnjë rast nuk është përgjigjur qartë nëse e njeh apo jo Serbinë. Dhe meqenëse nuk ka asnjë vendim qeveritar që thotë se nuk e njeh, atëherë kjo nënkupton se ajo e njeh. E vetmja arsye pse nuk ka ndonjë vendim të Qeverisë së Kosovës për ta njohur formalisht Serbinë, është vetë Serbia, Serbia nuk do ta pranonte një njohje të tillë kurrë.

Në konkluzë, në pikat 2, 4 dhe 5 të asaj për lëvizjen e lirë, ne trajtohem si ‘banorë’, e jo ‘qytetarë’, ndërsa në pikën 3 të po së njëjtës, trajtohem si ‘persona’. Kjo mosnjohje e Republikës së Kosovës nga palët, pra edhe nga vetë zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, meqë Serbia nuk e ka problem njohjen, ajo njihet si shtet nga BE-ja, por edhe nga Qeveria e Kosovës në bazë të platformës të cilën e ka paraqitur tash së voni këtu në Kuvend, pasi që aty i referohet palës së Beogradit si Republika e Serbisë. Republika e Serbisë, secili zyrtarë i Serbisë kurrë nuk e përmend emërtimin politik - Republika e Kosovës.

Fusnota që është futur në pikën 3 të marrëveshjes për lëvizjen e lirë, e cila i referohet një sistemi që nxjerrë dokumente përcjellëse me letërnjoftimet e personave që udhëtojnë nëpër Kosovë dhe Serbi, thotë që këto dokumente përcjellëse do të përmbajnë gjuhë neutrale. Po çka nënkupton kjo gjuhë neutrale? Ky është neutraliteti i famshëm ndaj statusit të Kosovës, apo jo. Pra, kjo i bie që nëse Kosova lëshon dokumente të tilla përcjellëse për ata persona që udhëtojnë nëpër Kosovë me letërnjoftime të Serbisë, aty nuk guxon të figurojë Republika e Kosovës. Mosnjohja e Serbisë ndaj Republikës së

Kosovës kështu zgjerohet edhe në mosnjohje të Republikës së Kosovës nga secili serb individualisht.

Përderisa në pikën 5 thuhet që patentë shoferët do t'i lëshojnë autoritetet e palëve, në pikën 6 të së njëjtës konkluzë thuhet që Kosova do të vazhdojë me lëshimin e tabelave KS të cilat, në fakt, janë të UNMIK-ut, pra qartazi të një autoriteti të cilin e njeh BE-ja.

Te pika 7 e së njëjtës konkluzë, kemi një formulim të ..., të cilin e hasim në shumë pika tjera. Aty thuhet 'secila palë do të bëjë përpjekje maksimale'. Kjo pikë nuk e kufizon Serbinë që të lëshojë tabela me regjistrim PR, GL, KM etj. Serbi i Graçanicës mund të thotë që banon edhe në Serbi, ose mund të vozisë në Kosovë veturën e kushëririt të tij nga Serbia, me autorizim. Pika 8 e së njëjtës konkluzë e shpall të përkohshme lejimin e tabelave KS në Serbi. Por, më pas mund të bëhet më keq, apo jo. E përkohshmja nuk garanton që kemi përmirësim më pastaj. Po ashtu, në pikat 4, 6, 8 dhe 9 flitet për masa të përkohshme në mënyrë të papërcaktuar.

E vetmja gjë konkrete në këtë konkluzë për lëvizjen e lirë, të dakorduar nga palët, është që deri me 1 nëntor ne do të zbrapsemi nga RKS në KS, pra do të zbrapsemi nga Republika e Kosovës, në Kosovë.

Me tabela KS në vend se RKS, Kosova pa cilësimin si republikë shndërrohet nga shteti në vend, pra nga një entitet i pavarur politik, në hapësirë të papërcaktuar gjeografike. Për më tepër, me këto tabelat KS mirëmbahet nga vetë Republika e Kosovës UNMIK-u.

Te konkluzat për regjistrat civilë, thuhet që palët do ta vendosin një regjistër civil të besueshëm në Kosovë. Pra, Serbia dhe Kosova duhet të punojnë bashkë në Kosovë për t'u dakorduar për një çështje që është çështje e brendshme e Kosovës, nëse natyrisht e kemi parasysh pavarësinë e Kosovës. Sepse, ky angazhim i përbashkët i Kosovës dhe Serbisë në Kosovë, ka kuptim vetëm nëse nuk e kemi parasysh këtë pavarësinë e Kosovës, pra vetëm nëse e mohojmë atë.

Kjo konkluzë disi nënkupton që origjinale është vetëm ajo që ekzistonte para vitit 1999, dhe jo ajo që është ndërtuar pas vitit 1999. Bile edhe UNMIK-u, p.sh. me procesin e privatizimit, e pati hequr periudhën 1989-1999, duke mos i marrë parasysh transformimet e pronës të bëra atëherë. Por, tash, me këto konkluzat të dakorduara, po konsiderohet në mënyrë normale dhe origjinale edhe kjo periudhë!

Pika 3 e konkluzës e lë hapësirën që EULEX-i mund të mos konsultohet nëse është e nevojshme. Por kush e vendos se a është e nevojshme apo jo?! Pasoja do të jetë që Serbia bën trysni mbi EULEX-in dhe këtu mund të hyjmë në një cikël bisedimesh EULEX-Serbi, ku Kosova natyrisht bëhet spektatore. Le të mos harrojmë që për shkak të trysnisë së Serbisë mbi EULEX-in, ky i fundit s'i ka prekur kurrë strukturat paralele të Serbisë në Kosovë dhe as kriminelët serbë të luftës por, për më keq, ka nënshkruar protokoll për bashkëpunim policor me Serbinë.

Pika 4 e konkluzës, thotë se me kërkesë EULEX-i do t'i ofrojë informata specifike nga Kosova. Po për çfarë informatash bëhet fjalë këtu?! Edhe një çështje...

KRYETARI: Mirë, regjia, ia vazhdoni!

VISAR YMERI: ...pra çfarë informatash do t'i ofrojë EULEX-i Serbisë, për shkak se këtu thuhet që EULEX-i do të ofrojë informata nga Kosova dhe informata nga Kosova do t'i ofrojë vetëm Serbisë me kërkesë të Serbisë. Dhe një çështje tjetër, pse kjo nga 'nga Kosova' nuk figuron në përkthimin shqip?! Nëse i krahasoni tekstin anglisht dhe tekstin shqip, e shihni që kjo nga Kosova është hequr nga përkthimi shqip. Çka nënkupton kjo? Kjo nënkupton se negociatorët tanë, Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila sigurisht e ka bërë përkthimin, se nuk e ka bërë përkthimin BE-ja, e di dëmin që i sjell ky lloj formulimi i kësaj konkluze dhe rrjedhimisht ka dashur të na hedhë hi syve, thua ti se ne asnjëri nuk dimë anglisht!

Lëvizja "Vetëvendosje" e ka të qartë se për sa kohë që nuk na njeh Serbia, në secilën negociatë me te, ne do të përfundojmë duke mos e njohur Kosovën dhe duke e deshtetëzuar Kosovën, ashtu siç po dëshmojnë këto marrëveshje, prandaj pezullimi i këtyre negociatave është i domosdoshëm. Është qëndrim i palëkundur i Lëvizjes "Vetëvendosje" që Kosova të mos negociojë me Serbinë deri në plotësimin e kushteve që i duhen vendosur Serbisë, e që i kemi bërë publike në këtë Kuvend me Rezolutën e propozuar më 7 mars të vitit 2011. Kushti kryesor është njohja e Republikës së Kosovës nga Serbia dhe ndryshimi i Kushtetutës së Serbisë, që e konsideron Kosovën si pjesë të sovranitetit të saj shtetëror. Prandaj, iu kemi bashkuar rekomandimit të përbashkët që këto negociata të pezullohen dhe marrëveshjet të mos jenë të obligueshme dhe as të zbatueshme në Kosovë dhe për Kosovën. Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të jetë garant i kushtetueshmërisë, i sovranitetit, rendit republikan dhe vullnetit të qytetarëve të Kosovës. Prandaj, u thërrasim të gjithëve, që e konsideroni veten deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që ta votoni këtë rekomandim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Edhe dje, edhe sot, një pjesë e madhe e retorikës së Qeverisë, edhe e partisë në Qeveri ka pasur të bëjë me miqësinë, me miqësinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Unionin Evropianë dhe mendoj se kanë dalë edhe disa shprehje të cilat janë të çuditshme dhe na rezonojnë diçka, na thirrën kujtesën, shembull ta marrim. Vetëm duhet t'ju themi që ne si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës kemi punuar në ndërtimin e esencës së kësaj miqësie, esencës popullore, të popullit të Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Unionin Evropian dhe Qeveria nuk mund të bëjë më shumë, nuk mundet Qeveria të bëjë më shumë se sa ka bërë vetë populli i Kosovës për të ndërtuar miqësi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Unionin Evropian, as nuk mundet t'i prishë, nuk mundet as të bëjë më shumë, por nuk mundet as t'i prishë, por mundet vetëm të qesë Kosovën pak si qesharake në këto rrethana.

Shprehja ta ruajmë miqësinë me SHBA-në dhe BE-në si sytë e ballit, ma ka kujtuar shprehjen e shokut Tito - ta ruajmë vëllazërim - bashkimin si sytë e ballit. Edhe unë nuk po di, veç ta vesim kryeministrin a ka nisur ta kopjojë edhe Titon tash. Domethënë, nuk ka nevojë edhe nuk më pengon, nëse do, është punë e tij dhe po më vjen keq që s'është këtu, është punë e tij a e kopjon a jo, as ideologjikisht nuk kam problem, edhe pse vetë jam i djathë, i partisë së djathtë, edhe familjen djathtë që 75 ..., po veç po më befason se ka ndërtuar karrierë politike duke i denoncuar titistët e duke bërë me ata të tjerë, e çka po ja vjedh shprehjet tash, s'ka nevojë kështu. Sidoqoftë, po dua të kthehem në temë.

Ne, si Aleancë, e shohim si interes vital të Kosovës, edhe të popullit të Kosovës që kur flasim për këto tema, të jemi sa më të qartë, sa më të thjeshtë në fjalë të tona, me fjalë të zgjedhura që të na kuptojnë të gjithë. Jo vetëm një pakicë e ngushtë e njerëzve që merren me këto tema, po të gjithë!

Tani, një rekomandim të cilin e lexoi zoti Beqiri dhe e përsëriti zoti Ymeri, është që të pezullohen bisedimet dhe me siguri se duhet të shpjegojmë pse po mendojmë kështu dhe t'i thërrasim edhe deputetët e partive në pushtet që të votojnë kështu sikur që ne po synojmë që të arrijmë sot.

Fillimisht, Kosova nuk i ka qartësuar interesat e veta strategjike dhe do të flas edhe pak më vonë për këto. Kosova sot nuk ka interesa të veta strategjike ose, të paktën, përmes këtyre negociatave nuk po dëshmon se po ndjek interesa të veta strategjike.

Nën dy, Kosova nuk i ka sekuanecuar veprimet e veta ashtu që të maksimizojë përfitimin për vete, domethënë sekuencimi është i gabueshëm dhe te sekuencimi do të kthehem pak minuta.

Po del që Qeveria e Kosovës nuk e ka kuptuar që diplomacia botërore dhe politika ndërkombëtare i ka disatribute të ujtit, shkon andej nga e gjen më lehtë, nga është më së lehti shkon dhe nëse ia ndërton një barrierë, fillon e rritë presionin në atë barrierë, po në të njëjtën kohë e rritë edhe mundësinë për të gjetur rrugë tjera për të gjetur zgjidhje, të punëve. Kosova mendon që në pengesën e parë duhet ndalur, kështu të paktën po e paraqet Qeveria e Kosovës gjendjen tonë. Duhet të pezullohen bisedimet, se në vend se të krijohet një situatë në të cilën edhe ne, edhe Serbia do të kishim synime të njëjta viza-vi Unionit Evropian. Qeveria jonë e ka sjellë Kosovën në pozitë që synimet tona dhe të Serbisë vizavi Unionit Evropian janë diametralisht të ndryshme. Serbia ka interes për të hyrë në Union Evropian drejtpërdrejt të marrë statusin e kandidatit, të jetë pjesë e fondeve strukturale, të fillojë të negociojë për anëtarësim, derisa Kosova nuk e ka të qartë hala as a ka për të pasur liberalizim të vizave. Po thotë, pozicioni ynë vizavi Unionit Evropian është jashtëzakonisht i ndryshëm, nëse duam të flasim kështu. Tani Serbia e ka të qartë, e fiton statusin e kandidatit dhe statusi po i duhet, se e di që nuk e merr anëtarësimin menjëherë edhe sado që dëgjon dikush prej nesh që Serbia nuk do të anëtarësohet në Unionin Evropian pa e njohur Kosovën ose pa pasur marrëdhënie me Kosovën, nuk po i duhet asaj, se e di që nuk mund ta marrë edhe sikur ta njihte Kosovën, nuk kish për të qenë anëtar i Unionit Evropian, por i mjafton kaq sa ka dhe të njëjtën

kohë mbërrin ta shndërrojë Kosovën në një vend gati vazal përmes atyre që do t'i them edhe pak.

Do të thotë, këto ishin qëllimet strategjike të Serbisë. Qëllim tjetër është definitivisht mos jo ndarja e Kosovës, atëherë krijimi i një entiteti të ri në Kosovë, në Kosovën e veriut dhe kjo është një gjë që shihet prej vasionës, edhe nëse Qeveria e Kosovës nuk e sheh, atëherë duhet të na vijë keq gjithëve, edhe vetë deputetëve të partive në pushtet.

Çka po kërkon Kosova të arrijë në këto bisedime, sipas kryeministrit? Po synon integrimin me Unionin Evropian. Shihni, ju lutem, integrimi në Unionin Evropian nuk është frazë sikur - ta ruajmë miqësinë. Integrimi në Unionin Evropian i ka fazat e veta dhe caqet imediate të veta të cilat duhet t'i arrijë dhe kryeministri duhet të na thotë çka ka arritur ndërkohë, cilat pika, ka sekuencim të pastër, cilat pika po i arrin Kosova për shkak se po bisedon me Serbinë, për shkak se Serbisë po ia jep vizën bllanko për Union Evropian, çka po fitojmë ne? Të gjithë po na thonë që po fitojmë diçka, por realisht, deri tash, për mendimin tim dhe për mendimin e shumicës dërmuese të qytetarëve të Kosovës dhe të ndërtuesve të opinionit publik, kanë dështuar të na tregojnë çka po arrin Kosova me këto bisedime. Do të thotë, ky integrim nëse nuk është konkret, nëse caqet e integritit në BE nuk janë konkrete, nuk po ndodhë kurrëgjë, por po dëgjojmë vetëm frazë.

Tani, prapë te njohja prej Serbisë, për shkak se Qeveria e Kosovës po na thotë - ne po shkojmë drejt njohjes së Kosovës nga ana e Serbisë. Edhe Serbia po thotë - jo, s'dua t'ju njoh dhe s'ju kam njohur, por edhe bashkësia ndërkombëtare po i thotë Serbisë që nuk e ke kusht në këtë fazë ta njohësh Kosovën. Do të thotë, këto bisedime nuk çojnë drejt njohjes së pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë. Tash, Qeveria po na thotë – po, dhe duhet të na shpjegojë qysh, qysh e njeh Serbia Kosovën për shkak të këtyre bisedimeve në të cilat kemi hyrë ne.

Po thonë që po punojmë për interesin e qytetarëve. Prapë është pyetja - qysh për interesin e qytetarëve? Qysh për interesin e qytetarëve, po duhet t'ju kujtoj, deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës, edhe juve, edhe Qeverisë, edhe opinionit publik që para disa viteve populli ynë, për hir të heqjes së sovranitetit të Serbisë nga Kosova, ka hequr dorë prej shumë sendeve, ka hequr dorë edhe nga lëvizja e lirë, edhe nga shitja e produkteve në Serbi, ka hequr dorë edhe nga udhëtimi nëpër Serbi, edhe nga pasaportat, edhe nga tabelat, edhe nga telefonat, edhe shumë kush ka hequr dorë edhe prej jetës, vetëm për ta hequr sovranitetin e Serbisë prej Kosovës. Tani, ne po i lejojmë elemente sovraniteti Serbisë në Kosovë, për t'i kthyer këto, që dikur me vullnet secili prej nesh, edhe me çmimin e jetës, kemi hequr dorë prej tyre.

Për t'i shpjeguar këto, vetëm duhet pyetur Qeverinë, pa i përsëritur shumë kolegët e mi, që thanë më përpara, pse keni pranuar kopje, a s'ka pasur dikush prej Qeverisë së Kosovës që i thotë edhe zotit Kuper, edhe Unionit Evropian, a po ju duket që është shumë më ndershëm, me qenë se po insistoni ju, ne t'i marrim origjinalet e Serbia kopjet, origjinalet tona. Të paktën a ka bërë dikush këtë pyetje, edhe pse as kopjet nuk duhet t'i ketë Serbia, se si duhen gjë? Pse s'kanë insistuar? Ju thashë edhe një herë, po e përsëris,

është si çështja e ujit. Kur insistohet, duhet të gjendet zgjidhja, edhe zgjidhja mund të shkojë në favor tonin.

Tabelat i kemi, po punojmë për një palë, tani kemi për t'i pasur dy palë. Çka ndodhë me këtë marrëveshje, është që qytetarët serbë të Kosovës kanë për të pasur tabela tjera, qytetarët e Kosovës, shumica dërmuese tjera, e disa kanë për t'i pas dyfish, edhe ato të serbëve, edhe ato të qytetarëve tjerë të Kosovës, që janë me Republikë të Kosovës për shkak se kanë për të shkuar për të bërë tregti dhe ju duhen dy palë tabela, kanë për t'i ndërruar. Çka ka fituar Kosova në këtë aspekt të lëvizjes së lirë? Të njëjtën gjë mund ta bëjnë edhe tash, ata që po donë të bëjnë tregti, po shkojnë në Vranjë po i marrin tabelat, serbët e Kosovës kështu e ashtu po shkojnë po i marrin çfarë po donë, domethënë çka e përmirëson jetën e qytetarëve të Kosovës në lëvizjen e lirë ky ndryshim i tabelave? Vetëm sa e çon Kosovën mbrapa edhe ja shtrinë Serbisë edhe një dorë brenda për brenda sovranitetit të Kosovës, nuk e përmirëson lëvizjen e lirë. Ata që donë për të shkuar, edhe sot mund të shkojnë, i marrin tabelat në Vranjë, nuk e kanë problem hiq, bile, bile ne e kishin ruajtur fytyrën. Nuk na kishte shkuar edhe fytyra, se s'na ka mbetur gjë tjetër për të ruajtur, fundi i fundit.

Tani është çështja e ratifikimit në Kuvend, po i them disa fjalë. Nëse sipas Qeverisë së Kosovës, edhe sipas partisë në pushtet, këto marrëveshje janë të mira, nëse ju besoni që janë të mira, pse s'po i sillni në Kuvend edhe me shumicën e votave që i keni t'i votoni, çka po ju pengon? Nëse janë të mira, e ju po thoni që janë të mira, ju lutem, sillni në Kuvend, shumicën e kini, votoni!

Tani po dua të flas diçka për interesat e qytetarëve të Kosovës, për të cilët po flet kryeministri dhe për integrimin në BE.

Interes i qytetarëve të Kosovës nuk është dialogu, interes i qytetarëve të Kosovës është demokracia, jo vjedhja e votës, është interes jetik i qytetarëve të Kosovës. Interes është ndalja e korrupsionit, interes është zhvillimi ekonomik i vendit, jo shkatërrimi i perspektivës, është sundimi i ligjit, është fjala e lirë, ky është interes i qytetarëve të Kosovës, është ulja e varfërisë, është shkollimi kualitativ, është shëndetësia kualitative dhe po i them kryeministrit, edhe pse s'është këtu, këto që i përmendi, janë kushte për t'u anëtarësuar në Union Evropian, jo dialogu, se edhe nëse e kryen dialogun, qysh po do, këto kushte ka për t'ia lypur Unioni Evropian dhe ky është ai sekuencimi për të cilin ju fol në fillim. Cilën po e duam ta bëjmë më përpara ne, a po duam të shkojmë në negociata me Serbinë si shtet që e ka ekonominë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, një minutë e gjysmë ia vazhdo kohën!

ARDIAN GJINI: ...jo për shkak se bën dialog me Serbinë, por për shkak se e ka ndërtuar shtetin normal, e atëherë të shkojmë si të fuqishëm në negociata me Serbinë, apo sekuencimi është krejtësisht i mbrapshtë për Kosovën, është sekuencim i cili neve na ka dërguar në këto negociata në pozitë jashtëzakonisht inferiore, me një shtet që të gjithë na

shajnë, prej sundimit të ligjit, prej korrupsionit deri te zhvillimi ekonomik, te një sistem i edukimit të shkatërruar total, te një sistem i shëndetësisë, që as ne vetë s'i besojmë se pak nëse sëmuremi, dalim jashtë shtetit. E me këtë farë shteti ne shkojmë në negociata me Serbinë edhe themi që negociatat na çojnë në Unionin Evropianë. Mund të them që negociatat na çojnë në Unionin Evropian pa këto pjesët e para, është mashtrimi më i madh që mund t'i bëhet qytetarit të Kosovës sot për sot.

Çdo qeverisje i ka tri aspekte globale, dy të shkurta, një më të gjatë. Aspekti i parë është të fitohen zgjedhjet, aspekti i dytë është për të ditur të mbahet pushteti edhe aspekti i tretë është për të ditur të qeveriset për të mirën e vendit. Ne në Kosovë e kemi bindjen e plotë që kryeministri i vendit e ka pas aftësinë e parë për t'i fituar zgjedhjet në mënyrë qysh i ka fituar, po e ka aftësinë ta mbaj pushtetin qysh po e mban përmes shtypjes së fjalës së tij e tjera e tjera, por jashtëzakonisht të keqe e ka aftësinë për të qeverisur me vendin. Domethënë, nuk po mundet të qeverisë vendin, dhe ky kombinim kur dikush dinë për t'i manipuluar zgjedhjet, dinë t'i manipulojë mediat edhe fjalën e lirë edhe nuk dinë të qeverisë, është kombinimi më i keq që mund t'i ndodhë një vendi edhe unë një herë i kam thënë kryeministrit pa qenë këtu, nëse e do pak vendin, mblidhi shokët e shko, sot me qenë se erdhi, po i them edhe një herë, nëse e do pak vendin, lësho rrugë kryeministër, se jemi duke shkua në një situatë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kush e do fjalën? Deputeti Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë dhe kolege deputetë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re përshëndet iniciativën e kësaj seance të jashtëzakonshme dhe njëherësh konsiderojmë që kjo do t'i kontribuojë transparencës dhe informimit adekuat të qytetarëve të Kosovës.

Njëherësh, Koalicioni për Kosovë të Re kërkon që të zbatohet në tërësi rezoluta e aprovuar në Kuvendin e Kosovës lidhur me bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë, veçanërisht duke fuqizuar aspektet, siç janë: parimet e reciprocitetit në të gjitha fushat, parimet e mos cenimit të Kushtetutës së Kosovës, parimet e mos cenimit të integritetit territorial të Kosovës, parimet e evitimit të interferimit të palëve në çështjet e brendshme ndërshtetërore. Ne konsiderojmë që të gjitha pasuritë, dokumentet dhe artefaktet e Kosovës duhet të kthehen pa kushte në Kosovë, ngase ato janë pronë e Kosovës dhe duhet të kthehen në formën origjinale të saj. Kërkojmë që Kuvendi i Kosovës të jetë i informuar për rrjedhën e bisedimeve dhe, sipas nevojës, seanca të mbahen edhe pa praninë e publikut.

Duke marrë parasysh kontributin që po jep Republika e Kosovës në nivel të bisedimeve me Republikën e Serbisë, kërkojmë nga Bashkimi Evropian që të jetë i hapur dhe t'i

trajtojë të barabartë Republikën e Kosovës dhe atë të Serbisë në çështje të integritetit të Bashkimit Evropian.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Petar Miletij e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Poštovani predsedniče,
Poštovani predsedniče Vlade, članovi Vlade,
Koleginice i kolege poslanici,
Samostalna liberalna stranka od samog početka podržava proces dijaloga Beograda i Prištine. Glasali smo u ovom parlamentu za rezoluciju kojom je obezbeđen početak dijaloga, a zbog čega smo neretko bili kritikovani od pripadnika naše zajednice, ali nismo se previše osvrnuli na te kritike, u nadi da će dijalog brzo početi da daje rezultate i da će kvalitet života ljudi biti na višem nivou, a to je za nas prioritet.

Naša ozbiljna primedba na početku dijaloga bila je nedostatak transparentnosti ovog procesa. Međutim, i tada, i danas kažemo, ako će do doneti brza i kvalitetna rešenja, spremni smo da tolerišemo ovaj nedostatak i pružimo podršku Beogradu i Prištini u naporima da pored dogovorenog, postignu nove sporazume koji će olakšati život građana Kosova bez obzira na etničku i versku pripadnost.

Samostalna liberalna stranka pozdravlja postignute dogovore na temu slobode kretanja, matičnih knjiga, univerzitetskih diploma. Mišljenja smo da je pogrešan pristup ovim dogovorima, merenje koje dobio više a ko manje. Ovom dogovorom, za koji se nadamo da je samo početak normalizacije odnosa Beograda i Prištine, dobijaju svi i svako dobronameran bi trebalo da podrži zaključke od 2 jula. To što opozicija u Beogradu optužuje Beogradski tim da je zaključcima priznata nezavisnost Kosova, a opozicija u Prištini optužuje Prištinski tim da se ovim dogovorom krše suverenitet i Ustav Kosova, meni govori da su glavni pregovarači na pravom putu i mi ih ohrabrujemo da nastave da donose odluke od kojih će interes imati isključivo građani.

Naravno da u ovim zaključcima ima mesta za dorade i napredak i to treba da bude tema javne rasprave. Sloboda kretanja mora biti zagarantovana svim građanima i napredak u ovoj oblasti je za pohvalu. Zaključci o matičnim knjigama treba da učine život građana jednostavnijim, da dokument mogu da izvade u mestu u kojem žive, a nadam se da je onima koji falsifikuju dokumenta i zloupotrebljavaju nedostatak matičnih knjiga odzvonilo i da će se ta pojava svesti na minimum, odnosno konačno i iskoreniti.

Dame i gospodo,

Želim sa ovog mesta posebno da se zahvalim Evropskoj Uniji na medijaciji i vođenju ovih pregovora, kao i nesebičnoj podršci Sjedinjenih Američkih Država. Bez njihovog doprinosa ovaj proces ne bi počeo da daje rezultate ili možda u opšte ne bi ni počeo. Zato, prve rezultate dijaloga ne treba predstavljati kao uspeh ili kao neuspeh bilo koje strane, već treba da nas ohrabri i činjenica da iz sveta stižu pozitivni signali u vezi dijaloga.

Mislim da je jedan od najboljih komentara na prve rezultate dijaloga Beograda i Prištine dala šefica Evropske diplomatije, Katrin Ašton, koja je istakla da je ovo pozitivan korak i da ne traži da se bilo ko čega odriče, a da je korist obostrana.

Samostalna liberalna stranka će nastaviti da podržava proces dijaloga isključivo zbog interesa građana i stavljamo sve svoje raspoložive kapacitete na raspolaganje, uvereni da možemo konstruktivno i konkretno da damo svoj doprinos nastavku dijaloga. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “6+”, a do dikush fjalën? Nuk ka kërkesë.

Atëherë, Qeveria e ka radhën. Kryeministri apo zëvendëskryeministrja. Kryeministri, zoti Hashim Thaçi e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari kryetar, Krasniqi,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që fillimisht të falënderoj deputetët që kanë kërkuar këtë interpelancë për të diskutuar për procesin e deritanishëm të dialogut për çështje teknike ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë dhe konkluzionet e para teknike të arritura.

Shpresoj se sqarimet tona do të hasin në mirëkuptimin tuaj dhe ju do të pranoni faktin se procesi i dialogut dhe marrëveshjet e arritura dhe ato që do të arrihen në të ardhmen, janë në shërbim të interesit të shtetit tonë dhe qytetarëve tanë.

Më lejoni që qysh në fillim të bëjë të qartë një gjë thelbësore, që dialogu dhe fqinjësia e mirë janë vlera dhe kushte të pa negociueshme të botës demokratike dhe euroatlantike.

Qytetarët e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës janë përcaktuar qartë dhe fuqishëm përkrah këtyre vlerave të botës demokratike. Ndërsa, këto vlera më së miri përfaqësohen sot në botë nga aleatët tanë të përhershëm, që janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian.

Unë dua të bëjë të qartë për të gjithë se as institucionet e Republikës së Kosovës e as qytetarët e Kosovës nuk kemi dhe nuk kërkojmë aleatë të tjerë. Falë këtij partneriteti vlerash, ne e kemi çliruar, demokratizuar dhe pavarësuar Kosovën dhe tani po ndërtojmë shtetin tonë bashkërisht dhe po e integrojmë në NATO dhe Bashkim Evropian. Dëshiroj t’i siguroj qytetarët e Kosovës se këtë partneritet vetëm sa do të thellojmë, forcojmë dhe kultivojmë edhe më shumë.

Ky partnerit bazohet dhe vizion dhe qëllim të përbashkët dhe nuk i takon politikës ditore apo interesave të ngushta politike ose partiake. Është partneritet strategjik, i ndërtuar me mund nga të gjithë ne, i bazuar në vlera të përbashkëta dhe është i përhershëm apo i përjetshëm. Kurdo që me dashje ose pa dashje synon të vë në pikëpyetje në çfarëdo mënyre këtë partneritet me botën demokratike, do të mund ta rrezikojë seriozisht të

ardhmen e sigurt të qytetarëve të Kosovës. Mirëpo, unë jam i sigurt dhe i bindur se tendencat e tilla do të refuzohen pa asnjë dilemë nga populli i Kosovës dhe gjithë skena politike kosovare.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të ritheksoj edhe një herë se dialogu ndërshtetëror me Serbinë është obligim ndërkombëtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i institucioneve të Kosovës, obligim të cilën e ka pranuar edhe Parlamenti i Republikës së Kosovës. Ky obligim rrjedh nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe nga Bashkimi Evropian, si zbatues i Rezolutës dhe ndërmjetësues zyrtar.

Dialogu është i mbështetur fuqishëm nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe së bashku me Bashkimin Evropian janë garantues të këtij procesi dhe të zbatimit të marrëveshjeve.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërtuar marrëdhënie të shkëlqyeshme mes shteteve fqinje, si me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Është obligim kushtetues dhe i politikës së jashtme të Qeverisë për të gjetur dhe zbatuar zgjidhje për çdo çështje të hapur me fqinjët dhe me shtetet tjera.

Me Maqedoninë kemi përmbyllur me sukses demarkacionin e kufirit, kemi lidhur marrëveshje të ndryshme në fusha të ndryshme dhe nuk kemi aktualisht çështje të hapura.

Me Shqipërinë kemi marrëdhënie të shkëlqyeshme dhe vëllazërore. Për të lehtësuar qarkullimin e qytetarëve të dy vendeve me Shqipërinë, e zbatojmë kalimin e kufirit me letërnjoftime gjatë tërë vitit. Për të lehtësuar edhe më shumë fluksin e pushuesve kosovarë në bregdetin shqiptar, e kemi vendosur një pikë të vetme të kontrollit të përbashkët kufitar.

Me Malin e Zi gjithashtu aplikojmë kalimin reciprok kufitar me letërnjoftim, ndërsa me Maqedoninë është iniciuar procedura e njëjtë.

Pavarësia e Kosovës ka stabilizuar rajonin, i cili kurrë nuk ka qenë më paqësor se tani. Marrëdhëniet tona fqinjësore janë të shkëlqyeshme dhe të vlerësuara lartë nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Fqinjësia e mirë është parakusht kryesor për t'u bërë pjesë e familjes euroatlantike.

Edhe unë, si kryeministër i Kosovës, kam marrë besimin e qytetarëve të Kosovës dhe të këtij Kuvendi pikërisht për shkak të vizionit për integritet euroatlantike. Ky vizion dhe qëllim për mua dhe qytetarët e Kosovës mbetet qëllimi i vetëm që ta ndjekim pa asnjë hezitim. Ndërsa, nëse ndonjëri nga ju ka ndonjë qëllim tjetër, atëherë është mirë që botërisht qytetarët e Kosovës ta dinë.

Kërkesa për pezullim të dialogut si vlerë edhe e popullit tonë dhe vlerë euroatlantike, është kërkesë për izolim ndërkombëtar të Kosovës, është kërkesë për konfrontim me Bashkimin Evropian, NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Deputetë të nderuar,

Natyrisht se raportet me fqinjin verior, Serbinë, janë specifike dhe komplekse. Mirëpo, ato nuk duhet të shndërrohen në beteja politike ditore për të shënuar kinse poenë politike ose për interesat e ngushta partiake. Secili nga ne është dëshmuar dhe ka pasur mundësi të dëshmohet në përpjekje për liri, për demokratizim dhe pavarësi edhe në periudhën e pushtimit nga Serbia në Kosovës dhe përpjekjet tona për liri dhe çlirim.

Opozita është një pjesë e sistemit politik dhe ka për obligim për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve të gjithë qytetarët e Kosovës dhe jo të bëjë të kundërtën. Edhe unë kam qenë në opozitë kur kemi filluar dialogun me Serbinë, po iu kam bashkangjitur institucioneve të Republikës së Kosovës për të pasur një qasje të përbashkët unike, politike, institucionale dhe gjithë qytetare.

Problemet e grumbulluara nga lufta dhe pasluftë janë të mëdha dhe kërkojnë zgjidhje, flas për periudhën 2004 – 2007, procesin e Vjenës.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka hyrë tash në këtë dialog ndërshtetëror për çështje teknike, si shtet, dhe është duke u sjellë si i tillë. Për herë të parë institucionet dhe zyrtarët e Kosovës ulen në nivel të barabartë me zyrtarët e Serbisë, si përfaqësues të shtetit të Kosovës. Ky është dialog, pra, i palëve të barabarta dhe kështu do të jetë sot dhe do të jetë nesër, por edhe në të ardhmen.

Dialogu do të ndihmojë në gjetjen e zgjidhjeve të problemeve praktike që rëndojnë mbi supet e qytetarëve në shtetin e Kosovës. Askush nuk ka të drejtë të ikë nga zgjidhja e problemeve të qytetarëve. Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë me përgjegjësinë më të lartë t'i kryej obligimet e veta kushtetuese dhe ligjore, por edhe obligimet ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Perspektiva evropiane e Kosovës tanimë është e qartë dhe e garantuar si kurrë ndonjëherë më parë. Kjo më është konfirmuar edhe nga baronesha Ashton, në takimin që kisha në Bruksel, dhe në emër të të gjitha vendeve të Bashkimit Evropian. Perspektiva euroatlantike dhe miqësia e përjetshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është konfirmuar edhe ditë më parë nga zëvendëssekretari i shtetit, zoti Bërns, në takimin që e kam zhvilluar në Dubrovnik. Dhe në këtë dialog të vlerave euroatlantike dhe zgjidhjes së modeleve evropiane, sot Kosova e ka mbështetjen e plotë apo ky proces e ka mbështetjen e plotë të të gjitha vendeve të Bashkimit Evropian, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të NATO-s dhe të gjithë fqinjëve.

Edhe Serbia do të ketë perspektivë evropiane, por asaj i është bërë e qartë se nuk mund të pengojë rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian dhe nuk do të ketë kurrfarë vetoje dhe nuk do të bëhet kurrë anëtare e Bashkimit Evropian pa e pranuar pavarësinë e Kosovës.

Dialogu teknik është fillimi i fundit të procesit ku të dyja vendet, si Kosova, ashtu edhe Serbia, si dy shtete të pavarura të njohura reciprokisht do t'i bashkohen familjes së madhe evropiane.

Të nderuar deputetë,

Tri marrëveshjet e para apo konkluzionet e para kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes, librat amzë dhe pranimin e diplomave universitare, janë konkluzione të përbashkëta. Në të tri këto konkluzione qytetarët e Kosovës do të kenë benifite konkrete praktike. Objektivi ynë është që qytetarëve të Republikës së Kosovës t'u sigurojmë qarkullim të lirë me dokumente të Republikës së Kosovës në tërë rajonin dhe në Evropë. Ne jemi duke finalizuar përgatitjet për marrjen e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave së shpejti, sepse është e papranueshme që qytetarët tanë të jenë të izoluar dhe të bllokuar.

Librat amzë do të plotësojnë një kusht ndër më kryesorin të Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave dhe procesi i dialogut është duke ecur paralelisht me procesin integruar evropianë.

Pranimi i diplomave do t'u ndihmojë mijëra studentëve dhe nxënësve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit që të studiojnë lirshëm në Universitetin e Prishtinës dhe t'ju njihen diplomat dhe të gjejnë punë në tërë rajonin pa pengesa. Unë jam takuar disa herë me përfaqësuesit legjitim të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit dhe i kam dëgjuar kërkesat dhe ankesat e tyre. Unë i falënderoj shumë për mbështetjen e tyre që i kanë dhënë këtij procesi.

Qe 12 vite është penguar komunikimi dhe qarkullimi i lirshëm midis familjeve shqiptare andej e këndej kufirit. Kjo ka marrë fund dhe raportet e Kosovës me Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovcë vetëm sa do të thellohen dhe do të shtohen.

Të nderuar deputetë,

Para vetes keni edhe tekste të plota të konkluzioneve të përbashkëta, si dhe platformën e Qeverisë së Republikës së Kosovës për dialogun teknik. Unë kam kërkuar edhe më herët, edhe sot dhe kurdo që të jeni të gatshëm, jam i gatshëm ta diskutojmë platformën, nuk e keni kërkuar një gjë të tillë, por përsëri edhe sot, nëse ju jeni në dispozicion, jam i gatshëm ta prezantoj, ta diskutojmë, ta plotësojmë nëse keni ndonjë ide.

Dëshiroj të ritheksoj se dialogu teknik bazohet në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila përcakton qartë vijat e kuqe të Republikës së Kosovës, por të Bashkësisë Ndërkombëtare. Ato bazohen në parimin e reciprocitetit ndërshtetëror dhe të raporteve ndërshtetërore dhe nuk do të ketë lëvizje nga këto vija të kuqe në asnjë rrethanë dhe këto vija të kuqe i ka vu Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ju i keni përkrahur dhe ju falënderoj.

Përmes konkluzioneve të para, ne do të integrojmë edhe më shumë komunitetin serb, sidomos në veri të vendit, do të shpërbëjmë strukturat paralele dhe do të vendosim autoritetin legjitim të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Konkluzionet e arritura nuk e vejnë në asnjë mënyrë në pikëpyetje integritetin, sovranitetin dhe pavarësinë e vendit. Pohimet se gjëja këto marrëveshje zhvlerësojnë shtetin e Kosovës, janë të paqëndrueshme dhe amatoreske. Unë kërkoj që të debatojmë me qëllimin më të mirë, që t'i ndihmoni këtij procesi në ushtrimin e pushtetit, natyrisht, të Qeverisë së Kosovës, të gjitha kompetencat e veta ekzekutive të politikës së jashtme me të gjithë fqinjët. Unë falënderoj sidomos Komisionin për Integritet, që kanë krijuar një frymë shumë të mirë bashkëpunim për perspektivën e përbashkët euroatlantike.

Unë nga ju, të nderuar deputetë, pres përkrahje të plotë për politikën e fqinjësisë së mirë me të gjitha shtetet e rajonit. Pres përkrahjen tuaj për thellimin e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto janë pritjet e mia nga ju, si përfaqësues të qytetarëve të Republikës së Kosovës, këto janë pritje që kanë qytetarët e Republikës së Kosovës nga ju. Qytetarët e Republikës së Kosovës nuk kërkojnë dhe nuk dëshirojnë izolim dhe nuk e meritojnë.

Qeveria e Republikës së Kosovës në asnjë formë nuk mund të lejojë që këto pritje të mos përmbushen dhe, për pasojë, Kosova të humbas aleatët e vetë, të humbas besimin e partnerëve ndërkombëtarë dhe, për pasojë, të përfundojë në një izolim. Kjo është e papranueshme dhe nuk do të ndodhë në asnjë rrethanë. Prandaj, ju inkurajoj që në këtë debat konstruktiv të jeni në shërbim të avancimit të vlerave euroatlantike, të cilat janë përqaftuar një herë e përgjithmonë nga qytetarët e Kosovës.

Unë falënderoj për durimin tuaj dhe vëmendjen tuaj dhe në vazhdim të seancës jam në dispozicionin tuaj për të dhënë detaje të hollësishme për përmbajtjen e konkluzioneve të arritura. Por, edhe një herë ju ftoj edhe miqësisht, edhe si kryeministër i Kosovës, që politika ditore të mos ndikojë në proceset madhore të forcimit dhe të konsolidimit të shtetit tonë.

Unë i dëgjova edhe parafolësit, mirë e kishe shkruar përsëri fjalimin, Ismet, dhe mirë e ke lexuar kësaj radhe, por minutat që t'i dha Ekremi, nuk janë edhe ... Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Beqiri e ka kërkuar fjalën, për replikë.

ISMET BEQIRI: Unë nuk e kam ndërmend të vazhdoj, sepse dëshira e zotit Thaçi është kjo. Unë nuk jam Ismet, për ty, unë jam deputet i Parlamentit, por faleminderit sepse kështu e kultivon gjithmonë qasjen, nuk është ndonjë problem ajo punë, nuk e kam ndërmend domethënë të hy në polemika, se këtë dëshirë e keni ju, të devijoni gjithmonë atë për çka është esenca e takimit dhe po më duket vërtetë e pakuptueshme, të mos them edhe diçka më keq, kjo tendencë e juaja. Unë jam kryetar i Grupit Parlamentar dhe jam deputet dhe mos u merr me atë kush kujt ia shkruan, sepse po dilni qesharak, më së buti ta them. Unë nuk e thashë tash kush ua ka shkruar juve. Me të vërtetë ka shumë jo seriozitet dhe nëse e keni ndërmend ta shndërroni këtë parlament me kësi qasje, veçmas karshi deklarimeve të mia, vërtet po habitem, po është problem i juaj. Por, edhe një herë

po ta përsëris, për të satën herë, unë asnjëherë nuk i shkruaj fjalimet për qejf tëndin, ato ti shkruajnë ty, se ashtu ke qejf edhe ashtu edhe paraqitesh, zoti kryeministër i Republikës së Kosovës. I tillë je dhe vazhdo, është problem i juaj, e sa për miqësi e këto, u tha edhe nga parafolësit, dihet kush i ka filluar miqësitë edhe me SHBA-të, edhe me BE-në, nuk dëshiroj ta zgjas më tutje. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit!
Kryeministri, kundër replikë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari dhe i vlerësuar zoti kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri, Çështja është shumë e thjeshtë, a jeni për dialog, si parti, apo jeni kundër? Kjo është pyetja që shtrohet dhe të mos krijohet konfuzion i panevojshëm në opinion. Gjithashtu, këtu u dëgjua edhe opiniononi se thirrja për ruajtjen e miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është sikur thirrje e Titos për rrualtjen e Jugosllavisë së vëllazërim – bashkimit. Ky është gabim trashanik dhe është një vlerësim shumë i rrezikshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputetët sipas radhës. Zoti Gjini, replikë.

ARDIAN GJINI: Zoti kryeministër,
Rruga për t'i thirr miqtë ndërkombëtarë sa herë ke nevojë për të bërë politika të këqija, është ekzakt rruga e kundërt e ndërtimit të miqësisë. Sa herë ta kesh zor, ti i thirr amerikanët edhe evropianët edhe thua - për shkak të atyre po e bëj. Kjo është rruga e kundërt e ndërtimit të miqësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Thaçi e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë, realisht, përsëri me dy shefat e grupeve parlamentare të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotit Ismet Beqiri dhe kryetarit të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Ardian Gjini, realisht pajtohem që për dialog partia e juaj njihet dhe vlerësohet, por komplet është një shkëputje e asaj trashëgimie nga filozofia e ish presidentit Rugova.

Tash, zoti Gjini, ju thoni që kryeministri kërkon mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Evropian e NATO-s sa herë që jemi në zor. Realisht, edhe si popull, edhe si politikë kemi kërkuar gjithmonë mbështetje dhe është fat që e kemi merituar, do të duhej shqetësuar nëse do të kërkonim injorimin, dikush mund të pretendojë, apo ndonjë konfrontim dhe për mua thirrja për partneritet e për mbështetje dhe kjo mbështetje që është institucionale si kurrë ndonjë vend tjetër në rajon apo ndonjë vend tjetër, është vlerë e jona dhe duhet çmuar dhe jo të shihet si diçka e rrezikshme që Kosova e ka mbështetjen e SHBA-ve, të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s. E kemi kërkuar thirrjen apo mbështetjen e SHBA-ve, të Bashkimit Evropian, të NATO-s prej vitit '90, e kemi kërkuar në vitin '98, e kemi kërkuar në vitin '99, e kemi fituar dhe merituar atë mbështetje me bombardime dhe kemi fituar lirinë. Kemi bashkëpunuar dhe ju që të dytë keni qenë, Ismet ke qenë, por zoti Gjini ka qenë në dialogun e Vjenës. Kemi

bashkëpunuar shumë ngushtë edhe me SHBA-të, edhe me Bashkimin Evropian, edhe ju personalisht. Prandaj, të qenit në opozitë apo pushtet dhe menjëherë ky transformim i vlerave dhe të shihet rrezik bashkëpunimi me SHBA-të dhe Bashkimin Evropian, është antihistorike dhe jo vizionare për politikën dhe është në kundërshtim të plotë me vullnetin e qytetarëve të Kosovës. Po kërkon konkluzionet e kësaj seance, urdhëroni, deklaroni, jeni kundër dialogu, deklarohuni!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYESUESI: Unë kisha sugjeruar që ta vazhdojmë debatin. Mirë, zoti Beqiri, replikë.

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues, po të lus, së pari ju duhet t'ia ndaloni kryeministrit mos të provokojë dhe ky po sillet si provokator. E para, po ju lus, rendi i ditës është i caktuar dhe ky është i njohur për devijim të asaj çka është në rend të ditës. Po ju lus, lëreni LDK-në, nëse je bë merak, mund të anëtarësohesh, por këqyrin a i plotëson kushtet për të ardhur a jo! Ndërkaq, filozofia politike dhe qasja juaj, zoti Thaçi, ndaj Ibrahim Rugovës është e njohur dhe këto nuk fshihen. Po të lus, mos provokoni, sepse është rendi i ditës së seancës. Unë nuk do ta marrë më fjalën, sepse kolegët kanë për të diskutuar për pikë të rendit të ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë, vetëm desha të them që Rregulloren e kemi miratuar me vota dhe kjo rregullore që e kemi miratuar bashkë, unë jam i detyruar për ta zbatuar. S'mund t'ia marrë fjalën asnjëherë kryeministrit, sepse ia jep rregullorja. Zoti Thaçi, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari zoti kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri, Ju u paraqitët këtu si iniciues i kësaj seance të jashtëzakonshme për debat krahëhapur...

(Reagim)

Mirë de, në emër të gjithëve u paraqite fillimisht edhe në tri grupet, por u paraqite në emër të gjithëve, kështu që plotë krahëhapur dhe me ballin lartë.

Unë e vlerësoj këtë debat dhe sinjerisht çdo pyetje, çdo çështje që ju mendoni që ia vlen për t'u diskutuar, jam i gatshëm ta diskutoj.

Vlerësimet e mia nuk janë provokime. Unë kam të drejtë të vlerësoj, kam drejtë të mendoj, qysh keni të drejtë edhe ju të mendoni edhe të vlerësoni, porse si parti, nëse jeni kundër dialogut, definitivisht e ritheksoj edhe një herë, komplet është një devijim nga trashëgimia e vlerave të dialogut të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe fqinjësisë së mirë që e ka pasur edhe më herët, e filozofisë së presidentit Rugova. Ndërsa, sa iu përket partive, ju e dini Ismet, në vitin 2007, ju keni ardhur, vetë keni zhvilluar fushatë për ne, kundër kryetarit të komunës së Prishtinës.

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Zoti Beqiri, ju vetë po thoni t'ia marrë fjalën, prapë po doni ju. Vazhdoni, zoti Beqiri e ka fjalën!

ISMET BEQIRI: Zoti Thaçi,

Se je provokator, edhe atë super provokator, e dëshmuat në fund. Se kush ka bërë propagandë, për atë e ke rezultatin në Prishtinë. Po ta përsëris edhe një herë, lëre Prishtinën, kurrë zgjedhjet s'ke për t'i fituar, e kush ka bërë propagandë, dihet ajo. Unë jam shumë i lumtur se të kanë treguar votat edhe në Kodër të Trimave, në krejt Prishtinën, të kanë treguar edhe më 2007, edhe më 2009 zgjedhjet lokale. Lëri këto, se këto cinizma nuk të pinë ujë. Harroje Prishtinën, sepse ju se meritoni ta qeverisni Kosovën, e lëre më Prishtinën!

KRYESUESI: Zoti Thaçi e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe i vlerësuar zoti Ismet Beqiri,

Ju e dini se në vitin 2007, bile edhe para se të caktohet kandidatura e Prishtinës, ju kam treguar që nuk do të jeni kandidat dhe ju e dini dhe kam dëshmitarë. Në anën tjetër, ju e dini se, realisht, tash mos më keqkupto, por jo provokim, ju e dini që keni zhvilluar një fushatë shumë aktive dhe dinamike për Partinë Demokratike të Kosovës në vitin 2007. Është mirë që LDK është e hapur dhe je rikthye, besa edhe të ka vlerësuar shef të grupit parlamentar dhe këtë unë e vlerësoj, por sido që të jetë, ke zhvilluar një fushatë shumë aktive, dinamike dhe të falënderoj, të falënderoj publikisht. Faleminderit, shumë! Po, ndoshta edhe i humbëm se ishte me ne! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Vazhdojmë me debatin. Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,

Kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni fillimisht të duartrokas për Lëvizjen "Vetëvendosje" e cila arriti që ta homogjenizojë opozitën rreth programit dhe ideve të saja refuzuese për çfarëdo që bën Partia Demokratike dhe Qeveria.

Nuk më kanë befasuar këto sjellje të Lëvizjes "Vetëvendosje" dhe të liderit të saj për të ndërprerë bisedimet pa dhënë ndonjë alternativë, por më befason sjellja e pjesës tjetër të opozitës dhe solidarizimi i tyre në këtë pikë me të vetmin qëllim që të ndërpriten këto arritje të përbashkëta Qeverisë së Kosovës dhe të miqve ndërkombëtarë për perspektivën e Kosovës dhe interesave praktike të qytetarëve të Republikës sonë.

Në vend që ne sot të aprovojmë ligjet që u sjellin të mira qytetarëve, ne këtu bisedojmë për të hapur vrima në ujë, me të vetmin qëllim që të krijojmë një opinion negativ dhe një imazh të krizës. Pra, propozuesit e kësaj seance pa ditur çka të bëjnë, bëjnë rrethrotullimin, duke e parë vetveten, përpara se të shohin interesat e qytetarëve të vendit dhe votuesve që na kanë sjellë këtu, i harrojnë qytetarët kur kanë nevojë më së shumti.

Shtrohet pyetja - pse frikësohen këto zotërinj, pse kundërshtojnë, pse thonë se ra morali dhe identiteti shtetëror i Kosovës, pse thonë se Kosova nuk ka identitet? Të shkojmë me radhë.

Para dy dite, ditën e martë, në Republikën e Maqedonisë, në pjesën lindore ushtarët e Kosovës morën pjesë bashkë me ushtarakët e disa shteteve. Ata demonstruan se ne jemi të barabartë dhe se jemi garantues të paqes dhe stabilitetit rajonal. Për çudi, për këtë ngjarje askush nuk tha asnjë fjalë urimi a morali për këta djem dhe vajza. U kalua në heshtje kjo performancë e krenarisë dhe e shtetit tonë. Sikur të bëhej fjalë për ndonjë aktivitet sportiv të ndonjë lagjeje, e jo për ushtarët e shtetit tonë. Kjo trupë është vazhdimësi më besnike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e trupave mbrojtëse të Kosovës dhe sot FSK-së. Pse po e pengon kjo opozitën? Po atë ditë, por në pjesën perëndimore të Maqedonisë, 4 presidentë të 4 shteteve të rajonit, duke përfshirë edhe Presidenten e Republikës së Kosovës, morën pjesë në një samit rajonal dhe aty u ekspozua qartë dhe fuqishëm shteti i Kosovës. Për çudi, as për këtë ngjarje opozita nuk tha asnjë fjalë për të vetmen. Shtrohet pyetja - pse? Po atë ditë, në Prishtinë, grupi i lartë më vendimmarrës për rajonin, biseduan me kryeministrin Thaçi dhe Qeverinë për të arriturat e deritashme që u vlerësuan pozitivisht, gjithmonë duke dhënë udhëzime për kujdes financiar, që është normale për të gjitha shtetet në këtë kohë krizash globale e financiare. Në atë takim përfaqësuesi ICO-s e pranon se ka ardhur koha që ai të shkojë dhe Kosova të ecën vetë drejt integriteteve evropiane dhe atë ditë askush prej opozitës nuk e tha asnjë fjalë të vetme. Shtrohet prapë pyetja - pse? Po atë ditë u takuan në Uashington baronesha Ashton dhe Sekretarja e Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Hillary Clinton, vizituan, biseduan dhe vlerësuan lartë të arriturat në Kosovë, garantuan për Kosovën, perspektivën evropiane. Për çudi, as për këtë ngjarje askush prej opozitës nuk e çeli gojën, nuk e dhanë asnjë koment. Shtrohet tash për të satën herë pyetja – pse? Pse heshten gjithë këto zhvillime pozitive për shtetin tonë? Kurse po atë ditë, një analistë na thërret për moral dhe humbje të identitetit shtetëror, pas arritjes së konkluzioneve me palën serbe. Tha se kjo Qeveri është në krizë dhe se lidhshipi gjithashtu gjendet në një krizë. Duke lexuar këtë artikull, më shkoj buza në gazë. Pse - do të pyesni ju. Pse kur unë isha student i përjashtuar nga Kosova, ky analist me disa deputetë të tjerë të asaj kohe na thërrisnin neve që të bashkohemi rreth ... dhe ta shpëtonim Jugosllavinë, që ta shihnim shpëtimin në Jugosllavi, çfarë misioni i rrezikshëm i asaj kohe! Tash, me vete, duke lexuar shkrimin e tij, them goxha ka evoluar ky njeri pas 20 vjetësh, gati vetja po më duket tradhtar përballë tij.

Të njëjtët sot bëjnë piramida informative dezinformuese për të krijuar opinione me yje e xixëllonja të tyre, që përmes klubeve arsyetojnë financimet e veta.

Unë po pyes prapë, pse kundërshtohen të gjitha këto të arritura që kanë ndodhur? Pse nuk po respektoni rezolutën për bisedime të aprovuara në këtë Kuvend, ku detyrimet kushtetuese të Qeverisë nuk kanë nevojë që të vinë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sepse janë obligim kushtetues të Qeverisë. Këto ishte dashur të vinin vetëm ato çështje që prekin integritetin dhe sovranitetin e vendit, dhe kjo nuk po ndodhë që të kërkohet me këmbëngulje se është duke u rrezikua integriteti. Kjo nuk ka ndodhur deri më tash, përndryshe edhe lideri i “Vetëvendosjes” mund të shkojë tani të udhëtoj në Mal

të Zi me letërnjoftim. Madje mund që edhe të vazhdojë në Serbi, tash të udhëtojë me letërnjoftim dhe atje të japë intervista para gazetarëve, por këtë herë jo nga burgu, por nga ndonjë restorant dhe t'ju flet atyre për çështjen kombëtare.

Unë po pyes, pse dyshoni në vërtetësinë e librave kadastral dhe atyre amzë, kur vërtetësia e tyre do të garantohej nga ekspertët e Bashkimit Evropian edhe ata lokalë të të dyja shteteve. Këto dokumente do të jenë të mjaftueshme që në këtë fazë të kryejnë punë. Edhe Serbia ka problemet e saja, të nderuar deputetë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës. Ajo tashmë ka shkelur kushtetutën, sepse qartazi kishte deklaruar se kurrë nuk do të bisedojë me palën e Kosovës, por ja që ndodhë edhe po ndodhë, sepse përndryshe do të rrezikonte izolimin total. Pyetjet, pse dyshohet në ekuivalentimin e diplomave të studentëve shqiptarë të Luginës, të cilët nuk gjejnë punë për shkak të këtyre problemeve në Preshevë, Medvegjë, Bujanovc dhe janë të detyruar të ikin nga vendi, derisa çudia është që këtu të thuhet - po mendojmë për ta, për perspektivën e tyre e tjera demagogji të vërteta. Pse do të dyshoni nesër që Elektroprivreda e Serbisë nuk do të guxoj të operojë në Kosovë, por vetëm KEK-u? Pse nesër do të dyshoni që Telekom Serbia ose do të respektojë shtrirjen territoriale dhe prefiksi ynë do të lirohet shpejt? Pse do të dyshoni nesër në prezencën e NATO-s në Serbi, do t'ju pengojë misioni i saj paqeruajtës apo jeni të interesuar të ekzistojë territori i hallakatur dhe i çoroditur i Serbisë? Pse do të dyshoni nesër t'ju pengojë prezenca e Bashkimit Evropian në Serbi, a do të jetë për ne më mirë apo më keq, apo Serbia të lihet në influenca tjera, të cilat do ta ndjellin keq kundër perspektivës sonë. Pse këtu një pjesë e opozitës raportin e Dick Martit nuk kërkuan ta diskutojnë në parlament për qëllimet e tija, planet e tija, por përkundrazi ka individë këtu dhe parti që sponzoruan dhe e përkrahën me qëllim që të rrënojnë ato që kemi si shtet dhe lidhshëm? Pse opozita është në gjendje të mbajë nga një seancë të jashtëzakonshme çdo ditë për tema e jo për ligje, që është kusht për integrimin euroatlantik?

Ka shumë pse për pozitën e opozitës, por pse-ja më e madhe nganjëherë është dhe të pyesim veten nganjëherë a mos jemi gabim dhe a mos kemi zënë vendin e dikujt që ndoshta do t'i qaseshin çështjes më mirë, më profesionalisht se sa që jemi këtu, sepse qytetarët na votuan të punojmë për t'ua lehtësuar problemet e grumbulluara një dekadë, të rrisim ekonominë, perspektivën, e jo të na dëgjojnë këtu në frustrime personale e politike, mjaftë kish thanë me vetvete, sepse i kemi lodhur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Skender Hyseni, e ka fjalën.

SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar, kryeministër,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që pa humbur kohë të them se dialogu në përgjithësi, po në këtë rast dialogu me Serbinë është instrument i pazëvendësueshëm i zbutjes së dallimeve dhe instrument i pazëvendësueshëm për normalizimin e marrëdhënieve me këtë shtet dhe, në këtë, Lidhja Demokratike e Kosovës nuk e ka asnjë dilemë, që dialogun nuk e zëvendëson asgjë. Alternativë e dialogut është dhuna dhe patjetër që Lidhja Demokratike e Kosovës

fuqimisht e refuzon dhunën ndërshtetërore për arritjen e marrëveshjeve ndërshtetërore, po e theksoj, për arritjen e marrëveshjeve ndërshtetërore.

Dhe, nëse dialogu është synim i normalizimit të marrëdhënieve, siç u tha, dhe unë e mbështesë fuqimisht këtë. Kam frikë të madhe që ky synim, ky qëllim është diskredituar dhe lënduar që në start, sepse në vend që të ishte një fillim i vështirë, por i mirë i normalizimit të marrëdhënieve Kosovë – Serbi, delegacioni i Kosovës në këto bisedime është përcaktuar për një fillim të lehtë, por shumë të keq të normalizimit të marrëdhënieve, duke bërë koncesione të papranueshme në dëm të sovranitetit dhe të karakterit unitar të Republikës së Kosovës. Po, dialogu është obligim, përpos tjerash është edhe obligim ndërkombëtar i Republikës së Kosovës dhe Republika e Kosovës nuk e ka asnjë arsye që ta refuzojë një obligim të tillë ndërkombëtar. Përkundrazi. Mirëpo, bërja e koncesioneve në dëm të sovranitetit të Republikës së Kosovës nuk është obligim ndërkombëtar dhe nuk guxon të ndodhë. Pse duhet të pezullohen këto bisedime dhe unë i bëjë thirrje Qeverisë së Republikës së Kosovës që ta shqyrtojë në maturinë dhe esullinë më të madhe të mundshme këtë propozim.

Ishin 10 parime prijëse ose parime udhëheqëse të cilat u dakorduan edhe me pëlqimin e Kosovës, para fillimit të procesit të Vjenës. Dhe një nga ato parime udhëheqëse ishte që çfarëdo zgjidhje në fund për çështjen e Kosovës duhet të respektojë pa tjetër vullnetin politik të popullit të Kosovës. Ndërkaq, ky proces kaq i rëndësishëm ka filluar totalisht i papërgatitur dhe një minimum që është dashur të bëhet, do të ishte që Qeveria e Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me pesëshen: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Francën, Italinë, Gjermaninë dhe Britaninë e Madhe të ulet dhe të përcaktojë një sfond parimesh udhëheqëse, kriteresh bazike, kriteresh themelore të cilat do të ishin korniza e zhvillimit të këtij dialogu. Në vend që të ndodhë krejt kjo, këto ditë kemi parë gjithçka, por s’e kemi parë atë që duhej ta shihnim.

Unë po marr dy tre shembuj. Përpjekje evidente për të mashtruar opinionin, kryesuesja e këtij delegacioni thotë - do të ketë reciprocitet te tabelat e regjistrimit. Unë pyes, reciprocitet me kë, me strukturat paralele serbe që veprojnë në Serbi si Kosovë e Metohi, e që lëshojnë targa PR, KM, targa të vjetra të Kosovës? Nuk ka reciprocitet me Republikën e Serbisë këtu. Nëse ka reciprocitet, atëherë ka me struktura të paligjshme, sepse ne nuk do t’i lejojmë ata të hyjnë më në Kosovë me PR, ndërkaq ata s’do ta lejojnë Kosovën të hyjë andej pari me atë që është atribut shumë i qartë i shtetësisë dhe i sovranitetit të Kosovës me tabela RKS dhe ky është lëshim, koncesion totalisht i papranueshëm.

Të nderuar deputetë,

Unë ju garantoj nuk bëjë politikë në këtë temë, mirëpo kjo shkon ndesh edhe me një sanksionim të fuqishëm të shtetësisë së Kosovës, që i ka bërë Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Po ashtu, bëhet përpjekje t’i thuhet opinionit në Kosovë që ka reciprocitet, përkatësisht e njëjta formulë është aplikuar në rastin e Kosovës te regjistrat civilë, si te Sllovenia ose te Maqedonia. Kjo është e pasaktë dhe është e pandershme t’i deklaroni opinionit të Kosovës kështu, sepse Republika e Serbisë asnjëherë nuk ka pasur mundësinë as fuqinë ta marrë regjistrat civilë nga Sllovenia ose nga Maqedonia. Bëhet

fjalë për dokumente federale, për kopje të dokumenteve federalë, që eventualisht Serbia mund të ketë insistuar t'i mbajë dhe nëse i duhen Sllovenisë ose Kroacisë ose Maqedonisë, mund të marrë ndonjë kopje.

Pse duhet patjetër që qytetarët e Kosovës të udhëtojnë nëpër Serbi, unë e shtroj pyetje, pse duhet patjetër, pse duhet me çdo kusht? Dhe, më lejoni të përgjigjem. Nuk duhet patjetër dhe nuk duhet me çdo kusht të udhëtojnë nëpër territorin e Republikës së Serbisë, sepse kështu nuk i ndihmohet normalizimit afatgjatë të marrëdhënieve midis dy shteteve. Në këtë mënyrë vetëm i ndihmohet betonimit të një status quoje, e cila do të na rikthehet në të ardhmen e afërt në variantin e saj më të keq të mundshëm. Prandaj, me këto zgjidhje, nuk di çka janë, a janë marrëveshje, dikush i quan konkluzë, kushdo që ka një ide elementare çka janë marrëveshjet ndërshtetërore, ndërkombëtare, i dinë çka janë ato, mirëpo këto zgjidhje janë zgjidhje të këqija dhe, po them, në variantin më të mirë të mundshëm e dëmtojnë rëndë një proces normalizimi midis dy shtetesh, i cili duhet të zhvillohet në afat të gjatë.

Prandaj, kërkesa e Lidhjes Demokratike të Kosovës, në këtë rast, është që të kontaktohet me partnerët kyq të Kosovës, të rishqyrtohet edhe një herë krejt gjendja dhe të krijohet një kornizë e sigurt për Kosovën në këto bisedime. Kosova nuk guxon të shkojë tre hapa mbrapa, Kosova minimumi që duhet ta mbrojë, është atë që e ka sanksionuar atë fuqishëm Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Unë ju falënderoj shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!
Zoti kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryesues, zoti Haliti!
Mua më lejoni që edhe njëherë, duke u zotuar për transparencë të plotë të gjithë këtij procesi dhe gjithë punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, të sqaroj para juve të gjithëve, por edhe para të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës se dialogu mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë ka filluar me rekomandimin edhe të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, vitin e kaluar, kur ka qenë një qeveri e përbashkët Partia Demokratike e Kosovës – Lidhja Demokratike e Kosovës, me pajtimin e plotë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me mbështetjen e plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe thirrjen e tyre, me pajtimin e plotë dhe udhëheqjen e Bashkimit Evropian dhe gjithë miqve tanë ndërkombëtarë. Edhe pozicioni ynë para GjND-së, edhe pas GjND-së, edhe gjatë punimeve të Asamblesë së Përgjithshme kanë qenë veprime plotësisht të koordinuara me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Shtetet e Kuinit, por edhe gjithë miqtë dhe partnerët tjerë ndërkombëtarë dhe kjo gjë tanimë dihet botërisht, ka qenë kështu, është dhe do të mbetet kështu.

Tani, palët janë dakorduar sa i përket lirisë së lëvizjes që kalimi reciprok i kufirit të bëhet me letërnjoftime. Dikush mund të pyes se pse me letërnjoftime? Ne pretendojmë të ndërtojmë një rajon tanimë të paqes, të stabilitetit, të bashkëpunimit rajonal dhe jo të izolimit, jo të telave me gjemba, por të kufijve të hapur të standardit evropian, të lëvizjes së lirë të plotë të modelit evropian. Sot qytetari i Kosovës lëviz, nesër do të lëviz në gjithë rajonin, por edhe në Evropë në një proces të plotë të liberalizimit të vizave. Për çka

thjeshtë po angazhohemi ne për liberalizim të vizave, kur ne kërkojmë të ndërtojmë tash mure me fqinjët. Evropa nuk na pranon duke pretenduar me mentalitet politik të luftës së ftohtë në Bashkimin Evropian, e as me mentalitet të kufijve me tela me gjemba, por të hapjes së kufijve, të lëvizjes së lirë e me letërnjoftim të Republikës së Kosovës qytetari i Kosovës do të lëviz edhe në Maqedoni, edhe në Shqipëri, edhe në Mal të Zi, por edhe në Serbi. Është vullneti dhe nevoja e qytetarit të Kosovës a dëshiron të udhëtojë në Mal të Zi, a dëshiron të udhëtojë në Shqipëri, a dëshiron apo ka nevojë të udhëtojë në Mal të Zi apo përmes Serbisë. Ajo është nevojë, është vullnet personal dhe privat i qytetarit, por këtu hynë edhe lëvizja e mallrave, që është nevojë edhe domosdoshmëri e qytetarit të Kosovës, e institucioneve të Kosovës, e shtetit të Kosovës.

Prandaj, këto janë dy procese paralelisht që janë duke ecur, pra normalizimi i marrëdhënieve me fqinjët, fqinjësia e mirë, që është parakusht i domosdoshëm për liberalizimin e vizave. Askush nga ne mos të pret liberalizim të vizave me mentalitet të ngurtë politik dhe jo të vlerave dhe standardeve euroatlantike apo të shikimit të interesit të politikës ditore, apo të interesit të ngushtë grupor politik, apo të ndonjë partie politike, apo të ndonjë pozicioni të caktuar opozitar, apo ku ta di unë se çka. Kosova është duke ecur me hapa përpara, jo mbrapa. Është duke u konsoliduar dhe forcuar. Edhe dje, zëra zhurmues disfatistë për Kosovën theksonin se Kosova humbi 360 milionë euro. Kosova nuk e humbi as edhe një cent dhe tregohuni dhe merrni kurajën, dilni edhe tregoni sot qytetarit të Kosovës të vërtetën zhurmuese që keni pretenduar të prezantoni më herët. Kosova nuk e humbi as edhe një centë nga Komisioni Evropian dhe mbështetësit tjerë financiarë. Kosova dje fitoi edhe 203 milionë euro nga Komisioni Evropian, dilni dhe pranoni botërisht dhe kjo po ndodh falë qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar, ndërtimit të Kosovës demokratike, vlerave euroatlantike, reformave demokratike që po ndodhin kudo në Kosovë dhe ky realitet duhet të pranohet, jo të injorohet. Ky është realiteti i Kosovës, Kosovës storje e suksesit të plotë që po ndodhë bashkërisht me ndërkombëtarët. Nuk duhet ta shikojmë atdheun tonë nga pozicionet politike, nëse unë sot jam në pushtet, po ndodhë mirë, nëse unë s'jam pushtet, gjithçka është keq. Kjo nuk i ndihmon askujt, as juve personalisht, as subjekteve tuaja politike, e as vizionit tonë euroatlantik. Është fat që deri tani ne kemi pasur, kam besim të plotë, përsëri do të kemi, një konsensus të plotë ndërpartiak dhe ndëretnik për vizionin tonë euroatlantik. Por nuk ecet në vizionin tonë të përbashkët euroatlantik me mentalitet të bllokimit, të izolimit dhe të ruajtjes së raporteve të ngrira.

Është e vërtetë, kemi qenë në luftë me Serbinë, por nuk jemi të vetmit dhe të fundit si vend dhe si popull që kemi qenë në luftë. Ne kemi luftuar për largimin e Serbisë nga Kosova, kjo ka ndodhur. S'kemi luftuar kundër popullit serb, dhe këtë e dini të gjithë. Kemi luftuar për vlerat e lirisë dhe të pavarësisë, por jo të ndalemi këtu ku jemi tani, por të ecim përpara, siç po ecim në të gjitha sferat.

Ne kemi diskutuar edhe me Maqedoninë gjëra po të njëjta teknike, kemi nxjerrë konkluzione të përbashkëta, që janë vlerësuar nga gjithë bota. Edhe me Shqipërinë, edhe sot ka takime për çështje teknike, që vlerësohen nga të gjithë.

Dje u kërkua ndalimi i punimeve të autostradës, unë nuk mund dhe kurrë nuk do të ndërtoj bunker, por autostrada dhe mjetet e taksapaguesve kosovarë do t'i investoj në ndërtimin e autostradave e jo të bunkerëve. Do ta keni të qartë një herë e përgjithmonë dhe ky është dallimi ynë në vizionin tonë politik.

Pra, sa i përket lirisë së lëvizjes, palët janë dakorduar që kalimi reciprok i kufirit të bëhet me letërnjoftime, në rast të kalimit transit në një shtet të tretë. Letërnjoftimet mund të shoqërohen nga një dokument në hyrje e dalje. Sqarim: Kjo është e nevojshme në mënyrë që gjatë kalimit të kufirit tjetër shtetëror, për shembull me Kroacinë, Policia kufitare Kroate ta dijë se hyrja përmes Serbisë është bërë në mënyrë legale. E njëjta procedurë vlen për qytetarët e Serbisë gjatë kalimit transit nëpër Kosovë për në Shqipëri ose Maqedoni. Kosova tashmë e aplikon kalimin e kufirit në Shqipëri dhe Mal të Zi me letërnjoftime. Kjo është praktikë tashmë e njohur.

Qytetarët e të dyja vendeve duhet të blejnë policën e sigurimit kufitar të automjeteve në pikat kufitare, me synimin që të arrihet një marrëveshje për njohjen reciproke të policave të sigurimeve.

Sqarim: Deri më tani automjetet serbe nuk kanë pasur sigurim valid të automjeteve në Kosovë, me ç'rast buxheti i Kosovës është dëmtuar për 1.3 milionë euro, të cilat i ka paguar Banka Qendrore nga Fondi i garancisë së kompanive të sigurimeve në Kosovë për dëmet e shkaktuara me automjete nga serbët.

Përdoret patentë shoferi i Republikës së Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës si masë kalimtare do të vazhdojë vlefshmërinë e targave KS për një periudhë 5 vjeçare.

Sqarim: Me qëllim që t'i eliminojë targat serbe në Kosovë dhe t'i fus gjithë qytetarët e Kosovës në një sistem, kjo masë është paramenduar më shumë për qytetarët serbë të Kosovës, sidomos në veri si fazë kalimtare.

Targat KS mund t'i marrin edhe qytetarët tjerë të Kosovës, është në vullnetin e tyre. Sipas dëshirës, nga 1 nëntori në Kosovë targa valide do të jenë vetëm ato RKS dhe KS. Pra, kanë validitet ligjshmërie të Republikës së Kosovës edhe RKS, edhe KS, është në vullnetin e qytetarëve.

Serbia do t'i lejojë targat KS të hyjnë lirisht në territorin e Serbisë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdojani kryeministrit edhe pak!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Targat RKS përmbajnë simbole shtetërore të Kosovës, të cilat pala serbe ka refuzuar t'i pranojë në territorin e vet për arsye të simbolikës dhe të garantimit të sigurisë së qytetarëve të Kosovës në territorin serb. Në marrëveshje nuk figuron ky refuzim, por aty është instaluar parimi i reciprocitetit, ashtu që Qeveria e Kosovës mund të vendos t'i detyrojë automjetet me targat e Serbisë t'i përdorin targat e përkohshme, edhe pse ato janë lejuar të hyjnë lirisht në Kosovë që nga viti 1999.

Regjistrat civilë. Kosova do t'i marrë kopjet e certifikuara nga EULEX-i, të gjitha librat amë që janë marrë nga Kosova në vitin 1999.

Sqarim: Mbi 80% të atyre librave mungojnë në Kosovë. Pas vitit 1999, Kosova ka ristrukturuar regjistrin civil me dokumente të paplota, ku mungojnë pjesa dërmuese e serbëve të Kosovës. Regjistri i plotë, i sigurt dhe i besueshëm është parakusht, ndër kryesorët nga Bashkimi Evropian për liberalizimin e vizave. Kosova nuk ka hequr dorë nga origjinalet, ato janë pronë e Kosovës dhe Serbia do t'i kthejë ato kurdoherë. Me refuzimi për të dorëzuar origjinalet, Serbia ka njohur Kosovën si shtet me juridiksionin tjetër, sepse nëse do t'i konsideronte si territor të vetin, pse do të kishte problem t'i jepte librat e amzës, që u përkasin komunave të Republikës së Kosovës.

Diplomat. Palët kanë rënë dakord për pranimin reciprok të diplomave universitar dhe shkollorë përmes certifikimit të tyre nga një palë e tretë, një agjencion shkencor evropian ose nga një organizatë ndërkombëtare, por jo UNMIK-u, ose nga ndonjë institucion arsimor.

Sqarim: Kjo marrëveshje do t'u mundësojë studentëve që kanë diploma të Kosovës, sidomos mijëra studentëve nga Lugina e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit që të vazhdojnë studimet ose të punësohen në Serbi dhe, e kundërta, sipas të gjitha gjasave, certifikimi do të bëhet nga ndonjë institucion i rëndësishëm shkencor evropian.

Gjithashtu, është eliminuar mundësia që UNMIK-u të bëjë këtë certifikim. Ky certifikim vlen edhe për diplomat të lëshuara në Serbi, është reciproke.

Sa i përket nënshkrimit ose jo të këtyre konkluzioneve të përbashkëta, një element tjetër që sinjerisht ndonjëherë është edhe shqetësuese kur dëgjohet pa asnjë argumentim, që kanë përdorur zëra të ndryshëm kundër këtyre konkluzioneve, është çështja e mosnënshtrimit të marrëveshjeve nga pala kosovare dhe ajo serbe.

Për më tepër, mos nënshkrimin e tyre kanë cilësuar si zhvlerësim të shtetësisë. Kjo nuk qëndron fare, për të gjithë ata që kanë njohuri elementare të së drejtës ndërkombëtare, mund ta kuptojnë një gjë të tillë, prandaj më lejoni të sqaroj se dy shtete që nuk e njohin njëra- tjetrën, nuk nënshkruajnë marrëveshje ndërshtetërore. Në rastin tonë, të dy palët janë përgjegjëse, edhe shteti i Kosovës, edhe i Serbisë para Bashkimit Evropian për zbatimin e këtyre konkluzioneve, që është edhe më e fuqishme se sa nënshkrimi bilateral dhe përkrahja e plotë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që është ndërmjetësi Bashkimi Evropian ai që garanton zbatimin e këtyre marrëveshjeve dhe mbështetja e plotë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Platforma e qeverisjes, e cila na është sjellë tash, është një dokument shumë i dobët, por edhe kështu i dobët, siç është, ai është shkelur qysh në titull. Thuhet: "Platforma e Qeverisë së Republikës të Kosovës për dialogun teknik ndërshtetëror midis Republikës së

Kosovës dhe Republikës së Serbisë”, mirëpo dialogu nuk ka qenë teknik, nuk ka qenë ndërshtetëror dhe nuk ka qenë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, për shkak se këtë gjë na e dëshmojnë pikërisht këto tri konkluzione të dakorduara. Pra, konkluzionet na e dëshmojnë se nuk ka qenë i këtillë dialogu.

Në faqen 3 të kësaj platforme, thuhet që “dialogu teknik ndërshtetëror” edhe një herë “midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, është konform Rezolutës së Asamblesë të Përgjithshme të OKB-së, të datës 9 shtator 2010”. Mirëpo, kjo rezolutë nuk e quan dialogun as teknik, as ndërshtetëror dhe as ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Tash pra platforma bie në kundërshtim edhe me vetë Rezolutën e OKB-së, të cilës i referohet si pikënisje dhe si obligim ndërkombëtar.

Në të njëjtën faqe thuhet se “...me këtë dialog ne synojmë zgjidhjen e çështjeve teknike që kanë rënduar marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë që nga periudha e luftës”. Marrëdhëniet e rënduara nuk janë për shkak të çështjeve të pazgjidhura teknike, por politike. Mandej, “...duke gjetur zgjidhjet, Kosova do të përshpejtojë realizimin e synimeve të saj evropiane dhe euroatlantike”. Vetëm me zgjidhje të çështjeve teknike nuk ecet para, sepse problemet janë politike. Ne s’ kemi ngecur teknikisht, por para së gjithash kemi ngecur politikisht.

Mandej, “Dialogu teknik midis Kosovës dhe Serbisë do të konsolidojë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës”. Kjo është një fjali shumë e rëndësishme, për shkak se Qeveria e pranon që pavarësia dhe sovraniteti na qenkan të pakonsoliduara, e mandej kjo vjen në kundërshtim me faktin që thuhet: “nuk do të cenohen”.

Serish në faqen 3, ky dialog pra “...do ta bëjë përshpejtimin e integriteteve evropiane dhe euroatlantike”. Nuk mund të jetë problemi te shpejtësia për diçka që realisht s’ka filluar. Deri më tani, ne s’ kemi pasur proces të integritetit të Kosovës në BE, por proces të integritetit të BE-së në Kosovë, më herët, në formën e Shtyllës IV të UNMIK-ut dhe tash në formën e EULEX-it. Pra, sfidat dhe vështirësitë janë qysh të integrohet BE-ja në Kosovë, jo Kosova në BE, se ajo nuk ka filluar ende, duke qenë se 5 shtete nuk na njohin.

Në faqen 4, “...duke krijuar marrëdhënie të fqinjësisë dhe bashkëpunimit të mirë me të gjitha shtetet fqinje...” Të gjitha shtetet fqinje s’ janë kurrësi të njëjta për t’i futur në një thes. Kjo platformë i barazon: Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Serbinë, si shtete. Ky mund të jetë pikëvështrimi i Brukselit ose i Nju Jorkut, por jo edhe i Kosovës.

Gjatë tërë kësaj platforme, vazhdimisht thuhet “dialog teknik”, e rrallë “çështje teknike”, thuaj se e pavetëdijshmja e Qeverisë tregon që çështjet që bisedohen, pra temat e dialogut, janë politike, por karakteri i dialogut është teknik, sepse po bëhet fjalë për dialog, i cili siç thuhet, është teknik, apo jo? Ky dialog teknik, nënkupton që dialogu politik tashmë ka përfunduar. Pra, po bëhet dialog teknik, sepse është kryer dialogu politik dhe ai dialog politik, kanë qenë takimet e kryeministrit Thaçi me baroneshën Ashton dhe këshilltarin e saj Robert Cooper, në vjeshtën e vitit të kaluar. Ai ka qenë

dialogu politik, sepse atje i kanë përcaktuar temat e bisedimeve, temat e dialogut, kanë përcaktuar renditjen e atyre temave, që të gjitha ato çështje të brendshme të Kosovës, prandaj kryeministri Thaçi nuk u pat përgjigjur në asnjërën prej 7 pyetjeve që ia patëm bërë në interpelancën e 5 majit, sepse ai dialog që e ka bërë ky me baroneshën Ashton dhe me këshilltarin Cooper, është shumë më i rëndësishëm se ky dialogu teknik i zëvendëskryeministres Tahiri, sepse atje është përcaktuar korniza, baza, temat, renditja e tyre. Ajo është pjesa kryesore e bisedimeve.

Te parimet e dialogut teknik, thuhet “Republikës së Serbisë”. Kosova pra po e pranon Republikën e Serbisë. Kjo Qeveri e Kosovës e ka pranuar Republikën e Serbisë. Ky është qëndrim zyrtar i saj në platformë, por për shkak të Kushtetutës të saj, Kushtetutës të Serbisë, kjo do të thotë që kjo Qeveri e konteston Republikën e Kosovës, sepse nuk mund ta njohësh Republikën e Serbisë, nga pozita e zyrtarit të Republikës të Kosovës, pa a e kontestuar Republikën e Kosovës, për shkak të Kushtetutës të Serbisë, e cila thotë që Kosova është pjesë e Serbisë.

Mandej, thuhet që ky dialog nuk do ta prek në asnjë rast sovranitetin e Kosovës, pavarësinë, integritetin territorial e të tjera. Pra, kjo tash bie në kundërshtim me atë që u tha se ky dialog do të përdoret për konsolidimin e pavarësisë dhe sovranitetit. Nëse nuk janë të konsoliduara pavarësia dhe sovraniteti dhe dialogu na qenka mënyra për konsolidimin, atëherë pikërisht po preket sovraniteti për t’u konsoliduar, e nëse është i konsoliduar, siç në fillim thuhet se nuk është, atëherë do të mund të thuhej që nuk po preket. Mirëpo, këtu pra po preket sovraniteti edhe pavarësia, sepse kjo Qeveri e Kosovës beson që duke e prekur me dialog pavarësinë dhe sovranitetin, do t’i konsolidojë ato, sepse në faqen 3 thotë që janë të pakonsoliduara. Pra, krejt këto janë ato problemet e mëdha logjike të cilat e shpërfaqin diku moskokëçarjen, e diku qëndrimin negativ të kësaj Qeverie.

Tjetër, në pikën 5 thuhet: “Udhëheqësi i delegacionit të Republikës së Kosovës për dialogun me Republikën së Serbisë, do të ofrojë raporte, do ta informojë në baza të rregullta Komisionin për Politikë të Jashtme”.

Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, ka qenë vetëm një herë në Komisionin për Punë të Jashtme, me datën 8 prill dhe mandej e ka anuluar pjesëmarrjen në takimin e radhës më datën 24 qershor. Më pak se një ditë, para se të ndodhë ajo, e ka anuluar pjesëmarrjen, prandaj kjo e tregon edhe një herë që s’ ka transparencë.

Me 8 prill e kemi kuptuar një gjë. Në fillim më thanë që mos na i kërko transkriptet dhe procesverbalet, mandej unë u thashë - a do të thotë që ato ekzistojnë? Dhe, zëvendëskryeministrja Edita Tahiri më tha: “nuk mund të përgjigjem në këtë pyetje”. Pra, absolutisht s’ ka pasur transparencë gjatë këtij procesi edhe prej këtyre konkluzioneve po shihet që nuk kanë qenë të interesuar që të shihet se çfarë po bëhet për shkak se u bë kjo gjë kaq e keqe.

Gjithashtu, dua t’ju them një përshtypje timen personale. Unë e kam vërejtur një shpërputhje midis dijes dhe mençurisë së zëvendëskryeministres Edita Tahiri dhe bindjes

së saj për mençurinë dhe dijen e saj. Nuk po them që është e pamënçur, nuk po them se është e paditur, por mendimi që ka kjo për veten, për dijen e saj, për mençurinë e saj, besoni është në shpërputhje me atë që e ka. Edhe a e dini pse është problemi im këtu? Problemi, se kjo është çështje shumë serioze, problemi është se pikërisht kjo shpërputhje midis asaj që njeriu mendon për veten dhe asaj që është, e prodhon një vetëbesim artificial, që ia sheh krejt populli sherrin, atëherë kur ai njeri është zëvendëskryeministër. Pra, ky vetëbesim, kjo megalomani, ky fodullëk na i bien këto konkluzione, sepse unë po di, jam i mençur e kështu me radhë, s'keni keni çka më tregoni ju të tjerët, unë e di teorinë e negociatave. Ky vetëvlerësim i madh, ky inflacion i sedrës, na i bie mbasandaj këto konkluzione.

Tjetra, është shumë interesante qysh në faqen 7, pushon së përmenduri “Republika e Kosovës”, kur vjen te agjenda e dialogut. Deri te faqja e shtatë thuhet: “Republika e Kosovës”, “Republikës së Serbisë”, prej faqes 7, te dialogu thuhet “Kosovë” dhe “Serbi”. Dhe, gjithashtu, pikërisht në faqen 7, kur trajtohen çështjet teknike, eliminohen emërtimet politike. Përveç që nuk thuhet më “Republikë”, po ashtu s’ thuhet as “shtet”, por “vend”, në këtë faqen 7, dhe është interesante qysh thuhet “në periudhën e luftës dhe të pasluftës”. Pra, periudha e paraluftës, amnistohet Serbia. Nuk kanë nisur problemet tona me Serbinë vetëm në luftë dhe në pasluftë. Këtë do të mund ta thoshin: Kroacia, Bosnja, Sllovenia, të cilët kanë pasur probleme me Serbinë vetëm gjatë luftës, edhe pas luftës. Kosova ka pasur probleme me Serbinë prej shekullit XIX dhe këtu të thuhet që problemet teknike të krijuara në periudhën e luftës dhe të pasluftës, kjo është e pandershme, kjo është ta mohosh dhe ta zhdukësh historinë.

Problemet tona janë shumë më të hershme se sa të luftës. Veç kujtoni aparthejdin, për shembull, të viteve '90, e ku janë dëbimet e shqiptarëve, konolizimi, reforma agrare, Rankoviqi, planet e tyre në shekullin XIX, të gjitha këto hiqen në emër të asaj që kemi pasur vetëm probleme të luftës. Jo, lufta është kulmi i problemeve, kurrsesi pikënisja e atyre.

Tjetër, thuhet që “të bëhet kthimi i dokumentacionit të marrë nga Serbia”. Dokumentacioni është marrë, por thuhet sipas kësaj Qeverie “nga Serbia në kohë të luftës”. Edhe natyrisht që mandej kthimi na del çështje teknike, por nuk është marr, por është plaçkitur, është vjedhur. Këta po dëshirojnë aktin kriminal të Serbisë ta zhveshin nga motivi kriminal e politik i saj dhe kësisoj të bëhet teknike ajo. Shërbim ma të mirë Serbisë nuk mund t’i bësh. Mandej, thonë “kthimi i eksponateve të trashëgimisë kulturore të marra, të huazuara”. Qysh, na i paska marrë hua ato, trashëgiminë kulturore, a? Edhe çka tash, duhet të na paguajë qira që na i ka pasur hua ato gjatë kësaj kohe, a? Pra, a po e kuptoni qysh e bëjnë depolitizimin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe dy minuta!

ALBIN KURTI... Tjetër, në këto çështje dhe probleme të krijuara në periudha të luftës dhe të pasluftës, askund nuk përmenden strukturat ilegale të Serbisë, shtypja e

shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë, Bujanovc, vjedhja e depozitave bankare të qytetarëve të Kosovës, krimet e luftës, krimet e agresionit dhe okupimit. Neve këtu kryeministri Thaçi dhe Qeveria na flasin për Luginën e Preshevës. Mos më fol mua, shko fol atje në Bruksel për Luginën e Preshevës, po atje nuk e kanë çelur gojën kurrë. Neve na flasin këtu tash për Preshevë, Medvegjë e Bujanovc, neve na falsin për bashkim kombëtar, a çka flasin këta me ndërkombëtarët për bashkim kombëtar, e ka treguar Wikeliksi. Këta thonë: aman amerikanë, na e mbani Shqipërinë të mos të na përzihet. Kjo e ka treguar. Këqyr çka flasin këta me ndërkombëtarë. Para se të dalin ndërkombëtarët kundër bashkimit kombëtar, janë këta ata të cilët në takime me ndërkombëtarë dalin kundër bashkimit kombëtar, prandaj jemi në këtë gjendje.

Tjetër, në faqen 10, është interesant qysh ... unë nuk besoj që këtë e kanë bërë me qëllim, po fillojnë të flasin për çështje praktike. Deri atëherë janë çështje teknike, mandej bëhen praktike. Pra, praktike, të cilat natyrisht tash nuk janë më jopolitike, por ky joprecizitet tregon moskokëçarjen dhe tregon thjesht shprehje e këtij fodullëku, e të asaj megalomanie të delegacionit negociator. Pra, këta nuk janë preciz, e mandej pasojat do t' i shohim shumë më vonë. Diku çështje teknike, diku praktike, s' ka rëndësi, njësoj është për ta.

Dhe, së fundi, sa i përket kësaj, ashtu qysh ka filluar ky dialog më 8 mars, para Rezolutës së Kuvendit, e pa rezolutë, ngjashëm na erdhën konkluzat e dakorduara para platformës dhe e keni parë qysh konkluzionet janë më herët në këtë letër, e mandej vjen platforma. Se platforma është e shkruar vonë, e dëshmon edhe atribuimi i Presidentes, pra në gjininë femërore, që do të thotë se deri më 7 prill, për një muaj së paku me siguri s' ka pasur platformë.

Më lejoni të them...

KRYESUESI: Jepja kohën, ta mbyll fjalën! Ok, 30 minuta t' i japin, a?
Vazhdoja fjalën derisa ta kryej!

ALBIN KURTI: Qeveria e Kosovës nuk ka ide për Kosovën. Qeveria e Kosovës nuk ka alternativa për Kosovën, prandaj Qeveria e Kosovës nuk paraqet alternativë për Kosovën. Kjo qeveri pikërisht pse nuk ka ide se çka të bëjë me pavarësinë, se si nuk di ta bëjë pavarësinë sovranitet, demokraci dhe zhvillim ekonomik, shkon e bisedon me Serbinë për çështje të brendshme të Kosovës. Pra, nuk janë bisedat me Serbinë ide, janë mishërim i mungesës të idesë. Duke mos pasur ide, shkojnë në bisedime, se po të kishin ide, e kishin bërë pavarësinë sovranitet, zhvillim ekonomik e kështu me radhë.

Tjetër, Serbia i do bisedimet me Kosovën, sepse e di që Qeveria e Kosovës ka qëndrime të ndryshme prej popullit të Kosovës, të cilit nuk i ndryshon qëndrimi. Sikur Serbia ta dinte që Qeveria e Kosovës ka qëndrim të njëjtë me popullin, atëherë sigurisht nuk do t' i ndryshonte bisedimet, por ajo e di që nuk është kështu. Kurrë këto bisedime nuk do të kalonin në referendum, e aq më pak këto konkluzione.

Bisedimet me Serbinë po i bën Qeveria e shumicës parlamentare që nuk është shumicë popullore, vetëm përmes ulëseve të rezervuara për deputetët serbë që janë tërësisht jodemokratike, ka arritur të sajohet kjo Qeveri, e cila tash bën pazare me Serbinë. Serbia ka shumë shpresa në Qeverinë Thaçi, sepse qytetarët e Kosovës nuk kanë shpresa në Qeverinë Thaçi. Kjo Qeveri ia ka premtuar Serbisë 6 marrëveshje për çështje të brendshme të Kosovës, qysh të mos ketë shpresa Serbia në ta.

Tri vjet e gjysmë pas shpalljes së pavarësisë, Qeveria e Kosovës po ia trash Kosovës varësinë prej Serbisë. Para se të jetë problemi te temat e dialogut me Serbinë, problemi është që dialogu është tema, sa herë që i teket Serbisë, Qeveria i shkon në bisedime.

Këto konkluzione u cilësuan nga zëvendëskryeministrja Edita Tahiri si një hap përpara drejt njohjes të Kosovës nga Serbia. Për një hap u deshën 3 marrëveshje. Sa hapa do të jenë tjerë: 10, 15, 20? Tri marrëveshje ishin një hap.

Mandej, Kosova po përpiket përmes kësaj Qeverie ta çojë sa më shpejtë Serbinë në BE, këtë e kanë thënë publikisht. A e dini pse? Se këta mendojnë që Serbia pak para se të shkojë në BE-na njih neve, se rrugë tjetër s' ka. Pra, rruga e Serbisë për BE është e njëjta rrugë për njohjen e Kosovës nga Serbia. Kjo është premisa fundamentale e tyre, mirëpo këta harrojnë një gjë, se Millosheviqi e ka njohur Bosnjën jashtë Serbisë kur e ka njohur Alia Izetbegoviqi Serbinë brenda Bosnjës. Derisa të bëjë puna të shkojë Serbia para portës së Brukselit, ajo këtu do ta sajohet një republikë serbe, e pyesni tash boshnjakët dhe kroatët cili është problemi më i madh i tyre, prapë është Serbia, edhe pse i njih, edhe pse kanë ulëse në OKB?

Thonë aleancat me Perëndimin, partneriteti, por përvoja ime edhe analiza ime e ka dëshmuar një gjë, gjatë këtyre viteve sa merrem me politikë. Aleanca dhe partneriteti i tyre është taktiko-financiar, jo strategjik-kombëtar. Pra, nuk është problemi te aleanca, te partneriteti, por te karakteri i aleancës, te karakteri i partneritetit. Është taktiko-financiar, nuk është strategjik -kombëtar. Kurrkush prej këtyre ministrave nuk ka shkuar në Pentagon, në Uashington, në Bruksel të bëjë plane ku do të jetë shteti e kombi ynë pas 15, 20 apo 30 vjetëve? Këta mendojnë veç sot, eventualisht për muajin gusht, shtatori s' dihet, taktiko-financiare i kanë aleancat, këtu është problemi. Nuk është puna vetëm të kesh aleatë e të jesh partner, por çfarë karakteri ka ai partneritet.

Mandej, kur thotë kryeministri ose ndonjë ministër, koordinim me ndërkombëtare, veç zëvendësoni fjalën koordinim me subordinim edhe fjalja mbasandaj bëhet shumë më e saktë, ose kur thonë partneritet veç zëvendësoni me fjalën servilitet, edhe mbasandaj fjalja po ashtu bëhet shumë më e saktë.

Nëse ne paskemi marrëdhënie shumë të ngushta me bashkësinë ndërkombëtare, partneritet të shkëlqyeshëm, aleancë të fuqishme, pse e kemi këtë varfëri, këtë papunësi edhe e kemi Mitrovicën e ndarë? Si bëhet që na i kemi marrëdhëniet kaq të mira me bashkësinë ndërkombëtare, e kemi Mitrovicën e ndarë? Këtu dikush po rren e ju s' keni nevojë për imagjinatë shumë të zhvilluar për ta marrë vesh se kush po rren këtu.

Pra, këta marrëdhëniet me ndërkombëtarë i kanë taktiko-financiare edhe për pushtet, jo për shtet. Prandaj, përkundër marrëdhënieve të shkëlqyeshme, kemi varfërinë më të madhe në Evropë, kemi papunësinë më të madhe në Evropë dhe e kemi Mitrovicën e ndarë 12 vjet pas lufte. Nëse i kemi marrëdhëniet e shkëlqyeshme, pse s'u bashkua Mitrovica? Se marrëdhënie të shkëlqyeshme kanë këta vetë, jo për popullin tonë e për shtetin tonë.

Tjetër, me këto marrëveshje Serbia po fiton nga Kosova, pa i premtuar asgjë asaj, ndërkaq Kosova po fiton premtime nga BE-ja, pa hyrë në kurrfarë marrëveshje me të.

Në fund, më lejoni të them diçka për projektin e Bashkësisë Evropiane në Kosovë, ku qëndron problemi thelbësor.

Prej takimeve që i kam pasur unë me ta, me zyrtarët e Brukselit, përshtypja ime përfundimtare është kjo: që ata shtetndërtimin në Kosovë nuk e shohin si ndërtim të shtetit, por si ndërtim të shtetit anëtar të BE-së. Kjo tingëllon mirë, por nuk është mënyra e duhur. A e dini pse? Se përputhet me deklaratën e Piter Feith para gati dy vjetëve, kur pat thënë se Kosova do të jetë sovranë një ditë, atë ditë kur ka për ta shfrytëzuar delegimin e sovranitetit në BE. Pra, tërë kohën kemi qenë jo sovran, një ditë sovran edhe në BE. Pra, do të jemi sovran veç kur te delegojmë sovranitetin, kjo domethënë që kemi qenë tërë kohën të gjymtë deri kur të hyjmë në BE. Nuk bën kështu, sekuencë e gabuar është kjo.

Ne duhet të bëhemi shtet para se të hymë në BE, në mënyrë që në BE të hymë sa më të fuqishëm, se BE-ja është hierarki. Mund të hysh atje te Greqia, Bullgaria, mund të hysh diku kah mesi, te Gjermania, Franca s'mundesh, normalisht.

Po a e kuptoni, nuk është BE-ja organizëm i sheshtë, është piramidë, sa më fuqishëm që të hysh, aq më mirë i ke punët edhe aty. Mirëpo, nëse ne do ta kemi vetëm një ditë sovranitet, atëherë ne do humbim shumë. Prandaj, është me rëndësi që në këto vite të bëhemi shtet sovran, me zhvillim ekonomik, në mënyrë që të kemi shumë vite sovranitet para se të hyjmë në BE, që nuk duket që ka gjasa të ndodhë në këtë dekadë! Pra, ky është dallimi në qasje që duhet ta kemi ne si shtetndërtues vendor me BE-në. BE-ja synon të ndërtojë shtet anëtar, ne duhet të synojmë të ndërtojmë shtet. E këtu është njëfarë tensioni, të cilin ne mund ta tejkalojmë vetëm nëse kemi Qeveri të pavarur dhe sovranë në një shtet pavarur, e nëse e kemi Qeverinë e varur në shtet të pavarur, Qeveria e varur ta varë edhe shtetin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kryeministri Thaçi e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Nga parafolësit e mëhershëm u diskutua edhe për platformën e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ju e dini, të nderuar deputetë, se platforma i është dorëzuar secilit nga ju. Kam qenë edhe më herët, jam i gatshëm edhe sot edhe nesër, kur të dëshironi, ta diskutojmë platformën, ta plotësojmë platformën. Jam

i gatshëm ta prezantoj të tërën përsëri para jush, sepse ka nevojë qytetari i Kosovës, nëse është e domosdoshme ta dëgjojë edhe fjali për fjali, fjalë për fjalë.

Parimet në të cilat ka filluar ky dialog teknik, i Qeverisë së Republikës së Kosovës, parimet e përgjithshme, parimet e dialogut teknik, gjithashtu parimet e panegocushshme siç janë: statusi, sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës, rregullimi i brendshëm dhe plani i Ahtisarit.

Ajo çka ka ndodhur në skenën politike kosovare është mirë që tani të gjitha partitë politike e kanë pranuar dokumentin e presidentit Ahtisari dhe janë kornizuar në programin e agjendës së tij, pra programet e veta i kanë kornizuar në agjendën e presidentit Ahtisari. Dhe, mendoj se ka ndodhur një transformim në kuptimin teknik, po unë mendoj se gradualisht edhe në atë mental.

Gjithashtu, sa i përket çështjeve apo problemeve të krijuara që kërkohet të tejkalohen dhe të zgjidhen, janë të përfshira qartë në agjendën e dialogut dhe platformën e Qeverisë së Republikës Kosovës. Dialogu si një instrument për fuqizimin ndërkombëtar të Kosovës, ndërsa, të nderuar deputetë, unë dëshiroj të theksoj se nëse realisht dëshirojmë të zhvillojmë debat për një çështje të caktuar, zhvillojmë për një çështje të caktuar. Por, në të njëjtën kohë, unë ju ftoj që të kemi edhe seanca tjera jo të jashtëzakonshme, por seanca të rregullta pune, nëse dëshironi edhe të jashtëzakonshme edhe interpelanca, unë këtu jam në mesin tuaj vazhdimisht, të zhvillojmë debat për të gjitha çështjet politike të raportit të Kosovës me ndërkombëtarët, për zhvillimin ekonomik, dhe për të gjitha çështjet.

Po, Qeveria e Republikës së Kosovës, punon për njohje reciproke mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë dhe ky do të ishte konkluzioni më i drejtë dhe më i çmueshëm i mundshëm për popullin e Kosovës, për Serbinë, për paqen dhe stabilitetin në rajon.

Është vlerë ndërtimi i fqinjësisë së mirë, është rrezik konfrontimi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe NATO-n. Partneriteti me Perëndimin, nuk është taktik-financiar, por është vlerë e lirisë, është vlerë e demokracisë, është vlerë euroatlantike, dhe ky duhet të bëhet një dallim i madh.

Edhe sa i përket historisë, unë nuk dëshiroj të merrem me histori. Dikush ka mbetur në kapitullin e se kaluarës ende për shkak se s'e ka përfshirë kurrkund, po nuk mund të përfshihet, fort, po kam gjasa se nuk do të përfshihet as në kapitullin e së ardhmes.

Dikush pretendon të paraqitet si gardian i së vërtetës apo pronar i patriotizmit në Republikën e Kosovës, apo i shqiptarizmes. Edhe këtë nuk do të mund ta monopolizojë askush.

U fol këtu për shumicën dhe pakicën qytetare në Kosovë. Ky është racizëm, kjo është rrezik për Kosovën, të nderuar deputetë. Kosova ka perspektivë vetëm duke ndërtuar rend demokratik dhe shoqëri civile shumë etnike. Prandaj, ju keni dëgjuar edhe opinionet në Serbi rreth dialogut, kur potencohet qartë se Serbia, me pranimin e këtyre

konkluzioneve, ka filluar realisht edhe de jure ta pranojë dhe njohë shtetin e Kosovës, por në të njëjtën kohë, e konfirmoj edhe sot unë punoj për njohje reciproke mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë, për hir të interesit të Kosovës, interesit të paqes dhe stabilitetit në rajon, por në të njëjtën kohë edhe për perspektivën tonë euroatlantike.

Nuk mund të flasë për vlera euro-atlantike askush prej atyre që nuk i takon askush, as nga Uashingtoni as nga Bashkimi Evropian. Nuk mund të flas për vlera atlantike askush nga ata që realisht kanë një vizion apo kanë një platformë politike të ngurtë, të lagjeve. Prandaj, unë ju ftoj të gjithëve, së paku në parimet e përgjithshme të vizionit, të vullnetit të popullit të Kosovës, dhe vizionit shtetëror të Kosovës, të kemi një pajtueshmëri për ecje të përbashkët, sidomos atë të fqinjësisë së mirë, atë të integritetit euro-atlantik dhe në segmente tjera, por të mos pretendojmë të prezantojmë me përralla realitetin pozitiv të Kosovës me një zhurmë disfatiste, frustruese shpirtërore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Zoti Kurti e ka fjalën, për replikë.

ALBIN KURTI: Ne i kemi thënë botërisht cilat janë problemet themelore me planin e Ahtisarit edhe njësoj mendojmë sot e kësaj dite, jo pse kemi qëndrim kundër serbëve, pse kemi qëndrim kundër Serbisë. Për neve Serbia është shtet armik, nuk është vend fqinjë. Dhe a e dini pse, se Serbia ka shpallur veten armik të shqiptarëve? Nuk e kemi shpallur ne, ne veç po e konstatojmë shpalljen e saj. Lexojeni Kushtetutën e saj, lexoni historinë, lexoni planet e saj, shihni strukturat paralele edhe kësajsoj e merrni vesh që Serbia është shtet armik. Çfarë vendi fqinj ai?

Ne, edhe kur kemi gjuajtur me gurë, edhe me shishe me ngjyrë të kuqe, ndaj vizitës së zyrtarit të Serbisë, Borisllav Stefanoviq, nuk kemi gjuajtur as më 11 maj, as më 13 maj, por më 12 maj, kur Qeveria e ka strehuar atë njeri dhe nuk kemi gjuajtur ndaj serbëve në Graçanicë, ose ndaj serbëve në Partesh, sepse për neve nuk janë civilët problemi, problemi është regjimi me 24 programe shfarosjeje që s' ka ndryshuar, po këta kanë ndryshuar.

Nuk bën ta ndryshojmë qëndrimin ndaj Serbisë kur ajo nuk e ndryshon qëndrimin ndaj nesh. Kjo është ajo që e thotë "Vetëvendosja". E drejta e vetos për serbët këtu, ne e kundërshtojmë, sepse është jodemokratike, nuk ka ulëse të rezervuara, ata që votohen vijnë këtu. Ne s' jemi racistë ndaj askujt, përkundrazi ne mendojmë që diskriminimi pozitiv ka elemente të racizmit kundër shqiptarëve, se shqiptari s' na qenka i vlefshëm sa serbi.

Tjetër, decentralizimi mbi baza etnike ka qenë problemi i eksterritorialitetit të kishave, manastireve ortodokse, që me dashakeqësi shpallen serbe, shuarja e TMK-së, se s' ka aleancë pa ushtri. Këta thonë aleatë me Perëndimin, aleancë është NATO-ja, aleancë bëjnë vendet me ushtri, s' mundesh ti me FSK të bësh aleancë. Kjo është, këto janë përralla. Kjo aleancë me Perëndimin kur s' ke ushtri, është përrallë. Borxhi i jashtëm Serbisë, ne për të pasur pjesëmarrje aty, e dëmshme...

KRYESUESI: Faleminderit, u krye replika!
Zonja Tahiri, e keni fjalën!

(Reagim, deputeti Kurti vazhdon të flasë pa mikrofon)

KRYESUESI: Zoti Kurti, ju faleminderit! Ju lutem, lirojeni foltoren! Zoti Kurti, kjo është në kundërshtim me Rregulloren, të lutem ulu në vend!
Zoti Kurti, nuk është fer kjo, megjithatë zonja Tahiri e ka fjalën. Mirë, zoti Thaçi e ka një sqarim shtesë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë, pa dashur në asnjë rrethanë të polemizoj me asnjë deputet, por vetëm të sqaroj. Është shqetësuese thjesht frustrimi shpirtëror edhe politik kur mungojnë argumentet politike.

Në anën tjetër, dëshiroj të theksoj se është shqetësuese gjithashtu përkushtimi kaq agresiv kundër partneritetit të vlerave të lirisë dhe euroatlantike, siç po ndodhë tani nga njerëzit që thirrën për bashkim kombëtar dhe dalin kundër ndërtimit të autostradës, që thirren për bashkim kombëtar dhe që, në asnjë rrethanë, në asnjë rrethanë kurrë nuk prezantojnë ndonjë ide për të ardhmen, t'i japin të drejtë vetes për t'u thirrur në emër të një bashkimi kombëtar që tanimë ka marrë karakter prej tyre- përralle, jo realitetit, se unë punoj për shqiptarët në rajon dhe popujt tjerë, pa kufij të jetojmë në një rajon pa kufij.

Prandaj, është mirë shumë që keni pranuar dokumentin e Ahtisarit, qysh e keni prezantuar vazhdimisht, që keni dhënë edhe betimin, por duke i kushtuar poezi atdheut sot, duke mbajtur vetëm shqiponjën në gjoks, apo duke kujtuar vetëm të kaluarën, nuk është kjo vetëm, apo që mund t'i monopolizosh atributet e patriotit. Edhe shqiponja edhe simbolet tjera kombëtare, më tepër mbahen në zemër se sa. Nuk janë në rrezik shqiponjat, bindu, as nuk ka qenë as nuk është në rrezik. Nuk është në rrezik atdheu, kur ka qenë në rrezik, dikush iu ka dorëzuar Serbisë, dikush e ka vazhduar luftën.

Në anën tjetër, nuk ndërtohet shteti duke i djegur simbolet e shtetit, duke dhunuar Kushtetutën e shtetit, duke djegur flamujt e shtetit të Kosovës, prandaj politikani duhet të ketë edhe edukatë, të mos bëhet horë apo mos e bëjë horë vendin para botës, së paku. Unë edukatë nuk mund të jap, po leksion politik po, i nderuari apo të nderuar, ju pronarët e patriotizmit, të vetëquajtur dhe gardianët e së vërtetës.

Rrethanat, të cilat ju do t'i imagjinoni se do të duhej të ndodhin në Kosovë, nuk do të ndodhin më kurrë, është kapitull i mbyllur. Tani vendin do ta zhvillojmë dhe ndërtojmë në perspektivën tonë euroatlantike, zhvillimore, për rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve, për krimin e vendeve të reja të punës dhe në këtë drejtim, unë kam besim të plotë dhe sinqerisht çdo deputet të vullnetit të mirë dhe juve të gjithëve ju falënderoj për mirëkuptimin dhe mbështetjen, së paku në disa parime, ne kemi pasur gjithmonë konsensus të përbashkët, sa i përket bërjes së Kosovës shtet dhe funksionalizimit e konsolidimit. Nëse dikush e sheh Kosovën që po ecë mbrapa, sinqerisht po them, ka

stagnuar në të menduar dhe jo në të zhvilluarit e mendimit politik, por edhe ballafaqimit të realitetit. Prandaj se apo zhvillohet apo jo Kosova, unë lirisht mund t'ju them se shihni edhe se projektet që po ndodhin. Unë nuk merrem me fyerje, me akuza, me shpifje, me, jam kundër instalimit të fjalorit të dhunës në Parlamentin e Kosovës, siç është instaluar, kundër kërcënimeve që prezantohen. Ato nuk i bëjnë nderë as deputetit, as familjes së tij, as rrethit të tij, as subjektit të tij politik, prandaj secili duhet ta ketë parasysh se kjo nuk është as në traditën e popullit tonë, as në vizionin e politikës kosovare, prandaj ju faleminderit shumë!

(Reagim i deputetit Kurti nga salla, pa mikrofon)

KRYESUESI: Ju lutem, qetësi, kur të vjen rendi, fol!
Zonja Tahiri e ka të drejtën për replikë, me Rregullore.

EDITA TAHIRI: Po, humbi pesha ime e replikës...

KRYESUESI: Po mirë, është kultura e tyre!
Zoti Albin Kurti e ka fjalën!

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Ne e kemi bërë betimin me flamur kombëtar, as nuk e kemi shpikur “Vetëvendosjen”, as nuk e kemi shpikur shqiptarinë, mirëpo ne nuk e kemi braktisur atë, këtu është dallimi midis nesh.

Tjetër, sikur ne ta kishim pranuar planin e Ahtisarit, s' kishte pasur nevojë kryeministri Thaçi ta thotë disa herë - e keni pranuar, e keni pranuar, s'di që e kemi pranuar, po ky e di shumë mirë që nuk e kemi pranuar, se ne kemi edhe vizion tjetër për institucionet. Këto institucione na duam t'i transformojmë, s' kemi hyrë këtu për të ndryshuar vetë, por për t'i ndryshuar ato, se ne këto nuk i shohim si një shtëpi me salltanet, ku kemi ardhur për të banuar, por i shohim si mjete të reja për t'i shfrytëzuar brenda konceptit tonë të njëjtë e për qëllimin e njëjtë.

Edhe, sa i përket edukatës, natyrisht që s' mund të na e japë kryeministri, se duhet ta ketë për të na e dhënë, besoj. Edhe, singërisht, prej intervistave të tij, e çka ka shkruar ky, unë një gjë mund ta them: niveli i tij intelektual edhe kulturor është pikëllues dhe trishtues. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Thaçi e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë vetëm e parashtroj një pyetje të cilën e parashtrojnë sot të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Pse po i digjni simbolet e shtetit të Kosovës? Pse po i sulmoni me dhunë institucionet legjitime të Republikës së Kosovës? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Tahiri, e keni fjalën!

EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,
I nderuar kryeministër,
Qeveri e nderuar,

Unë nuk do të dilja sot që të flas, sepse kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, e mbrojti në mënyrën më të mirë dhe më të argumentuar gjithë procesin e dialogut teknik, interesat nacional të Kosovës dhe angazhimet shtetformuese të Qeverisë të Republikës së Kosovës, mirëpo unë u nxita kështu nga disa diskutime të cilët nuk u ndalën dot duke ma përmendur emrin dhe më lejoni shkurt t'i them disa fjalë.

Për interesat nacional, pozita dhe opozita duhet të jenë bashkë. Dhe, interesat nacional të kësaj periudhe, kur Kosova tashmë është shtet i pavarur, kanë të bëjnë me shtetndërtimin demokratik të vendit, integrimin e vendit tonë në Bashkimin Evropian, në NATO, në OKB dhe në mekanizmat tjerë relevant ndërkombëtarë, forcimin e marrëdhënieve me shtetet fqinje, (Shqipërinë nuk e kemi shtat fqinj, zoti Albin) dhe forcimin e stabilitetit dhe paqes në rajon përmes bashkëpunimit rajonal. Mirëpo, unë sot në disa diskutime kam vërejtur një dukuri të cilën desha ta ndaj me ju. Ka këtu disa deputetë që dëshirojnë ta përdorin dialogun teknik për ta konsoliduar patriotizmin, sepse ata të cilët në kohën kur u desh të tregohet patriotizmi dhe heroizmi, në fakt nuk ishin atypari, tash kanë një kompleks dhe kanë një nevojë ta konsolidojnë patriotizmin. Ju lutem, populli jonë ka 100 vjet që din mirë t'i vlerësojë edhe patriotët edhe pseudopatriotët edhe demagogët edhe ata që kanë ditur të punojnë, por edhe ata që kanë ditur të improvizojnë me nja dy- tri defilime demonstratash gjatë kohës së okupimit.

Ju lutem, populli ka 100 vjet që ka përjetuar shtypje dhe 100 vjet ka përjetuar qëndresë të individëve, të lëvizjeve dhe sot e kemi shtetin e pavarur, sot e kemi kombin shqiptar më të fuqishëm se kurrë më parë, por nuk ka shanse që dikush përmes një procesi shumë të rëndësishëm për Kosovën, që është dialogu teknik, dhe është teknik ani që disa mendojnë që është politik, sepse proceset politike kanë kaluar. Rambujeja dhe Vjena ishin dialogë apo negociata politike, ato kanë përfunduar. Kosova sot jo vetëm që është e pavarur, por edhe është konfirmuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, se është shtet i pavarur, prandaj dialogu do të jetë vetëm teknik në interes të qytetarëve, në interes të afrimit me Bashkimin Evropian si dhe është një, do të thosha, angazhim qeveritar, po edhe i shtetit të Kosovës, që së bashku nga aleatët ta marrim Kosovën nga ky pozicion, ta qojmë në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në OKB.

Ajo që më ka pëlqyer te zoti Kurti, që do t'ia jap një kompliment tash, është se kur fliste për planin e Ahtisarit, shikonte kah LDK-ja. Mirë e pate, sepse këta ishin në pushtet bashkë me AAK-në, kur u bë plani i Ahtisarit.

Por PDK-ja, partnerja ime e koalicionit, ishte në opozitë dhe pranoi të jetë në dialog, në emër të interesave nacional dhe sot ne po ballafaqohemi me një situatë do të thosha të mjerueshme në planin e patriotizmit. Por në qoftë se ne jemi në një rrugëtim bashkë me ata të cilët ishin me ne për ta mbërri pavarësinë dhe lirinë, ku po është opozita? Ju lutem, nuk dua të përdorë fjalë të rënda, po, sot këto ditë nuk isha në Kosovë, i lexoja

lajmet dhe analizat, diku- diku disa diskutime të opozitës, u ndërlidhen me një transversale jo bash të mirë.

Andej në Mitrovicë, njëfarë Kuvendi i serbëve të veriut, kundër dialogut, këtu te ne, opozita kundër dialogut e të tjera. Kujdes, ju lutem, kujdes se ndonjëherë interesat e tepruar opozitar, të bëjnë të biesh ndesh me interesat nacional dhe unë po ua jap këtë porosi, sepse kam një përvojë 20 vjeçare, pavarësisht se analizat e individëve më nxjerrin pra jo kredibile, por unë them se ka, disa janë analistë, disa janë pseudo-analistë, disa janë patriotë, disa janë pseudopatriotë. Dhe, patriotët nuk flasin, nuk lavdërohen, janë pseudopatriotët të cilën kompensojnë pra mungesën e patriotizmit në kohë okupimi kur kombi ishte në rrezik, kur individit që bënte politika çlirimtare dhe të vendvendosjes ishte në rrezik. Ato ishin kohë kur është dashur të matet dhe dëshmohet kombëtaria dhe patriotizmi. Ju lutem, sot dialogu, ta dini, nuk ju ndihmon ta konsolidoni patriotizmin. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën, për replikë!

ALBIN KURTI: Faleminderit!

Vetëm një vërejtje të vogël. Kur përputhen dy deklarata, duhet të shikohet motivi dhe kush janë ata që përputhet. Merreni me mend, ta zëmë, mundet bujku të thotë: “kjo sëpatë qenka e mprehtë”, mundet edhe vrasësi serik të thotë: “kjo sëpatë qenka e mprehtë”.

Përputhja formale midis deklaratave s’ thotë asgjë për pasojat dhe motivet. Kjo është shkurtëpamësia e juaj për të cilën po flas unë prej fillimit sot. Përputhja formale me dike tjetër, nuk domethënë kurrëgjë për qëllimet, motivet dhe pasojat. Këtë desha ta sqaroj. Nuk është gjykim, gjykimi etik ka të bëjë me pasojat edhe me motivet, jo me përputhjen formale të deklaratave.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka Blerim Shala.

BLERIM SHALA: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Kabinet i Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryesuesja e delegacionit të Kosovës, zëvendëskryeministrja, Edita Tahiri, në shpjegimin e bisedimeve Prishtinë-Beograd, të nisura më 8 mars në Bruksel, kanë përsëritur dhjetëra herë para nesh dhe para qytetarëve të Kosovës- këto janë bisedime teknike dhe jo politike. Këtu nuk do të trajtohet fare sovraniteti i Kosovës dhe rregullimi i brendshëm i Kosovës, këto janë bisedime midis dy shteteve.

Në interpretimin e rezultateve të para të këtij dialogu apo të konkluzave të 2 korrikut në Bruksel, kryeministri Thaçi dhe zonja Tahiri, po e përgënjeshtrojnë vetveten kur po thonë: “në këto bisedime arritëm të mbrojmë sovranitetin e Kosovës”, i cili siç e pamë pak më lart, nuk duhet të jetë temë e bisedimeve.

Me këto konkluzë, sipas Thaçit dhe Tahirit, nisi njohja e shtetit të Kosovës nga Serbia, megjithëse vetë kanë thënë që kemi të bëjmë me bisedimet midis dy shteteve.

Këto konkluzë, siç thekson kryeministri Thaçi, janë në harmoni të plotë me Kushtetutën e Kosovës, ligjet dhe me platformën e Qeverisë së Kosovës për këto bisedime. Në fakt, këto konkluzë janë në kundërshtim me Kushtetutën, me ligjet, me Rezolutën e Kuvendit dhe me platformën e Qeverisë së Kosovës.

Bisedimet Prishtinë – Beograd janë kryekëput politike, jo vetëm në relacionet Kosovë-Serbi dhe në ato midis Prishtinës e Brukselit e Beogradit e Brukselit, por fatkeqësisht ato kanë karakter politik edhe kur flitet për marrëdhëniet brenda politikës kosovare.

Qëllimi kyç i Qeverisë së Kosovës është që këto bisedime apo sjellja e saj në to, të jetë justifikimi kryesor për mbijetesën e kësaj Qeverie në politikën kosovare për këtë zatën Qeveria e Kosovës po na mbanë në tension, qysh u pa edhe sot, të gjithë neve në temën e dialogut Prishtinë – Beograd, duke e ndarë dhe hasëmuar politikisht Kosovën dhe duke e prishur një traditë shumë të mirë nga e kaluara e përballjeve të Kosovës dhe Serbisë, kur thuaja të gjithë kemi qenë së bashku në temat e mëdha të çlirimit të Kosovës dhe të bërjes së shtetit të Kosovës.

Për këtë shkak, Qeveria e Kosovës synon ta bindë Perëndimin që është në zor të madh prej opozitës, duke qenë kooperative me Serbinë në Bruksel, e në fakt ajo është në zor të madh prej qytetarëve të Kosovës dhe përballë obligimeve që dalin prej Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ju, si qeveritarë të Kosovës, dëshironi të krijoni përshtypjen që ju respektoni sovranitetin dhe shtetin më shumë se të gjithë ne të tjerët këtu, por në fakt ju në bisedimet e Brukselit, keni bërë lëshime dhe gabime politike që shkelin propozimin e presidentit Ahtisari, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Rezolutën e Kuvendit të Kosovës të marsit të këtij viti dhe vetë platformën e juaj për këto bisedime. Ju si Qeveri e Kosovës po i ktheheni UNMIK-ut dhe Rezolutës 1244, edhe pse e keni gojën plot shtet, edhe pse keni deklaruar gati përditë që koha e UNMIK-ut dhe Rezolutës 1244 ka skaduar në Kosovë. Çfarë domethënie tjetër ka pika e gjashtë e temës së parë të konkluzave të Cooperit, liria e qarkullimit që edhe për 5 vjet të tjerë, në Kosovë do të mund të përdoren targat e veturave KS.

Kjo pikë është përzierje e drejtpërdrejtë në çështjen e rregullimit të brendshëm të Kosovës, i cili, po ashtu sipas jush, nuk duhet të shqyrtohet në bisedimet e Brukselit. Ju si Qeveri e Kosovës, përmes marrëveshjeve a konkluzave të Brukselit, keni shkelur nenin 7.1 të aneksit 7 të Propozimit Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari dhe nenin 143.1 dhe 143.2 të Kushtetutës së Kosovës, kur keni pranuar kopjet e regjistrave civilë, për të cilët, në konkluzat e 2 korrikut nuk tregohet fare se kush i ka marrë dhe ku janë në të vërtetë.

Pastaj, në pikën 4 të këtyre konkluzave, ju krijoni mundësi që t'ju ofroni Serbisë përmes EULEX-it, shënime specifike sa i përket regjistrave civilë, gjë që është shkelje e sovranitetit të Kosovës. E keni bërë vendin për t'ju dërguar në Gjykatë Kushtetuese edhe një herë dhe po e bëni vendin që qytetarët e Kosovës, t'ju bëjnë pjesë e një historie të hidhur politike të Kosovës.

Në veprimet e juaja, keni shkelur pikën 1, 2 dhe 4 të Rezolutës së Kuvendit të Kosovës për dialogun me Serbinë, sikurse edhe platformën e juaj të bisedimeve me Beogradin, më konkretisht pikën 1 të agjendës së dialogut të pjesës 1, çështjet dhe problemet e krijuara në periudhën e luftës dhe të pasluftës, që flet për kthimin e dokumentacionit të marr nga Serbia, përfshirë këtu edhe dokumentacionin për gjendjen civile dhe pikën 2 të pjesës 2, çështjet e bashkëpunimit rajonal, i cili lëvizjen e lirë të qytetarëve, e lidhë me njohjen e pasaportave.

Serbia nuk ka bërë gjë tjetër me këto marrëveshje të 2 korrikut, pos që na ka kthyer në terrenin e asnjësisë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, dhe ka pranuar më 2 korrik të vitit 2011, çfarë simbolike po na del kjo puna e 2 korrikut, atë që është dashur ta pranojë dhe ta respektojë prej qershorit të vitit 1999.

Nuk duhet pasur kurrfarë iluzioni që duhet t'ju bëjë mirë shtrimi kësaj i argumenteve ligjore dhe politike para jush.

Ideali i kësaj Qeverie është që Kuvendi i Kosovës të mos merret dot me fakte dhe argumente, por të jetë vendi i grindjeve, i përleshjeve, i llomotitjeve të pafund, krejtësisht të kota. Nuk jeni larg realizimit të këtij ideali ta bëni Kuvendin vend të kotë. Po ashtu nuk duhet besuar naivisht që ju do të ndaleni në dëmtimin e interesave themelore të shtetit të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj.

Nuk janë mbajtur zgjedhjet e 12 dhjetorit, nuk është degraduar aq shumë demokracia në Kosovë, nuk janë dëmtuar aq shumë institucionet e Kosovës, për ta kthyer mbarë Kosovën. Përkundrazi, kjo Qeveri, me këtë sjellje te vete po i shpronëson qytetarët e Kosovës prej fatit të tyre, po e privatizon ardhmërinë e Kosovës përmes një tenderi njëburimor politik dhe po e korrupton politikën si të tillë.

Çuditërisht në kontekstin e ngjarjeve të mëtejme, kjo çka ka ndodhur në Bruksel me 2 korrik, është lajm i mirë, lajmi i keq është se ky është vetëm fillimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar dhe kryesues i seancës!

Të nderuar ministra,
Zëvendëskryeministra,
Kolegë deputetë,

Ta filloj pak më ndryshe çështjen e diskutimit, sepse ndoshta ka qenë koincidençë, por me 2 korrik, shqiptarët e Kosovës, para kësaj ndërtese janë shkëputur përmes

Deklaratës së Pavarësisë, nga krijesa e atëhershme represive, okupuese në Kosovë, dhe i ra që më 2 korrik, pas 21 vjetëve dikush përmes konkluzioneve të vendosë fije të reja të bashkëpunimit, jo të marrëdhënieve apo të rregullimit të marrëdhënieve, po të asaj që jemi munduar për këto 21 vjet, me rezistencë aktive, me luftë çlirimtare, për t'i shkëputur përfundimisht dhe dy konferenca të mëdha apo dy procese të mëdha politike që ka kaluar Kosova, i Rambujesë dhe i Vjenës, kanë sjellë 17 Shkurtin, një datë krejt tjetër, por që është deklaruar vullneti i popullit për shtet të pavarur dhe sovran.

Se sa jemi sovran dhe të pavarur dhe të konsoliduar, është çështje që do të duhet biseduar.

Më erdh keq që nuk është kryeministri, por besoj se ai e dëgjon, por njëri prej zëvendëskryeministrave të tij po shkon në Shqipëri, po thotë: dua bashkim ekonomik, në kohën kur bashkimi ekonomik ka ndodhur me Shqipërinë. Nuk di cilat janë problemet ekonomike që i pengojnë shqiptarët në regjion apo shqiptarët e dy republikave tash dhe të një gjysmë republike në Shkup, që të mos kenë bashkëpunim apo integrim ekonomik? Ai ekziston edhe pakoja e fundit e reformave fiskale në Tiranë, tregon qartë që nuk ka nevojë për iniciativat që janë të realizuara veç dhe të përmbyllura, por si duket idetë e vjetra në kohë të reja, nuk po përputhen, nuk po përshtaten, po e filloj me qëllim, sepse zëvendëskryeministri tjetër është në Bruksel duke biseduar për liberalizimin e vizave, është ministri i Drejtësisë.

Zëvendëskryeministri tjetër, është për Pushtet Lokal, por merret me probleme etnike. I vetmi zëvendëskryeministër që ka mbetur që nuk po bën sherr, është zoti Bujar Bukoshi, i cili vjen në seanca rregullisht, dëgjon deputetët dhe e ruan rolin e vet.

As në program qeveritar, nëse i shihni brenda, nuk janë pjesë e punës, nuk është pjesë e punës, nuk është pjesë e punës integrimi ekonomik, as nuk është pjesë e punës që Edita Tahiri të shkojë në Mal të Zi, Podgoricën të njoftojë për dialogun teknik në kohën kur nuk ka ardhur ta njoftoj Parlamentin e Kosovës.

Sidoqoftë, po kthehemi te ajo që desha të them. Krejt zëvendëskryeministrat kanë nga një shtet fqinj të Kosovës për t'i rregulluar çështjet. Unë kisha propozua që Slllobodan Petroviqit t'i lihet Maqedonia, sepse vetëm aty nuk kemi të ngarkuar dike që e rregullon punën e këtyre problemeve që Kosova po i rrethon.

Nën 2, po e marr me një batutë të zezë në Kosovë që po thuhet, por s'njihem për diçka të tillë, po dua ta përmend, kur është realizuar marrëveshja e konkluzioneve të "quajtura" Prishtinë, të rinjtë e Prishtinës filluan të thonë që u zgjidh problemi i Pallatit të Rinisë, do të quhet: "Borko e Edita"

Kjo është ajo më së miri si e ka kuptuar qytetari i Kosovës, marrëveshjen. Atëherë, atë që e tha zoti Shala, nuk do ta përsëris, sepse i kam nxjerrë edhe unë disa nga aneksi i marrëveshjes së pakos së Ahtisarit, e cila është përkthyer në Kushtetutë, sepse të gjitha këto probleme, kemi arritur për t'i fituar ose për t'i bërë kompromis disa nga ato për

motive të 17 Shkurtit, që kanë ndodhur, duke e ruajtur vetëm cenimin e rregullimit të brendshëm dhe autonomisë territoriale që ka qenë sfida dhe problemi kryesor dhe ka mbetur i kësaj pako, por që vërtet nuk ka ndodhur, është përballuar, ndërsa tash është pjesë e punës.

Nuk kemi të bëjmë me të drejta civile në Preshevë në Bujanovc, të drejtat civile shqiptarët e Preshevës – Bujanovci i kanë fituar me Marrëveshjen e Konçulit. Kemi të bëjmë të drejtat politike dhe të drejta thjesht politike dhe territoriale të këtyre njerëzve, për të cilët ne nuk domi të bisedojmë. Ky Kuvend nuk është thirrur, por organet e këtij shteti kanë të drejtë të bisedojnë, kanë të drejtë ta vendosin në agjendë dhe të bisedojnë. Në kohën kur të tjerët po bëjnë problem, ne kemi treguar konstruktivitet 11 vjet, në raport me këta njerëz që asnjëherë nuk kanë qenë Serbi, vetë është konfirmuar nga zëvendëskryeministri serb, i cili është i vetëm zëvendëskryeministër atje, që Presheva e Bujanovci kurrë s' kanë qenë Serbi, kanë qenë Kosovë, ka mbetur.

Atëherë nëse duam të shesim mjegull që të drejtat civile që po i fitojmë për ata njerëz, është pak e rëndë për ne, sepse nuk qëndron. Ata kanë nevojë për të drejta politike dhe të drejtat politike të tyre, duhet të realizohen ndryshe.

Regjistrat civil, dokumentet e kadastrave, të mirat tjera, të vjedhura, të plaçkitura dhe në Kosovë shumë probleme janë të rregulluara besoj dhe nuk ka nevojë edhe një herë t'i kthehemi kësaj çështjeje, po shihet se me këto tri konkluzione po shkohet drejt kompromiseve të reja.

Për një numër të tyre po e përsëris, ne kemi bërë kompromise të dhimbshme në Vjenë. Nëse edhe një herë bëjmë kompromise, atëherë do të jenë kompromise shumë të dëmshme, definitivisht dhe do të na dëmtojnë në procesin e normalizimit, sepse askush nuk mund ta pranojë një realitet të tillë.

Nëse flasim me shifra, atëherë 17% e territorit të Kosovës është në të ashtuquajtur kufi komunal të tri komunave në veri të Mitrovicës. Dhe, problemi kryesor i kësaj agjende, nëse shihet në platformë, në fund do të del e drejta territoriale dhe autonomia për serbët në Kosovë, e cila është evituar në kohën më të keqe kur Kosova ka qenë kusht dhe peng i kërkesave ekskluzive për të arritur të drejtat, të drejtën e vet ta faktorizojë dhe ta bëjë të pranueshme, për sa e kemi bërë të pranueshme deri tash. Sidoqoftë, unë për ta përmbyllur këtë pjesë të angazhimit tim, natyrisht që jam pjesë e kulturës politike që dialogun e njeh si të vetmin mjet politik që këtë proces nuk e kam mbështetur në kuadër të angazhimit të grupit parlamentar dhe nuk jam pjesë e votimit të rezolutës së këtij Kuvendi, por edhe vetë rezoluta është shkelur. Dhe, natyrisht besoj shumë që më mirë është t'u themi deputetëve, qytetarëve të Kosovës që po shkojmë deri në fund t'i zgjedhim problemet me Serbi, po e kthejmë mbarë procesin, sa po vazhdomë mbrapshtë duke dashur të na blejnë ne si deputetë interesat që këtë proces me e përkthyer si interes i përgjithshëm nacional dhe po fiton Kosova shumë.

Fakt që Kosova sot është duke humbur shumë, por Kosova është duke u dëmtuar përditë e më shumë dhe një ditë do ta shohim shumë qartë që problemet janë shumë më

serioze. Unë nuk besoj në implementimin e kësaj marrëveshjeje, nuk besoj thjeshtë, sepse në faqen 9, thuhet: “Qytetarët kanë të drejtë të marrin tabela të përkohshme dhe shumica e atyre do t’i shfrytëzojnë tabelat e përkohshme, se qytetarët kanë të drejtë, do të marrin leje kalim, letërnjoftim të përkohshëm, që do të duhet ta marrin, dhe shumica shqiptare do t’i ikë këtij problemi, do t’i ikë qarkullimit dhe shumica e qytetarëve tanë që jetojnë në Zvicër ose në Evropë, do të kërkojnë pasaporta dhe shtetësi atje, do t’i ikë qarkullimit dhe shumë probleme tjera.

Ta përfundoj , një porosi për zonjën Tahiri, e cila përfaqëson Qeverinë, në këto bisedime është: Me konkluzione kemi filluar Vjenën dhe kemi përfunduar me pako. Ajo nuk ka të drejtë ta qojë Kosovën në konkluzion pas konkluzioni me një pako të re, e cila do t’i implikonte ndryshime kushtetuese. Ajo ka një mandat teknik, që ia ka dhënë shumica e thjeshtë në këtë Parlament, le ta ruajë atë mandat, le të flas për atë mandat, le ta ushtrojë për atë mandat, por nuk ka të drejtë që konkluzion pas konkluzioni të bëjë pako. Ata që kanë marrë pjesë në procesin e Vjenës, ka qenë konsensual, kemi qenë bashkë të gjithë, e dinë fare qartë që çdo bisedim, çdo rund bisedimesh, ka prodhuar konkluzione, konkluzionet kanë prodhuar pako, pako ka prodhuar propozim, propozimi është shprehur, është deklaruar këtu si vullnet ynë dhe ka ndodhur shpallja e ditës së pavarësisë.

Këta nuk e kanë atë mandat që s’ kanë mandat koncesual të qytetarëve të vet dhe të këtij Parlamenti. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Sot patëm mjaft diskutime edhe diskutime patriotike, por edhe diskutime të sinqerta. Mendoj se zoti Shala e ngriti një debat çfarë do të duhej të ishte tipik për një debat opozitat edhe pse tema që po ngritin, nuk është temë tipike, nuk është temë për të bërë mirë opozitën, por është një temë për të dhënë vërejtje në një proces që është proces më tepër proces shtetëror se sa proces opozitar.

Para se të shpreh opinionin tim, vetëm një korrigjim të zotit Haziri, përmendi 2 korrikun e vitit 90-të, si ditë e shpalljes së pavarësisë. Dua ta korrektoj, sepse kam qenë kontribuues i shkrimit të asaj deklaratë dhe nuk është dita e pavarësisë, por është dita e fillimit të procesit, sepse shprehimisht është përcaktuar se Kosova përcaktohet si njësi e barabartë brenda federatës apo konfederatës jugosllave, diçka që zoti Tadiq sot do ta uronte me një gotë shampanjë. Tek 18 nëntor i vitit 1991, është dita kur është miratuar Rezoluta për pavarësinë e Kosovës, kështu që mos t’i përziejme datat historike dhe të mos krijojmë këtë simbiozë të pavend.

Çështja e fillimit të negociatave, kam një përvojë, sepse kam qenë edhe në Rambuje, kam qenë edhe në Vjenë, kam udhëhequr aspektet legale të negociatave, Kosova ka hyrë në një cikël të negociatave në vigjilje të luftës e sidomos në periudhën e pasluftës. Jo

pse Kosova ka qenë e denjë për t'i dizajnuar vetë negociatat, po për shkak se Kosova ka hyrë në një proces ndërkombëtar, në një projekt ndërkombëtar dhe përvojat e Kosovës kanë qenë jashtëzakonisht të mira.

Ne edhe sot kemi dilema pro ose contra Rambujesë, por rezultati është pozitiv, është treguar se kemi qenë largpamës dhe është treguar se kemi bërë mirë që kemi vendosur partneritet strategjik. Gjithashtu edhe te procesi i Vjenës ka pasur shumë paragjykime si do të përfundojë procesi i Vjenës, ka pasur shumë defetizëm, ka pasur shumë spekulime se procesi nuk do të përfundojë sipas dëshirës. Megjithatë, pas atij procesi ne kemi shpallur dhe jemi krenarë që kemi shpallur pavarësinë.

Ky proces politik i negocimit është përmbyllur, Republika e Kosovës është shtet i pakthyeshem, është e vërtetë se nuk po ec me dinamikën çfarë donim, është e vërtetë se nuk po merr njohje ndërkombëtare sa kemi pritur, por është një proces i pakthyeshem, jo pse ne dom, por për shkak se është ndërmarrja më e madhe ndërkombëtare në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Është një investim kryesisht i popullit të Kosovës, por është një investim ndërkombëtar dhe procesi është i pakthyeshem, kështu që ne tani kemi situatën shumë, shumë më relaksuese për t'iu qasur këtyre bisedimeve për shkak se e kemi hequr prej qafe çështjen e pavarësisë së vendit tonë dhe jemi shtet dhe duhet të besojmë në këtë shtet. Nëse ne nuk besojmë në shtet, ku të presim të tjerët që të besojnë, duhet të besojmë dhe t'i gëzojmë frytet e këtij shteti, sepse edhe këto përvojat e parlamentarizmit që po i ndërtojmë e që nuk po na shkojnë bash mirë siç po presim, janë rezultat pikërisht i këtij shteti që po frymon lirshëm.

Qeveria e Kosovës, ka qenë entuziaste për të hyrë në këtë proces të dialogut, nuk ka qenë zgjedhje e Qeverisë, por ka qenë një agjendë evropiane, ka qenë një detyrim ndërkombëtar që e kemi marrë me Rezolutën e Asamblesë të Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Një alternativë ka qenë shumë më e keqe, një alternativë që Serbia atëherë ka propozuar, shumë më e keqe dhe ka hyrë me një relaks dhe pas vendimit të GJND-së, ne e dimë se ende ish shtetet jugosllave kanë probleme. E dimë që ende bisedojnë. Ne kemi parë tek para disa muajve Sllovenia dhe Kroacia kanë zgjidhur jo vetëm problemet teknike, por problemet territoriale, probleme me njohjen e sovranitetit. Kështu që, nuk duhet të krijojmë stres kur nuk ka shtres, nuk do të krijojmë bauk, është legjitime që Kuvendi të njoftohet, është legjitime që Kuvendi ta korrektojë procesin.

Unë ia zë për të madhe Qeverisë pse e ka lejuar këtë debat me kërkesë të opozitës, pse nuk e ka bërë debat me kërkesën e vet? Pse vetë Qeveria, përkatësisht zëvendëskryeministrja nuk kanë bërë kërkesë që ajo të vijë në Kuvend dhe të raportojë, ta njoftojë Kuvendin, sepse Kuvendi ka të drejtë të raportojë dhe është obligim i Qeverisë edhe karshi Rezolutës që e kemi miratuar, që në fakt ai të njoftohet dhe eventualisht të japë disa sugjerime të përgjithshme për rrjedhën procesit, sepse është vetëm fillimi i procesit, natyrisht në aspektin formal, ne që jemi disa prej juristëve, do të mund ta diskutonim çështjen sa janë konkluzionet praktike a të negociatat. Më tepër konkluzionet janë rezultat i procesverbaleve të diskutimeve apo janë diçka që mbyllet një cikël. Zakonisht negociatat ndërkombëtare përmbyllën në formë të caktuar dhe unë i kuptoj kështu se konkluzionet nuk janë marrëveshje ndërkombëtare. Konkluzionet janë

të arriturat në një shkallë të caktuar, të një procesi të dialogimit që po shpresojmë të përfundojë me një marrëveshje ndërkombëtare, e cila do të ratifikohet në këtë Kuvend. Absolutisht Qeveria nuk ka për qëllim që t'i ikë obligimeve ligjore që një marrëveshje teknike me Serbinë, në fund t'ia paraqesë Kuvendit dhe atë ta miratojnë, por nuk do të ketë dhjetëra marrëveshje, nuk do të kërkojnë pas çdo cikli të bisedimeve që ne të nënshkruajmë marrëveshje sepse logjika e këtyre bisedimeve nuk është e tillë. Thjeshtë qëllimi është që në fund të procesit, të fillojë raporti i ndërtimit të fqinjësisë të mirë që është padyshim një nga kushtet për Kosovën.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm se Serbia do të përfitojë më shumë se Kosova në këtë proces, sidomos në raport me integritet e evropiane, por të gjithë e dimë që Kosova nuk mund të thotë jo- unë nuk dua të hyj në këtë proces, sepse nuk e kam ndërmend unë për t'u integruar në Bashkimin Evropian. Nuk jemi nisur me një tren të njëjtë në Bashkimin Evropian. Kosova është nisur e fundit në rrugëtimin për integritet evropiane dhe duhet ta kuptojmë se kemi këtë hendikep.

Ajo që është me rëndësi, më tepër kam pritur se në këtë debat të jepen sugjerime Qeverisë, të jepen sugjerime, të shprehen shqetësimet reale dhe të jepen sugjerime për vazhdimin e procesit të mëtejshëm.

Natyrisht këto tri tema që u ngritën, liria e lëvizjes, pastaj çështja e librave amë dhe çështja e njohjes së diplomave universitare, kanë qenë tema më të lehta, dhe natyrisht që ne nuk duhet t'i fshehim gjërat. Kosova, para këtyre çështjeve që janë të rëndësishme, janë pjesë e gjenocidit që ka bërë Serbia, nuk janë çështje që janë të rëndësishme, por pjesë e gjenocidit ka qenë edhe kjo, edhe plaçkitja e librave amë edhe plaçkitja e gjithçka, edhe plaçkitja e diplomave universitare, por ne kemi probleme të rënda politike, pikërisht në veri dhe mendoj se nuk duhet ta kemi kompleksin që të kërkojmë që të ato të bisedohen, të bisedohet shpërbërja e strukturave paralele në veri të cilat po veprojnë. Të bisedohet në fakt luftimi i bandave kriminale që janë neveri, të bisedohet për funksionalizimin e komunës në veri, që ka qenë një nga kompromisi kryesor i pakos së Ahtisarit. Dhe, ne sikur kemi komplekse, sikur kemi komplekse t'i ngremë çështjes esenciale në raportet Kosovë-Serbi dhe mendojmë se krejt problemi është te këto çështje që nuk kanë fort rëndësi dhe pa të cilat Kosova mund t'i bëjë.

Unë mendoj se nuk është dëm i madh në qoftë se ne nuk i marrim librat e gjendjes civile, sepse ato janë të vitit 1999, aq shumë janë të vjetra, aq shumë kanë vdekur, aq shumë kanë lindur, sa që janë krejt të papërdorshme.

Në anën tjetër, Kosova ka filluar ndërtimin e sistemit të gjendjes civile, bile ka filluar në mënyrë shumë moderne elektronike, tash pas regjistrimit të popullsisë, kjo mund të pasohet.

Nuk duhet luajtur lojën e reciprocitetit, nuk duhet luajtur këtu retorikën se Kosova do të vendosë reciprocitet. Unë jam njohës i mirë i praktikave të retrozionit dhe reciprocitetit dhe nuk duhet me pritë se Kosova do të ndjekë politika të reciprocitetit

ndaj Serbisë. Mendoj se bashkësia ndërkombëtare këtu duhet ta bëjë të qartë se nuk i ka vendosur të dy palët në pozicion të njëjtë.

Natyrisht se unë dua të përshëndes atë çështjen e njohjes së diplomave universitare, është diçka që ne kemi pasur problem prej pasluftës. Kemi pasur problem me diploma në kohën e Republikës së Kosovës, kemi pasur problem me diplomat, dhe unë jam marrë me këtë çështje. Edhe sa isha rektor i Universitetit dhe më kujtohet presioni për të hyrë në këtë proces.

Shumë mirë që është hyrë në këtë proces, sepse ky është edhe procesi i Bolonjës, por duet pasur kujdes se si po trajtohet ky proces, për shkak se personalisht mendoj se në një fazë është lënë kjo për një agjencion të veçantë, për ekspertë të veçantë. Unë mendoj se në një fazë të caktuar, llogaria nuk do të bëhet me diplomat e Universitetit të Prishtinës në raport me universitetet e Beogradit, por llogaria do të bëhet me universitetin serb në veri të Mitrovicës dhe do të na qitet kushte, ne po i njohim diplomat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës me firmën e Universitetit të Prishtinës që është universitete legal, universitet legal dhe pranuar ndërkombëtarisht në Shoqatën e Universiteteve, me kusht që ju t'i njihni diplomat e universitetit serb në Mitrovicë, që është universitet publik, por që funksionon me firmën e Republikës së Serbisë. Dhe unë e lus zëvendëskryeministren, që në procesin e operacionalizimit të kësaj çështjeje të ketë kujdes që mos të bëhet ky ekuilibër apo kjo baraspeshë, sepse kjo do të na dëmtonte, jo pse jemi kundër Universitetit të Mitrovicës, ai universitet tash është faktik, e ka krijuar UNMIK-u, por ai po funksionon, po për faktin se ky është projekt politik dhe ky universitet prodhon diploma me firmën e Republikës së Serbisë dhe me këtë ne, jo vetëm që nuk i kontribuojmë integritetit të Mitrovicës, por sikur e mbajmë atë gjendje të status quos, kur Qeveria e Serbisë jo vetëm që mbanë institucione të veta, por ajo edhe i financon dhe me një verdikt eventual ndërkombëtar, ato edhe mund të lisohej.

Sidoqoftë, unë mendoj se nuk duhet tani ne të bëjmë opozitën në atë mënyrë që nuk do të ofrojmë kurrfarë alternative. Nuk është rezultat i këtij debati të ndalen bisedimet. Është proces i pamundshëm. Unë dëgjova edhe ish kolegun tim në Qeveri, zotin Hyseni, që zgjidhja më e mirë është të ndalen bisedimet.

(Reagim)

Kërkoj falje, atëherë tani po distancohem, por kam dëgjuar diku dhe mendoj se kjo...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdojani edhe 2 minuta!

ARSIM BAJRAMI: ... jemi pjesë i një procesi ndërkombëtar, është e vërtetë se pavarësia e mbikëqyrur po skadon apo po shpenzohet, por jemi pjesë e një agjende evropiane. Sa ka qenë për Kosovën interes strategjik pavarësia e Kosovës, aq është interes strategjik integriteti në Bashkimin Evropian, është mjeshtëri jona si klasë

politike, si politikanë që këtë proces ta qojmë përpara me së më pak dëmtime dhe më sa më pak ngecje apo sa më pak ngadalësime në proces. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka zëvendëskryeministrja, Edita Tahiri.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar deputetë Bajrami, Meqenëse e theksuat mundësinë e ndonjë konfuzioni lidhur me diplomat në raport me Universitetin e Mitrovicës, më lejoni edhe një herë të jap sqarimet lidhur me marrëveshjen.

Marrëveshja për njohjen reciproke të diplomave universitare dhe shkollore, mundëson pra që të dy shtetet përmes një organizate ndërkombëtare, por që nuk do të jetë asnjëherë UNMIK-u, këtë e kemi evituar, të mundësojë reciproke të diplomave. Dhe e njëjta marrëveshje nënkupton daljen jashtë të kuadrit të gjitha paralelizmave, përfshirë edhe paralelizmi që ndodhë në Universitetin e Mitrovicës, ku diplomat lëshohen me logon e Republikës së Serbisë, ato diploma nuk do të jenë valide. Ju besoj e keni përjetuar këto ditë që disa shtete tashmë ua kanë kthyer këto diploma studentëve pretendentë që ka dashur të studiojnë në vende të ndryshme. Sa për ilustrim, Sllovenia, për shembull, diplomat e tilla i quan jovalide, prandaj kjo marrëveshje mundëson jo vetëm njohjen reciproke të diplomave, por ndaljen e strukturave paralele. Me këtë rast, Universiteti i Mitrovicës, natyrisht që do të detyrohet ta zbatojë Ligjin e Kosovës, pra do të jenë diploma të Universitetit të Mitrovicës, të cilin ne kemi pranuar qysh herët, por me logon e Republikës së Kosovës.

Ju mbase keni mundur të krijoni konfuzion nga burimet mediale se edhe unë kam parë konfuzione të tilla, por ky është pra, këtë e parashikon marrëveshja.

E dyta, arsyeja pse në marrëveshje thuhet që finalizimi bëhet në raundin tjetër, lidhet me atë se Bashkimi Evropian ende nuk ka identifikuar cila organizatë ndërkombëtare po e merr përsipër bërjen e vërtetimit apo nostrifikimit dhe kjo do të bëhet në rundin e ardhshëm. Dhe e fundit, ne kemi thënë që veçmas ky proces i njohjes së diplomave, do të jetë me përfitime të mëdha për shqiptarët e Luginës së Preshevës, të cilët kryesisht shkollohen në Kosovë dhe më pas po kanë vështirësi të studimeve të mëtejme apo punësimeve në Serbi.

Në anën tjetër, kemi thënë që qytetarët e Kosovës, veçanërisht shqiptarët nuk kanë interes punësimesh në Serbi apo shkollime nëpër Serbi, prandaj nuk u shërben fort kjo marrëveshje, por me të vërtetë adreson dhe ndihmon studentët e Luginës së Preshevës dhe çka është më e rëndësishme, i ka efektet politike. Ndal zbrazjen e kësaj pjese apo të Luginës së Preshevës nga shqiptarët të cilët në pamundësi të perspektivës, janë me të madhe duke e braktisur, pra i ka edhe efektet politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Skënder Hyseni, për replikë.

SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Vetëm sa për sqarim. Unë isha shumë i qartë në kërkesën time për pezullim të dialogut, derisa Qeveria e Republikës së Kosovës të hartojë një kornizë të qartë të parimeve prijëse rreth asaj që synon të arrijë me këtë dialog për çështje praktike. Nuk kam sugjeruar ndërprerje të dialogut, sepse sugjerimet për pezullim dhe ndërprerje, janë dy kategori krejtësisht të ndryshme. Dhe tash, edhe më fuqishëm po e shtroj këtë kërkesë, sepse koncesionet që janë bërë me të ashtuquajturat marrëveshjet e arritura dhe unë prapë po e përsëris – nuk di çka janë, unë s’ mund t’i quaj marrëveshje, e dëmtojnë sovranitetin e Kosovës, e dëmtojnë karakterin unitar të Kosovës.

Po përmend tabelat e regjistrimit. Nëse Kosova e instalon praktikën e lëshimit të dy lloj tabelave të regjistrimit të veturave, ky është fillim i instalimit të një sovranitetit të ndarë. Ky është një fillim i instalimit të lëndimit të pariparueshëm të karakterit unitar të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Zoti Bajrami, kundër replikë, një minutë!

ARSIM BAJRAMI: Nuk do ta quaja replikë, po më tepër sugjerim jo për ministrin Skënderi, por për zëvendëskryeministren Tahiri. Në fakt, esenca e këtij debati të sotëm, është që t’i marrim disa sugjerime të deputetëve, jo konfuzione të deputetëve, sugjerime legjitime dhe zëvendëskryeministrja duhet të jetë falënderuese kur merr sugjerime. Dëshiroj ta siguroj që do ta ketë mbështetjen time personale, por besoj e gjithë Parlamenti që t’i arrijë ato çfarë i përmendi, që vërtet përmes njohjes së diplomave, mos të arrihen efekte politike. Dhe, unë uroj që ajo në procesin e mëtejshëm të operacionalizimit të kësaj pjese të arritjes së marrëveshjeve apo progresive, të shmangë çfarëdo qëllimi politik, sepse unë nuk jam i sigurt se ko nuk do të shtrohet në atë Agjencinë e Akreditimit apo në atë Komisionin Evropian, nuk jam i sigurt që nuk do të shtrohet çështja e pranimi të diplomave të Universitetit të Mitrovicës veriore dhe nuk jam i sigurt që ata do të heqin dorë nga fakti që janë një universitet publik i Mitrovicës, për shkak se ju e përmendët një rast të Sllovenisë, por unë mundem t’i përmend dhjetëra raste kur, me ato diploma njerëzit kanë marrë edhe master edhe doktoratura në shumë universitete ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Zonja Tahiri e ka fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: E para, duhet të vlerësoj se është fakt se këto janë sugjerime konstruktive, mirëpo unë vetëm desha t’ju siguroj që këtë e kemi pas parasysh dhe nuk e kemi lejuar.

Edhe nga ana tjetër, as fare nuk është shtruar pra një kërkesë e tillë në biseda, por ne e kemi shtruar me kohë, në mënyrë që të mos na ndodhë. Me fjalë tjera, më lejoni t’ju them se platforma e Qeverisë së Republikës së Kosovës për dialogun teknik, në fakt i ka parimet udhëheqëse, të nominuara si parime të përgjithshme, është kategoria e dytë parimet e panegociushme apo vijat e kuqe dhe kategoria e tretë janë parimet e dialogut

technik. Dhe jam duke dhënë përgjigje, sidomos zotit, deputetit Skënder Hyseni, i cili është marrë me diplomaci dhe pak a shumë e dinë se edhe këto platforma apo parime prijëse, në fakt janë vendime të marrëdhënieve ndërkombëtare bashkëkohore ku vendimet e shteteve, bëhen në konsultim me aleatët. Prandaj edhe platforma jonë ka parasysh konsultimet dhe mbështetjet e aleatëve dhe me këtë rast, më lejoni t'ju them se vijat e kuqe janë shumë të rëndësishme edhe shumë të qarta.

Për pavarësi, për sovranitet, për integritet territorial dhe për rregullim të brendshëm, nuk ka biseda, prandaj në asnjë rast nuk do të preket karakteri unitar i shtetit të Kosovës.

E dyta, ju thatë se me këto marrëveshje, mund të dëmtohet sovraniteti. Më lejoni t'ju them se me këto marrëveshje, mund të dëmtohet sovraniteti. Më lejoni t'ju them se me këto marrëveshje forcohet sovraniteti, sepse marrëveshjet, këto që u arritën dhe të tjerat, përveç që kanë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: ... Ju kisha ftuar për ndonjë seminar ndonjëherë, kështu për do çështje, megjithatë zoti Hyseni, e ke fjalën edhe ti të na sqarosh çka e ke ndërmend.

SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë i kuptoj, i kam shumë të qarta vijat e kuqe të deklaruara, po kam drojë që ato vijat e kuqe të deklaruara nuk po respektohen. Unë e shtroj pyetjen në mënyrë shumë të thjeshtë, lëshimi i dy lloj targave të automjeteve, a është mbrojtje e vijave të kuqe? Pse ka kthim në atë që ka qenë para shpalljes së pavarësisë të Kosovës? Pse duhet të kthehemi në tabelat KS pas fillimit të lëshimit të tabelave RKS dhe kjo është ajo që unë e quaj fillim i vështirë, po i mirë i normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë karshi fillimit të ...?

(Ndërprerje nga regjia).

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Një fjalë e urtë popullore thotë se "me kë rri, ashtu bëhesh". Qeveria e Kosovës duke u takuar aq shpesh me atë të Serbisë, ka filluar të marrë karakteristika të njëjta me të. E kam fjalën për sindromin e mirënjohur serb, së paku që nga viti 1389, që humbjet të shpallen fitore. Kështu edhe Qeveria jonë, marrëveshjet poshtëruese, të arritura me Serbinë, po mundohet të na i shes si fitore të mëdha.

Si mund të quhen fitore disa marrëveshje, të cilat e shkelin dhe mohojnë shtetësinë e Republikës sonë ende të brishtë? Këto marrëveshje, ashtu sikurse negociatat me Serbinë në përgjithësi, e kanë dhunuar përgjatë gjithë kohës parimin bazik të marrëdhënieve dhe respektimit të ndërsjellë të sovranitetit mes shteteve – e ky është parimi i reciprocitetit.

Parimi i reciprocitetit është më i rëndësishmi në marrëdhëniet ndërkombëtare, përmes këtij parimi shtetet e trajtojnë njëri-tjetrin si entitete të barabarta. Në këtë mënyrë ato tregojnë respekt të dyanshëm për vullnetin politik të popujve të tyre të cilat i përfaqësojnë. Në momentin që nuk ka reciprocitet, nuk ka barazi, por mos respekt dhe mospranim. Kategoria e reciprocitetit është parimi kryesor që e themelon integritetin dhe dinjitetin kolektiv të një shoqërie politike. Nuk ka asnjë bashkësi politike në botë që ka mirëkuptim për poshtërimin, mospranimin dhe diskriminimin. Pabarazia nuk iu pengon vetëm njerëzve pa integritet. Populli i Kosovës është më i dinjitetshëm sesa konjunktura që po i përfaqëson aktualisht.

Qeveria e Kosovës ka një mirëkuptim dhe tolerancë të habitshme karshi politikës mohuese të Serbisë. Në këtë pikë Qeveria jonë më së paku e përfaqëson vullnetin e qytetarëve të dinjitetshëm të vendit tonë, të cilët kërkojnë barazi dhe respekt. Ne si qytetarë të Kosovës nuk mund ta paguajmë çmimin e një Qeverie kaq të papërgjegjshme ndaj interesit shtetëror. Një përshtatje kaq e lartë e qeveritarëve ndaj kërkesave të Serbisë nuk mund të shpjegohet me asnjë koncept politik, racional, përveç se me atë të frikës, servilizmit e shantazhit, por herë-herë ndoshta edhe të interesit. Një strategji e tillë e Kosovës është faktori kryesor pse Serbia është kaq agresive dhe pse ajo edhe përkundër gjithë atyre luftërave që lanë qindra- mijëra viktime, gjendet para Shqipërisë dhe Kosovës, në procesin e integriteteve evropiane.

Negociatat e Qeverisë sonë me Serbinë e kanë treguar qartë një gjë, që interesi për pushtet i kësaj Qeverie, është bërë i kundërt tashmë me interesin shtetëror të Republikës sonë. Kjo Qeveri mund të mbetet në pushtet vetëm nëpërmjet koncesioneve që po ia bën Serbisë. Dhe, problemi është se kjo Qeveri e do më shumë pushtetin personal sesa shtetin e të gjithëve, kurse BE-ja tashmë është përcaktuar që për ta marrë në gjirin e vet Serbinë, t'i bëjë koncesione asaj në Kosovë. Ky rend negativ duhet të ndryshohet.

Fyerja e parë e parimit të reciprocitetit nga ana e Qeverisë së Kosovës është vetë pranimi i negociatave me Serbinë. Qeveria për hir të interesit të vet për të mbetur në pushtet e ka sakrifikuar interesin e Kosovës për afirmimin e shtetësisë sonë. Serbia nuk na njeh, kurse Qeveria jonë po e njeh Serbinë.

Fyerja e dytë e parimit të reciprocitetit është fakti që Qeveria jonë ka pranuar që çështjet e brendshme tona t'i bëjë edhe çështje të Serbisë, pra probleme për të cilat Serbia është bërë bashkë vendimmarrëse. Në këto negociata pra po flitet se për çështje të brendshme të territorit tonë, pra se çfarë dokumentesh të Kosovës janë të pranishme për Serbinë e çfarë jo, çfarë targash të Kosovës mund të hyjnë në Serbi, çfarë regjistrash civilë do të ketë Kosova, si do të rregullohet furnizimi me energji elektrike i pjesës veriore e të gjitha këto janë probleme të brendshme të Kosovës, për të cilat po vendos edhe Serbia falë Qeverisë sonë? Kosova ka nevojë mbi të gjitha që të bëhet Republikë e mirëfilltë karshi Serbisë, para se të jetë Republikë për ishujt e Oqeanit Paqësor.

Të gjitha çështjet që janë biseduar me Serbinë janë, ose agjendë e BE-së ose agjendë e Serbisë, por këtu nuk kemi parë asnjë agjendë të Kosovës. Kosova ka qenë aty për t'iu përshtatur agjendave tjera si dhe për ta krijuar imazhin e gënjeshtërt të një Serbie

miqësore dhe dashamirëse ndaj Kosovës – saktësisht të kundërtën e fytyrës së vërtetë shekullore të Serbisë ndaj shqiptarëve dhe Kosovës.

Pastaj Serbia nuk mund të hyjë në BE, sepse është shtet jodemokratik, dhe Kosova duhet ta mbajë këtë qëndrim. Gjeliqi që është zv.kryeministër për Integritet në BE, erdhi në Prizren dhe tha se Kosova është Serbi, kurse në anën tjetër prej Qeverisë po na thuhet që Serbia do ta pranojë Kosovën. Kurse, merreni me mend zëvendëskryeministri për Integritet në BE-e, thotë kështu: “Ky shtet nuk i respekton të drejtat e shqiptarëve dhe i diskriminon e i terrorizon ata.

Ministrinë e Punëve të Jashtme e ka SPS-i i Millosheviqit, po ashtu infrastrukturën dhe arsimin. Ministrinë e Mbrojtjes e ka Tadiqi, kurse gjeneralët e tij thonë se duan të kthehen në Kosovë. Po ashtu Ministrinë e Pakicave, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë për Kosovën, atë të Drejtësisë, Financave dhe Vetëqeverisjes Lokale. Nga të gjitha këto politika sektoriale që i përmenda, shqiptarët e Luginës së Preshevës i janë nënshtruar një terrori dhe diskriminimi të paparë kombëtar, kulturor, arsimor dhe social. Programi i qeverisë serbe e udhëhequr nga Cvetkoviqi, i ka 6 pika. Dy pikat e para janë integrimi në BE dhe mohimi i pavarësisë së Kosovës.

Për çfarë fqinji të mirë po na flasin qeveritarët tanë si dhe për çfarë Serbie demokratike po na flet Brukseli.

Qeveria e Kosovës mendoj se është dashur t’i mbrojë 14 qëndrime politike të cilat nuk i ka mbrojtur, e këto janë:

- Pendesa dhe kërkim-falja e Serbisë për krimet e organizuara në Kosovë,
- Njohja e Kosovës si shtet,
- Heqja nga Kushtetuta e Serbisë e pjesës së preambulës, nenit 182, që e definon Kosovën si pjesë të Serbisë, si dhe të nenit 114, ku presidenti i betohet për ta mbrojtur Kosovën,
- Shpërbërja e Ministrisë së Serbisë, për Kosovën,
- Kthimin e menjëhershëm në Kosovë i të gjithë të pagjeturve, të rrëmbyer e të ekzekutuar nga forcat policore e ushtarake të Serbisë gjatë luftës,
- Shpërbërja e strukturave paralele në Kosovë si dhe ndërprerja e financimit të tyre,
- Dorëzimin i dhjetëra- mijëra kriminelëve të Serbisë që kanë kryer krime në Kosovë,
- Zhdëmtimi material në formë të reparacioneve që Serbia do të duhej t’ia kryente Kosovës gjatë shkatërrimit që i ka bërë gjatë luftës,
- Kthimin e Fondit pensional dhe atij kulturor pa kurrfarë kushti,

- Zbatimi i marrëveshjes të CEFTA-s,
- Reciprociteti i të drejtave të shqiptarëve të Luginës me atë të serbëve të Kosovës,
- Çmilitarizimi i Luginës si dhe ndalimi i terrorit shtetëror serb atje
- Të drejtat e shqiptarëve në Luginë për identitet, simbole, shkollim, punësim dhe përfaqësim institucional jo diskriminues si dhe
- Të drejtën e shqiptarëve atje për të pasur universitet.

Asnjërin prej këtyre kërkesave, Qeveria e Kosovës nuk e ka mbrojtur gjatë këtij procesi negociator.

Çfarë Qeverie është kjo e cila kurrë njëherë nuk guxon t'ia vendos Serbisë hegjemonike bash asnjë kusht për asgjë?

Tash, nëse kam kohë isha marrë me një tri konkludime të kryeministrit Thaçi gjatë fjalimeve të tij. Ai tha se kërkesa e opozitës për të mbajtur debat lidhur me negociatat dhe kërkesat për t'i ndaluar këto negociata, për t'u ndërprerë, tha se është kërkesë për izolim dhe antievropiane.

Ne i themi atij se vlera evropiane janë: sovraniteti, demokracia, zgjedhjet e lira, liria e shprehjes, pavarësia e pushteteve, pavarësia e drejtësisë, antikorrupcioni dhe zhvillim ekonomik, në të cilat kjo Qeveri s' ka lidhje.

Pastaj tha që ne jemi për një Kosovë, në një Evropë pa kufij. Ne i themi që Kryeministri Thaçi i ka relativizuar aq shumë kufijtë e Kosovës, sa që tash ajo në anën e Serbisë, me të vërtetë ka mbetur pa kufij dhe pa pika doganore, kurse kufijtë e Kosovës i ka zbehur aq shumë sa që tash po quhen kufij administrativ dhe kjo është e dëmshme.

Kryeministri i ka instaluar praktikën e korrupsionit më kronik në Kosovë prej se është shpallur pavarësia dhe nëpër raporte, Kosova po renditet në vendet, pjesërisht të lira, sa i përket lirisë së mediave. Qeverisja e kryeministrit ka bërë që Kosova të renditet në vetin 119, sa i përket bërjes së biznesit, kurse sa i përket procesit të integriteteve evropiane, ne jemi të fundit, kurse sa i përket qeverisjes së tij, këto 4 vjet nuk kanë arritur që ta ulin papunësinë prej 45% e po aq është edhe shkalla e varfërisë. E kjo do të thotë që kryeministri Thaçi përnjëmend nuk ka nevojë fare të ndërtojë bunker, sepse e ka shndërruar Republikën e Kosovës në bunkerin më të madh në Evropë.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Fadil Demaku.

FADIL DEMA KU: I nderuar nënkryetar i Parlamentit,
E nderuara zëvendëskryeministre,

Ministra të nderuar,
Kolegë deputetë,

Në Kuvend është biseduar për dialogun në mes delegacionit të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, janë thënë të gjitha ato që mund të thuhesh duke filluar nga nevoja për dialog, pastaj kundërshtimi me çdo kusht i tij dhe natyrisht këtu kemi pasur edhe perceptime hipotetike nga më të ndryshmet edhe me lojën e fjalëve, nuk është kështu se është, apo është kështu se nuk është, edhe sot këto po na përsëriten me të njëjtën formë.

Dialogu është i interpretuar në forma të ndryshme varësisht nga grupet politike dhe interesat që përfaqësojnë ato. Parlamenti ka votuar pro dialogut për çështje praktike, të cilat do ta lehtësojnë jetën e qytetarëve të dyja vendeve dhe mendoj se deri me tani, gjerat kanë ecur në këtë drejtim. Tek e fundit, dialogu ka ardhur si rrjedhojë përtej vullnetit të Prishtinës dhe Beogradit, të cilën e ka kërkuar bashkësia ndërkombëtare me Rezolutë dhe që është duke ndërmjetësuar.

Në emër të këtij procesi, të cilin e kanë iniciuar dhe është ndërmjetësuar nga bashkësia ndërkombëtare, kemi dëgjuar çka jo, bile edhe atë se kryeministri Hashim Thaçi bëhet i pranuar për bashkësinë ndërkombëtare nëse bisedon me Beogradin, çfarë logjike e papranueshme që e ngatërron bashkësinë ndërkombëtare me Beogradin, por edhe kjo natyrisht se këtu do të kalojë. Bashkimi Evropian dhe SHBA, janë duke ndërmjetësuar këtë proces se janë ata që na kanë ndihmuar në luftën tonë për liri, ata që vazhdimisht na kanë ndihmuar ekonomikisht, ata që na e kanë njohur shtetin, ata që na kanë ndihmuar dhe po vazhdojnë të na ndihmojnë në forcimin e demokracisë dhe të ligjit, ata që i kanë përshëndetur bisedat mes të dyja palëve dhe janë po ata që janë duke bërë vazhdimisht të qartë Serbisë se Kosova është shtet sovran dhe i pandashëm.

E dyshimet në vullnetin e mirë të miqve tanë, nuk i kontribuojnë miqësisë. Të gjithë e dimë çka përmbajnë konkluzat që nuk kanë nevojë edhe të ratifikohen në Kuvend, as nuk ndikojnë fare në status. Ne u përgjigjemi atyre aq sa na takon pa bërë asnjë hap që nuk është në interesin tonë si shtet. Ne si vend, do të tregojmë pjekuri dhe vullnet politik, drejt politikës së bashkësisë ndërkombëtare, me qasje konstruktive, të moderuar dhe parimore, do ta shkurtojmë rrugën tonë drejt Bashkimit Evropian.

Ofensiva e mediave kohëve të fundit, është e kuptueshme se është e qëllimshme. Arsyeja është se edhe nuk kanë ndonjë alternativë, ajo që dinë është vetëm të shajnë dhe këtu tek ne, kjo është një formë për të njohur të tjetër apo për ta zënë vend në lajmet televizive apo për të qenë në faqet e para të gazetave ditore, e ndokush këtë e bën edhe për ndonjë donacion dhe kjo në ambientin tonë, është bërë tanimë rutinë që sa kohë.

Me ego të shfrenuar, duke u munduar se kush të mbajë primatin e të parit të opozitës, e të dashurisë së zjarhtë për atdheun, pa alternativa dhe ide për një opozitë të mirëfilltë, herë- herë po shfaqen fushata të egra të fyerjeve, gjuhës denigruese, pa takt në mungesë të edukatës dhe sensit. Në veprime të paargumentuara, në emër të një pseudopatriotizmi anakronik, synohet të krijohet mjegull, të dezinformohen qytetarët me

një qëllim të vetëm, pushtetin dhe vetëm pushtetin e asgjë më tepër, sepse në fund të fundit, ishin të gjithë këta që ne i kemi parë para se të vijë në pushtet Qeveria e zotit Thaçi, në vitin 2007. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në momentin kur kanë filluar bisedimet, në këtë Parlament është thënë se kanë filluar të papërgatitura dhe pa një platformë dhe një agjendë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kur është kërkuar platforma në këtë Parlament, nuk është sjellë, është kërkuar që të lëshohet një rezolutë shpejt e shpejtë, në mënyrë që sa më parë të fillojnë bisedimet, dhe platforma na vjen pasi fillojnë bisedimet dhe pasi të na arrijnë konkluzionet e ashtuquajtura, por që janë marrëveshje dhe kur është parë nga Qeveria se këto marrëveshje duhet të ratifikohen në Parlamentin e Kosovës, sepse ka qenë premtim i Qeverisë që të ratifikohen në Parlament dhe Parlamenti ka marrë vendim, atëherë vërtet po bëhet lojë fjalësh dhe janë zëvendësuar me konkluzione. Nëse janë konkluzione, a është marrë vesh dikush për këto konkluzione? Domethënë ka marrëveshje. Çka është kjo lojë fjalësh? Nëse ne i kemi lexuar ato konkluzione dhe të gjithë si deputetë i kemi kuptuar, çka ka nevojë të na i shpjegojë pak më ndryshe se sa ashtu si janë.

Nëse në Republikën e Kosovës, janë zëvendësuar targat nga KS Në RKS, në momentin e rikthimit të targave KS është një kthim prapa dhe një zmbrapsje dhe një pranim i një pushteti tjetër që, ju e dini që në kohën e UNMIK-ut, janë prodhuar dhe përsëri i jepen madje edhe detyra EULEX-it që të ndërmjetësojë në këtë drejtim, në mënyrë që edhe me targa të merret EULEX-I. Nëse këto marrëveshje, sepse janë marrëveshje, se janë marrë vesh tri palë, në këtë rast Kosova, Serbia dhe pala ndërkombëtare, atëherë obligim i Qeverisë është t'i sjellë këtu në Parlamentin e Kosovës dhe këtu të ratifikohen për arsye se duhet të marrin bekimin e Parlamentit.

Nuk është më koha që dikur është dashur të bëhen shpjegime të shumta, madje edhe mashtrime të shumta, siç e dini ju përmes frazeologjisë filozofike, duke i kamufluar veprimet të cilat janë krejtësisht konkrete. Aq shumë qenkan demokratizuar Serbia dhe Kosova, nga një konflikt kaq i afërt, sa në të tjera vende ne duhet të shkojmë me pasaportë, ndërsa në Serbi dhe Serbia në Kosovë, po mund të shëtisin lirë qytetarët derisa ne kemi struktura kriminale të cilat i furnizon Serbia përmes instrumenteve të veta në veriun e Kosovës.

Regjistrat civilë, u përmendën këtu, ai që e ka fotokopjen nuk është pronari, pronari është dikush tjetër dhe kush po do të na jap sqarime më të mira ose më të sakta se sa ajo që shkruan në dokument. Nuk është mirë po them edhe një herë nuk është mirë që në Parlamenti e Kosovës të ligjërohet sikur para nxënësve, sepse në fund të fundit të gjithë i kemi lexuar këto dokumente dhe i dimë. Dhe aq më keq është nëse dikush justifikon se mund të kuptohen edhe ndryshe nga ashtu qysh janë.

Nuk është mirë as këtu të ndahemi pozitë-opozitë, se në fund të fundit, jemi dëshmitarë se sa herë që ka pasur nevojë vendi për vendime shumë kuptimplote për vendin, jemi bashkuar të gjithë. Edhe për pavarësinë e Kosovës, edhe për Kushtetutën e Republikës së Kosovës, edhe për aktet më të larta, ligjet e Kosovës, e kush po do tash të ndajë në këtë llogari se dikush qenka “për” e dikush “kundër”. Dialog ka pasur edhe para luftës, e dini shumë mirë, dialog ka pasur edhe gjatë luftës, madje, dialog ka edhe tash, po dallimet janë, se pas 11, 12 vjetësh po bëjmë regres, pa nevojë, unë po flas për gjëra konkrete, nuk po flas për atë çka, në mendjen e dikujt mund të jetë për të mashtruar opinionin.

Nëse flasim, po flasim dokumente bazike të cilat ekzistojnë dhe janë në opinion, tani janë opinion. Asnjëherë nuk kanë ardhur nga bisedimet që të referojë zëvendëskryeministrja ose dikush nga delegacioni në këtë Parlament, derisa është thirrur seanca e jashtëzakonshme. A duhet edhe në marrëveshje tjera ne të thërrasim seanca të jashtëzakonshme për të na dhënë llogari dikush këtu se çka është kah bën me fatin e Kosovës?

Ne nuk duhet ta harrojmë një gjë. Nuk mund të sillemi si diletantë në kohën kur po themi kemi një përvojë të mirë të angazhimeve tona edhe në diplomaci edhe në politikë. Nuk është mirë që gjërat që janë konkrete tash t’i bëjmë në formë tjetër t’i shohim ose t’u japim një përmbajtje çfarë s’e kanë. Ne po flasim për elemente të cilat janë në konkluzione që për mua janë marrëveshje të arritura të cilat e ka për obligim t’i zbatojë Qeveria e Republikës së Kosovës. Nëse nuk i zbaton, janë sanksionet, pse nuk zbatohen? Prandaj, këtu nuk është mirë të luajmë lojë fjalësh, por ta përdorim fjalorin adekuat, atë shqip, i cili saktëson çdo fjalë të shkruar në konkluzionet e paraqitura. Dhe, nuk është mirë të pranojmë kurrkush prej neve si deputetë për shkak se kemi marrë votën e qytetarit të Kosovës që për hir të një pozicionimi të ndryshojmë qëndrimin tonë ose mendim tonë. Në fund të fundit jemi deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, të gjithë, mbajmë përgjegjësi para qytetarëve të gjithë dhe dijeni se ky dëm nuk i shkaktohet as pozitës as opozitës, iu shkaktohet të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe shtetit të Kosovës, nëse bëhet një hap prapa dhe ne po e shohim, shqip po flasim dhe shqip po kuptojmë që këtu ka kthim mbrapa. Dhe, ju kisha lutur edhe një herë si deputet, mos lejoni që asnjë milimetër, Kosova të tërhiqet prapa, përkundrazi, nëse duhet të japë dikush llogari për ato çka ka ndodhur në Kosovë, dhe për ato që sot bëhen ndaj Kosovës nga ana e Serbisë, duke ndërhyrë në territorin tonë, duke mos lejuar funksionimin e sovranitetit brenda shtetit, nuk duhet pranuar. Edhe një element, po e përmend, nëse partnerët, bashkësia ndërkombëtare ka ndihmuar Kosovën dhe po e ndihmon Kosovën, nuk është vetëm dikush që e ka krijuar këtë partneritet, të gjithë e kemi krijuar bashkë. Populli i Kosovës e ka krijuar këtë partneritet, prandaj pronësinë e partneritetit, nuk i lejohet kurrkujt ta marrë edhe të tjerët t’i fyejë se nuk qenkan partnerë me bashkësinë ndërkombëtare. Kujt i lejohet ky fjalor?

Në fund të fundit, cilido ka një mandat këtu dhe pas një mandati do të ballafaqohet me problemet, por jo vetëm ne, fëmijët e tanë do të pësojnë nëse ne lejojmë që Kosova, në

cilindo variant ose në cilindo element lëshon pe nga krijimi i shtetësisë. Me këto tri elemente që i kemi në konkluzione, jam i bindur se ka lëshim, ka degradim dhe nuk duhet lejuar. Duhet punuar me bashkësinë ndërkombëtare, në mënyrë që Serbia të japë llogari, Serbia t'i kryejë obligimet e veta që i ka edhe ndaj Kosovës edhe ndaj bashkësisë ndërkombëtare, pastaj normalisht fqinjët si fqinjë, gjithmonë do të kemi relacione, nëse i krijojnë mes vete, por jo dikush të na tërheq prapa edhe të vijë dhe të na shpjegoj këtu për elementet të cilat janë krejt konkrete, krejt shqip, krejt të njohura. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputetja Tetuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Mendoj që gjatë bisedave e kemi humbur këtë arsye pse jemi takuar këtu, pse është thirrur ky debat, pse është thirrur kjo seancë.

Është me të vërtetë për të ardhur keq që një brengë legjitime, e cila ka të bëjë me secilin deputet, me secilin qytetar të Kosovës, po keqpërdoret për të krijuar një mendim të rrejshëm që këtu pozita po e mbron Kosovën, ndërsa opozita është ajo e cila po e sulmon edhe po e degradon Kosovën.

Mendoj se duhet të koncentrohemi pikërisht në arsyen pse jemi sot këtu. Këtu nuk jemi pse jemi kundër bisedimeve, edhe pse shumica nuk e kemi. Shumë prej nesh nuk e kemi votuar Rezolutën. Ne jemi pjesë e Kuvendit dhe jemi të obliguar që të bisedojmë, që të përcjellim këtë debat dhe është për të ardhur keq që ka debat nuk ka ndodhur pikërisht me kërkesën e pozitës, me kërkesën e vet zëvendëskryeministres që të tregojë se çka po ndodhë me këto bisedime. Dhe, normalisht, në qoftë se prej këtyre bisedimeve kemi ardhur deri te disa konkluzat, marrëveshje, quajeni çkado, atëherë ajo është arsye që ne të mblidhemi këtu edhe të diskutojmë, të shohim se ku po shkon Kosova. A kemi mundësi që të ndikojmë pozitivisht atje? Edhe ato paralele që opozita është quar peshë edhe në të njëjtën në veriun e Kosovës po ndërmerren, po bëhen demonstrata, është totalisht e papranueshme, është shumë e papranueshme, është e rrezikshme, nuk ka vend që aso fjalë të përdoren në këtë Kuvend.

Më pëlqeu shumë diskutimi i zotit Arsim Bajrami, i cili tha që opozita duhet të japë tema të reja. Mendoj se pikërisht ky debat është për të dhënë tema të reja, për të diskutuar për atë se çka po ndodhë këtu, që këto konkluzione nuk janë marrëveshje, por këto konkluzione do të dërgojnë deri te një marrëveshje. A duhet të presim që të kryhet krejt puna, e pastaj ta thërrasim një debat e të diskutojmë? Mendoj që asnjëri prej nesh nuk e mendon këtë.

Nisja e bisedimeve u përshëndet nga bashkësia ndërkombëtare, por fillimi zyrtar i tyre ishte i përcjellë me mungesë totale të transparencës. Ky trend vazhdoi me Rezolutën e cila e përjashtoi totalisht Kuvendin, e më së shumti opozitën e përjashtoi nga ky proces.

Këto biseda në prag të marrjes të statusit të kandidatit për BE, për Serbinë, nuk kanë treguar vullnet për zgjidhjen e çështjeve, por për zgjidhje të përkohshme, për shtyrje të zgjidhjeve të mirëfillta për një periudhë tjetër, për blerje të kohës. Pas pesë apo më shumë vitesh, këto konkluzione e fortifikojnë status quon, mungesën e respektit për shtetin tonë, por tash të miratuara nga vetë ne, pala kosovare, siç shkruan aty, jo shteti i Kosovës, dhe kjo besoj që nuk i ndihmon shtetasit të Kosovës, qoftë ai shqiptar apo serb.

Në fakt vetë fjala “marrëveshje” ka një domethënie të mirë, tregon vullnetin e palëve për të zgjidhur një apo më shumë çështje apo për të përfunduar një status quo, që të hyjë në bisedime dhe maksimalisht të angazhohen për zgjidhje që tregon respekt dhe të jetë në dobi të dyja palëve, e marrëveshjen quaje si të dush, konkluzion, raport, përfundim, të nënshkruar apo të panënshkruar, është marrëveshje e cila i obligon këto palë.

Për tri temat për lirinë e lëvizjes, për pranimin e diplomave, për regjistrin civil, janë tema të rëndësishme dhe duhet të trajtohen seriozisht, të bëhen zgjidhje të mirëfillta, zgjidhje të përhershme, për të mirën e qytetarëve, të gjithë etnive, gjë për të cilën ne të gjithë angazhohemi, pa marrë parasysh kush është në pozitë apo kush është në opozitë.

Te konkluzioni i parë, lexoje marrëveshja e parë, liria e lëvizjes është gjë tepër e rëndësishme për çdo njeri, qofshin shqiptarë apo serbë apo të cilësdo përkatësi etnike, por në marrëveshje për lirinë e lëvizjes krahasohet kalimi me letërnjoftim me Shqipëri, me Maqedoni, me Mal të Zi, po në marrëveshje me këto shtete, ne nuk i quajmë kufijtë tonë, kufij administrativë e gjëra tjera të cilat janë në këto konkluzione me Serbinë.

Kosova quhet palë e jo shtet në paragrafin e parë. Në paragrafin e dytë thuhet: kufiri administrativ, sikur të ishte ai kufiri në mes të dy komunave të një vendi.

Në paragrafin 6, targat KS të kohës së UNMIK-ut vazhdojnë për 5 vjet. U shpjegua edhe prej parafolësve tjerë, çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë që shqiptarët do të vazhdojnë t’i marrin RKS, serbët do të vazhdojnë t’i marrin KS dhe do të kemi dy sovranitete brenda të njëjtit shtet, gjë të cilën mendoj se asnjëri prej nesh, pozitë a opozitë nuk e dëshiron këtë.

EULEX-i, do të shpërndajë targat e KS ose RKS, ju lutem, përsëri zgjidhje e përkohshme, blerje e kohës, tregimi vazhdon pa ndërprerje apo dokumentet hyrje- dalje do të përmbajnë gjuhën neutrale.

Fjala zgjidhje e përkohshme vetëm në konkluzionin e parë, përmendet 4 herë, a siguron ky konkluzion vërtet lirinë e lëvizjes dhe respektin për të dyja palët? Dikush tha ne duhet të besojmë në shtet, për shkak se ne besojmë në shtetin e Kosovës, po i shprehim këto brenga dhe ne me të vërtetë dëshirojmë ta mbrojmë atë besimin që e kemi në shtetin e Kosovës.

Sa i përket konkluzionit për librat amzë, çdo shtet i ka regjistrat e vet dhe ato që kanë uzurpuar këto dokumente origjinale, duhet pa asnjë marrëveshje, pa asnjë provizion, menjëherë të kthehen dokumentet që neve na përkasin.

Këto marrëveshje dhe procesi se si kemi hyrë në këto bisedime pa përfshirjen e Kuvendit, kur bisedimet nisen, e më vonë u pyet Kuvendi për leje për bisedime përmes rezolutës, ku jepen konsensione të mëdha për Serbinë e ku shtetësia e Kosovës vihet në dyshim, nuk ka asgjë tjetër përpos e njëjta shkollë politike e Serbisë si në çdo bisedim të cilin e kemi pasur gjatë historisë tonë.

Serbia po i lë përshtypje bashkësisë ndërkombëtare dhe BE-së se po merr pjesë në biseda, se dëshiron zgjidhje, se është konstruktive. Por, gjithë kjo Serbisë i nevojitet që të blejë kohën deri sa ta marrë statusin e kandidatit për BE, e nesër të vazhdojë punën për minimin e shtetit të Kosovës dhe për ndalimin e procedurave për të ardhmen evropiane të Kosovës, ashtu siç është duke bërë çdo ditë me shumë energji.

Përsëri po vendoset një deriçkë, një derë kontestuese, një grumbull që është thjeshtë një konflikt i ngrirë me të cilin ne duhet të merremi vazhdimisht. Askush nuk konteston nevojën për bisedime, prandaj është edhe ky debat, por këto bisedime, me këto konkluzione duhet të pezullohen, jo të ndërpriten, po të fillohen tjera me zgjidhje të përhershme jo aso me afate 1, 2, 5 vjeçare e tjera, të mirëfillta, të ratifikuara nga ky Kuvend, siç i kemi ratifikuar së fundit një numër të madh të marrëveshjeve ndërkombëtare për të mirën e Kosovës bashkë, edhe pozita, edhe opozita.

KRYETARI: Faleminderit! Ganimete Musliu, le të përgatitet Liburn Aliu.

GANIMETE MUSLIU: I nderuari kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Para se të filloj fjalën time, fillimisht më lejoni që singërisht ta komplimentoj sot zonjën Edita Tahiri, sepse nëse me të vërtetë nga opozita sot në Kuvend nuk është treguar ndoshta e denjë për përfaqësimin e Kosovës në ato bisedime, do të thotë me palën serbe, unë mund të them me singëritetin më të madh, zonja Edita Tahiri, ju sot keni qenë me të vërtetë përfaqësuese e denjë e zërit të femrave të Kosovës në Parlamentin e Kosovës, sepse deri tek parafolësja ime, zonja Teuta Sahatqija, keni qenë femra e vetme që për katër orë rresht debaton në këtë Kuvend të Kosovës.

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Qëndrimi i opozitës lidhur me bisedimet nuk bazohet substancialisht në interesat e vendit dhe qytetarëve, përkundrazi, me përhapjen e frikës përmes miteve të prapambetura se automatikisht pala shqiptare nuk është e aftë të mbrojë interesat e veta në çfarëdo bisedimesh, jo vetëm që shkakton konfuzion tek qytetarët e Kosovës, por është edhe shumë e dëmshme për të gjitha proceset nëpër të cilat po kalon vendi ynë.

Zhurmuesit e ditëve të fundit rreth çështjes së bisedimeve nuk dëshmojnë gjë tjetër vetëm se duke filluar nga vetja e tyre janë të bindur që shqiptarët nuk janë të aftë për bisedime

dhe janë të predestinuar të dështojnë. Kjo mënyrë e të menduarit dhe vepruarit është dekonstruktive dhe nuk iu shërben as vetë atyre.

Bisedimet nuk janë garë në të cilën ne patjetër duhet të jemi humbës. Edhe pse të dyja palët këto bisedime i komentuan si fitore të veta, fakt është që këto bisedime janë zhvilluar në nivel të dy shteteve sovranë, janë përafrim me standardet e botës demokratike dhe sinjalizojnë që Kosova dhe rajoni kanë hyrë në një fazë të re të zgjidhjeve të problemeve.

Do të ishte shumë më konstruktive sikurse opozita të ketë një qasje më serioze në proceset që po zhvillohen, por si duket ajo vetes i ka vënë vetëm një mision që përmes zhurmës, të veshur me parulla patriotike, të diskreditojnë një person të vetëm, i cili tani për tani është i pakapërcyeshëm për ta.

Për kohë të shkurtër mund të mendohet se kjo strategji do të bartë fryte te qytetarët e Kosovës, por mund të them me sinqeritetin më të madh, e qytetarët e Kosovës nuk janë naivë që të lejojnë të manipulohen sipas dëshirës dhe disponimeve ditore të personave të cilët Kuvendin e Kosovës e shndërrojnë në platformë të inateve të tyre personale. Të përhapet frikë në opinion vetëm e vetëm për të diskredituar një kryeministër, është e pa përgjegjshme për secilin që në këtë Kuvend është në cilësinë e përfaqësuesit të popullit. Mendoj që nuk është as e logjikshme, as e shëndoshë apo përparimtare që dy shtetet fqinje të këmbëngulin në kundërshtimin e njëra-tjetrës, me dhunë e presion nuk do të zgjidhet asnjë problem në Evropë. E vetmja formë me të cilën duhet të arrihen zgjidhjet, është ajo e dialogut.

Dua që shkurtimisht ta citoj edhe një filozof të madh, i cili i thotë një miku të vet, kur ia shkruan një letër: “I nderuari mik, më fal që të kam shkruar aq gjatë, se nuk kisha kohë për të shkruar më shkurt”, prandaj edhe Kuvendi i Kosovës, sikur po iu gjason letrave të atij shkrimtari ose filozofi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Liburn Aliu e ka fjalën, le të përgatitet deputetja Donika Kadaj-Bujupi!

LIBURN ALIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Përderisa negociatat po vazhdojnë, po vazhdojnë kompromiset me Serbinë, Serbia po i afrohet çdo ditë e më tepër statusit të vendit kandidat në BE, pra po i afrohet këtij statusi, natyrisht, përmes ndihmës sonë dhe shërbimit që po i bëjmë përmes negociatave shumë të nevojshme për të. Që Serbia po e merr statusin e vendit kandidat me ndihmën tonë, është e pa drejtë, pasi ne po e ndihmojmë, e njëkohësisht ajo nuk po na njeh, por fakti që Serbia po e fiton këtë status pa u trajtuar fare çështja e shqiptarëve në Bujanovc, Medvegjë e Preshevë, kjo është e tmerrshme e këtij procesi dhe edhe më të tmerrshëm e bën fakti që Qeveria jonë është pjesë e pandashme e këtij procesi.

Në BE tani nuk trajtohet çështja e shqiptarëve në Bujanovc, Medvegjë e Preshevë. Kjo është e mbyllur dhe shqiptarët në këto tri komuna konsiderohet se i gëzojnë të drejtat e

tyre. Nuk u bën fare përshtypje se pandërprerë në BE sot futen refugjatë nga këto tri komuna, nuk u bën fare përshtypje që territoret e tëra po zbrazen, ku Medvegja nga 2600 shqiptarë që kishte para disa vitesh, ka ngelur në më pak se 500 dhe nuk po u bën fare përshtypje prezenca e xhandarmërisë serbe, terrori ndaj qytetarëve dhe varfëria e tyre që vazhdojnë të jenë ende atje.

E trajtojnë kështu këtë çështje, se e duan të mbyllur, e duan të mos jetë më çështje, që të jetë akt i kryer. Në tërë këtë, politika e Qeverisë së Kosovës ishte dhe mbeti politika që ndihmoi dhe po e ndihmon ekzekutimin përfundimtar të çështjes së shqiptarëve në Bujanovc, Medvegjë e Preshevë, qoftë me heshtjen e saj, qoftë me aktivitetin e saj pacifikues të gjendjes së pa zgjidhur. Dhe kjo politikë nuk është vetëm e sotme, kjo i ka fillat më herët, që nga lufta e UÇPMB-së, luftë kjo e cila u përkrah vetëm në fillimin e saj deri sa në pushtet ishin Millosheviqi dhe me rënien e tij, shqiptarët atje filluan të braktisen dhe në terren të relaksohen. Fati i asaj lufte dhe marrëveshja pothuaj u përcaktuan që atëherë. Që atëherë ndryshoi politika për shqiptarët atje, ata filluan të braktisen, shumë figura të luftës u vranë në përfundimin e saj, një pjesë u larguan fare, një pjesë burgjeve dhe një pjesë tjetër filloi këshillimi për integrim në institucionet qendrore në Beograd dhe atyre nuk iu mbeti rrugë tjetër. Kjo politikë e tillë pastaj u shoqërua edhe me dhunën pa pretekst, dëbimin nga ana e shtetit serb që shihej nga bota tani si shtet i moderuar. Nga ana tjetër, negociohej dhe nuk flitej asgjë në negociata që bëheshin, por në anën tjetër premtuhej, iu premtuhej qytetarëve të Preshevës se do të flitej për ta vetëm sa për t'i relaksuar.

Edhe sot Serbia po e merr statusin e shtetit kandidat në BE dhe nuk flitet për shqiptarët atje. Dhe prapë për t'i relaksuar këta, flitet për diplomat e njohura si një arritje. Gjendja e rëndë, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, politikë relaksuese që po e mundëson zbrazen pa dhimbje, pa poterë. Para diplomave, çështje është mbijetesa e shqiptarëve atje, të drejtat elementare dhe ndalimi i politikës së diskriminimit e të dëbimit janë çështje, heqja e xhandarmërisë dhe demilitarizimi i zonës. Atyre u duhet të marrin frymë së pari, sepse për të marrë frymë lirshëm, po duhet ta braktisin vendin. Çështja e diplomave është njëra nga problemet, por kjo nuk e zgjidhë problemin e përgjithshëm të shqiptarëve atje. Në zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve atje duhet të pyetën shqiptarët, duhet të merret parasysh referendumi i vitit '92 dhe platforma e vitit 2006, e cila kërkon reciprocitetin me serbët e Kosovës dhe bashkimin me Kosovën në rast të ndryshimit të kufijve.

Këtu, sapo dëgjova edhe nga zoti Thaçi, po edhe nga të tjerët, se politikanët në Preshevë po i përkrahin negociatat dhe konkluzat që dolën nga këto negociata.

Dua vetëm t'ju bëj me dije që të gjithë shqiptarët në Preshevë dhe Bujanovc i kanë përkrahur këto negociata, i kanë përkrahur si shpresë që do të ketë farë lloji këmbimi territorial. Në anën tjetër, nga Qeveria e Kosovës iu ka dërguar sinjale të dyfishta që do të ketë edhe..., edhe këmbim territorial dhe unë mendoj se edhe në këtë situatë ju prapë i keni mashtruar ata. Ju ndoshta mendoni që jeni të shkathtë që i keni mashtruar, por nuk ka qenë e vështirë të mashtrohen shqiptarët e Luginës së Preshevës. Pse nuk ka qenë vështirë të mashtrohen? Sepse ata nuk kanë rrugë tjetër, nuk kanë rrugë tjetër pos t'i besojnë Kosovës dhe kur kërkohet prej tyre që t'i përkrahin këto negociata, ata do t'i

përkrahin prapë. Pra, ajo që Kosova, Qeveria e Kosovës bën sot me shqiptarët e Preshevës, të Bujanovcit dhe Medvegjës, është një krim shumë i rëndë, po luan me ta, sikur vazhdimisht edhe më herët.

Desha t'ua përkujtoj se në luftën e UÇK-së, pjesëmarrës kishte edhe luftëtarë nga këto tre komuna, dhanë djersën, gjakun e tyre edhe përgjatë luftës edhe më herët. Dhe gjatë viteve '90, kur shqiptarët e kësaj ane qëndronin ekonomikisht më mirë se shqiptarët në Kosovë, ata ndihmonin familjet e Kosovës ekonomikisht dhe kur dikush ndiqej, gjente kollaj strehë atje. Kur nënat e Kosovës i kishin djemtë në burgjet e Serbisë, dyert i kishin përherë të hapura për të gjetur pak strehë para se të niseshin në vizita në burgje në Serbi. Pra, këta ishin shqiptarët e Preshevës për ne, ne sot s'jemi për ta.

Dhe, zotërinj, të përpiqesh sot për shqiptarët e shtypur në këto komuna dhe kudo që janë ata, nuk është pan-shqiptarizëm, ky është thjeshtë një obligim njerëzor, në fund të fundit. Publikimi tani së voni nga Wikileaks për takimin e zotit Thaçi me zëvendësambasadorin amerikan Michael McMurphy, ku Thaçi ishte ankuar për kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, zotin Sali Berisha për përzierjen në punë të brendshme të Kosovës dhe ndër të tjera shfaq shqetësimin për pan-shqiptarizmin e Shqipërisë ndaj Kosovës, kjo është pikërisht edhe një fakt shtesë në krejt këtë politikë tejte të mbrapshtë.

(Ndërhyrje)

Jo, unë e di shumë mirë që është...! Ju duhet të deklaroheni kundër!

Mendoj që do të duhej të ndodh një distancim i detyrueshëm në lidhje me këtë deklaratë, të bëhej një sqarim tejte i nevojshëm lidhur me këtë deklaratë. Pra, ky qëndrim i publikuar në Wikileaks duhet sqaruar para deputetëve, para opinionit, pasi jam i bindur se ky qëndrim nuk është qëndrim i PDK-së, nuk është qëndrim i anëtarëve të saj që unë i njoh dhe i shumë deputetëve që janë këtu prezent, pasi që ky qëndrim është në kundërshtim të plotë me të kaluarën e tyre dhe me veprimtarinë dhe përpjekjet e juaja deri sot. Ju duhet ta sqaroni këtë punë! Të gjithë ju deklaroheni së paku intimisht që jeni pro Shqipërisë, së paku kjo ka qenë edhe në betimin e ushtarëve të UÇK-së, ju e keni të obligueshme ta sqaroni këtë para opinionit. Kjo është publikuar. Pra, është shumë i nevojshëm një distancim nga ky publikim, po sidomos është i nevojshëm një distancim nga politika e Qeverisë që po godet vazhdimisht veprimtarët e vet, të gjithë bashkë njëherësh, si dhe veç e veç e një nga një, deri sa asnjë prej jush të mos mbetet. Duhet të distancoheni!

Pra, ajo çka desha të them tjetër në lidhje me zotin Thaçi, pak më herët që tha, që tha dallimi në mes nesh qëndron tek bunkerët, gjë që edhe më herët e ka pas deklaruar që qëndron, sepse ne e kemi flamurin me yll e krejt këto gjëra. Unë, vetëm po më çudit ky fakt, sepse po e kuptoj prej nga i vjen në mendje ky mendim. Nuk ka të bëjë me neve. Ne jemi, sigurisht, moshë mesatare jona nuk ka të bëjë as me bunkera, as me flamurin me yll, po mua më kujtohet shumë qartë, që me datën 25 prill të vitit 1991, pranë varrit, pra viti 91, jo 89 as 88, as vitet e 80, 91 pranë varrit të një dëshmori në përvjetor pranë flamurit me shqiponjë e me yll ka përshëndetur me grusht, po pse po e shkelë këtë të kaluar vet,

kjo është e kaluara e tij, është e kaluesja e juaj, pse po e shkelni, pse po i shkelni ata njerëz, a po kupton, kjo është e kaluara e juaj, nuk duhet t'i shkelni ju ata! Në fund të fundit, prej kësaj e keni gjenezën. Dhe tjetra, dallimi real, dallimi real në mes nesh nuk qëndron pra te këto. Dallimi real në mes nesh qëndron pikërisht sepse ne jemi për të drejtën e bashkimit me Shqipërinë, si kusht për stabilitet afatgjatë në Ballkan dhe ju po e luftoni këtë ndikim të Shqipërisë, pikërisht duke e akuzuar Shqipërinë para botës, siç është rasti tek publikimi në Wikileaks.

Në anën tjetër, do të duhej të sqarohej patjetër edhe një gjë, sepse ne jemi deputetë dhe kemi nevojë për sqarime shtesë. Para pak kohësh është publikuar në TV Klan një film dokumentar francez, ku thuhet se kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi, është agjent i shërbimit sekret francez dhe gjëra tjera. Duhet kjo gjë të na sqarohet neve. Ne duhet ta dimë kë e kemi kryeministër. Ne kemi nevojë për sqarime të tilla, sepse në anën tjetër po ndodhin negociatat, e në anën tjetër këto negociata po mbrohen në emër të patriotizmit dhe po dalin gjëra krejtësisht tjera.

Për sa i përket patriotizmit dhe pseudopatriotizmit të zonjës Tahiri, e lus shumë thjeshtë, mos e humb kontrollin në këtë pikë, sepse nuk duhet të hapet kjo punë, sepse nëse fillon të hapet kjo temë në baza individuale jo kush ka qenë e kush s'ka qenë këndej pari, mund të dalë gjithçka prej kësaj pune.

Po ashtu, kur është fjala për gurët në institucione, për ngjyrë në institucione. Atë ditë ju në institucione e mbani përfaqësuesin e shtetit, i cili në Kushtetutë Kosovën e sheh si pjesë të saj dhe lirinë e Kosovës e godet përditë. Ne e goditëm me gurë dhe bëmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, edhe një minutë!

LIBURN ALIU: Pra, ne goditëm institucionet me gurë kur e kishit ju Borisllav Stefanoviçin brenda dhe ne vepruam shumë drejt. Tjetra, kur bëhet fjalë për flamurin e Kosovës, flamurin e Kosovës nuk e di kah e shpiku zoti Thaçi, ne nuk e kemi djegur, po nuk po dua të hyj andej pari. Ne nuk e respektojmë këtë flamur, sepse ky flamur ka ardhur me konkurs, konkursi ka pas kushte, jo s'guxon të ketë këtë ngjyrë, jo s'guxon të ketë atë ngjyrë. Flamujt nuk vijnë me konkurse. Flamujt janë mishërim i kulturës, i historisë së një populli dhe ky flamur nuk e paraqet as historinë, as kulturën tonë dhe, rrjedhimisht, shumë thjeshtë, ne nuk e pranojmë, nuk e njohim dhe kudo bëjmë propagandë të suksesshme kundër këtij flamuri...

KRYETARI: Kthehu në temë, në temë! Realisht, s'është temë flamuri sot!

LUBURN ALIU: ...Ne e mbajmë këtë flamur me vete për një arsye të thjeshtë, sepse është i rrezikuar kudo, edhe këtu në institucione, edhe kur takohemi me diplomatë të huaj. Te shtëpia s'kemi nevojë ta mbajmë, sepse i kemi në mure. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën! Më fal, se mendova e kreve ti. Më fal! Donika Kadaj-Bujupi!

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Një nismë e cila për bazë ka shpëtimin e një karriere shumë të përfulur me përplasje të mëdha në fusha senzitive, siç janë integriteti dhe kredibiliteti i një kryeministri, dyshimet e raportuara për involvim në korrupsion, ngulfatje të mediave e tjerë, e tjerë ka bërë që Kosova sot të paguajë çmim tepër të lartë, duke pranuar fillimisht të futet në bisedime, si palë e pa barabartë. Dhe disa muaj pas, përkundër zotimeve të kryeministrit Thaçi në këtë seancë se çdo marrëveshje do të ratifikohet në Parlament, sepse bisedimet po zhvillohen në nivel të dy shteteve të barabarta, kjo nuk ndodhi. Nuk ndodhi sepse nuk ka qenë e vërtetë, sepse nuk është e vërtetë as sot dhe tani kur ndodhi, e pavërteta doli në pah.

Mirëpo, nuk është këtu problemi, sepse kryeministri Thaçi me të pavërtetën të cilën e plasoi në opinion, nuk përbën asnjë lajm, ai tanimë njihet që gjithçka çka bën, e bazon në mashtrim dhe të pavërteta.

Problemi qëndron se kjo e pa vërtetë ka prodhuar konkluzione e marrëveshje apo si do që i quajmë, të gjetura, të cilat avancojnë pozitën e Serbisë për status të kandidatit për BE në dëm të Kosovës.

Me veprimet e veta kryeministri Thaçi edhe një herë konfirmoi pretendimin e Serbisë për sovranitet të vazhdueshëm ndaj Kosovës. Kryeministri Thaçi duke kërkuar derë dalje për t'i shpëtuar ligjit, pranoi që përmes konkluzioneve ose si po i quajmë herë konkluzione, herë marrëveshje, të dëmtojë seriozisht duke pakësuar statusin e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur dhe kjo me theks të veçantë po reflektohet në veriun e Kosovës.

Kryeministri Thaçi, i zënë ngushtë ndërmjet llogaridhënies, e cila do të pasqyronte veprimet jo ligjore gjatë mandatit të kaluar dhe vazhdimin e tij, pranoi që të japë elemente të shtetësisë, të sovranitetit dhe integritetit në shkëmbim të një amnistie. Dhe këtë e bëri në takimet e fshehta, shumë kohë më parë, kur Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës alarmoi opinionin se po ndodhin takime të pa zyrtarizuara, të fshehta, në dëm të Kosovës, takime para këtij dialogu, të cilat përmes mediave të ndryshme të caktuara u keq informuan, u orkestruan dhe u kthyen kundër nesh.

Sot, i nderuar kryetar dhe të nderuar kolegë deputetë, nuk po më vjen mirë që duhet t'ju themi - ju kemi thënë. Aleanca ju ka thënë më tepër se një vit që është duke ndodhur, janë duke ndodhur bisedime të fshehta që nuk janë në të mirën e vendit dhe që Kosova është vënë në pazar. Ju kemi thënë, po edhe atëherë, edhe tash, fatkeqësisht, përmes mediave të caktuara është keq informuar opinionin dhe janë kthyer kundër nesh.

Duke pranuar të futet në një dialog të pa legjitimitet, kryeministri Thaçi mohoi ekzistencën e shtetit dhe si pasojë edhe perspektivën për njohje, që do të duhej të ishte fokus kryesor, pra mohuat konsolidimin e mëtutjeshëm të pavarësisë.

Në mesin e shumë dështimeve, do të mbahet në mend kjo Qeveri dhe kryeministri, i cili bëri kompromis me atributet e shtetit. Edhe një herë, emrin e Republikës dhe kjo nuk është teknike, e nderuara zëvendëskryeministre, atributet e shtetit nuk janë tema teknike. Vulat dhe simbolet e tjera dhe këto i bëtë në emrin personal dhe emrat e juaj do të radhiten në mesin e atyre, të cilët për pak pushtet janë të gatshëm të japin shtetin.

Është fat në fatkeqësi që pronësia mbi konkluzionet është vetëm e juaja, është ekskluzivisht e juaja dhe rrjedhimisht pasojat do i bartni vetë. Edhe pse për keq qeverisjen që po bëni, një çmim tepër të lartë po e paguan Kosova.

I nderuar kryetar, si kryetar i këtij Kuvendi dhe të gjithë kolegë deputetë, pavarësisht pozitë dhe opozitë, unë ju ftoj që të rezistojmë ndaj këtyre konkluzioneve sot bashkë, sepse rezistenca e këtij Kuvendi do të ndalojë aranzhmane të dëmshme, të cilat vazhdojnë në dëm të pavarësisë së fituar me vështirës, prandaj rekomandoj që qysh sot Kosova dhe ky Kuvend të dalë dhe të rezistojë fuqishëm ndaj përpjekjeve të imponuara për vazhdim të bisedimeve me Serbinë, përderisa nuk kemi platformë të qartë për përfitimet që do i ketë Kosova, sepse rruga në të cilën na ka futur Qeveria Thaçi, është e rrezikshme, e pa shteg dhe do të ketë pasoja për të ardhmen dhe të tashmen e vendit. Nëse s'e ndalim sot këtë politikë të çmendur, nesër kur të tjerët do të jenë në pushtet, dëmet do të jenë të përmasave të pariparueshme dhe kjo do të prodhojë jo stabilitet dhe kriza të reja për Kosovën dhe rajonin. Kosova nuk guxon të lihet peng në duart e disa njerëzve të korruptuar, sepse stabiliteti, progresi dhe suksesi i Kosovës është angazhim afatgjatë i përpjekjeve të përbashkëta, prandaj ndërprerja e menjëhershme e këtyre bisedimeve duhet të shihet përtej interesave partiake dhe individuale dhe Kuvendi sot duhet të kryej obligimin kushtetues për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit të Republikës së Kosovës dhe edhe një herë po i referohem fjalës së dikujt këtu që tha – Kosova do të përfundojë në izolim, nëse nuk flasim dhe nuk dialogojmë me Serbinë. Kjo është një e pavërtetë! Kosova nuk do të izohet nëse mbron sovranitetin dhe integritetin e saj territorial sepse kjo është e drejtë e jona kushtetuese. Në izolim eventualisht mund të përfundojnë ata të cilët bënë pazare në emër të Kosovës dhe të cilët tani nuk guxojmë t'i lejojmë t'i zbatojnë këto pazare, sepse prapë do të jenë në dëm të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami, le të përgatitet deputeti Ramiz Lladrovci.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit! I nderuar kryetar,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Konkluzionet e publikuara më 2 korrik të këtij viti, të arritura në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë janë në favor të Serbisë dhe si të tilla janë në dëm të Kosovës. Këto konkluzione vënë në pah pretendimin e vazhdueshëm të Serbisë ndaj Kosovës dhe zbehin pavarësinë e Kosovës si shtet i pavarur, duke e kthyer atë në kohën e UNMIK-ut, para shpalljes së pavarësisë. Në këto bisedime me të cilat Qeveria është shumë e kënaqur, del se pozicioni i Serbisë mbrohet dhe përkrahet nga ndërmjetësuesit

ndërkombëtarë, derisa në të njëjtën kohë Qeverisë së Republikës së Kosovës i mohohet gjithë legjitimiteti, duke e kthyer atë në epokën kur për fatin e saj vendosej në Beograd nga UNMIK-u apo EULEX-i. Por, kush ka faj për këtë? Natyrisht se jo ndërkombëtarët, por ata që po bisedojnë në emër të Kosovës.

Qeveria e Kosovës ka bërë kompromise të cilat e kanë dëmtuar rëndë pozicionin tonë ndërkombëtar. Ju falënderoj shumë zëvendëskryeministër, që po e liron sallën, vazhdimisht po akuzohemi që s'po japim alternativa, ne alternativa po japim, po s'po kemi kujt t'i japim alternativa.

Qeveria e Kosovës ka bërë kompromise të cilat kanë dëmtuar rëndë pozicionin tonë ndërkombëtar. Qeveria ka pranuar që kufijtë që e ndajnë Kosovën dhe Serbinë të quhen kufi administrativ, ka pranuar të ketë targa KS në vend të atyre RKS që simbolizojnë Republikën e Kosovës. Qeveria ka pranuar që Serbia të na konsiderojë neve si një komunë në kuadër të sajë duke na lejuar që të udhëtojmë me letërnjoftim dhe me një copë letër të vizitorit. Ka pranuar të marrë kopje të regjistrave civilë, të regjistrave tanë dhe të mos harrojmë se kopjet e regjistrave civilë janë ofruar edhe në Vjenë, por Kosova i ka refuzuar.

Duke marrë parasysh të gjitha këto, zëvendëskryeministrja dhe të tjerët guxojnë të thonë se ky është hapi i parë drejt njohjes së Kosovës nga ana e Serbisë. Nëse ky është hapi i parë, atëherë kjo rrugë ka aq shumë hapa, sa që edhe pesë gjenerata pas zonjës Tahiri do të dialogojnë për ta përfjetuar njohjen e Kosovës nga ana e Serbisë.

Është tepër e rrezikshme që Qeveria të pranojë çdo kompromis që dëmton statusin e Kosovës në bazë të cilit janë siguruar njohjet dhe vazhdojnë të kërkohen. Kushtetuta nuk lejon as Qeverinë dhe askënd tjetër të pranojë kompromiset që mohojnë realitetin e krijuar nga 17 shkurti 2008, që e mohojnë Republikën e Kosovës, vulat, dokumentet zyrtare dhe elementet tjera që janë pjesë e qenësisë së shtetit të Kosovës.

Kjo Qeveri me të vërtetë ka probleme shumë të mëdha, deri në masën sa nuk është e sigurtë as me vetveten. Nëse marrim platformën e bisedimeve dhe konkluzionet e arritura, ato janë në kundërshtim të plotë me njëra - tjetrën.

U përmend edhe më herët nga parafolësit, emri i platformës. Platforma e Qeverisë së Republikës së Kosovës për dialogun teknik ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë në vete përmban dy të pa vërteta të mëdha. E para, Kosova në bisedime nuk ka shkuar si Republikë, po ka shkuar si Prishtinë dhe, e dyta, këto bisedime nuk janë aspak teknike, por shumë politike. Nëse zëvendëskryeministrja nuk ka biseduar për statusin e Kosovës, Stefanoviqi i ka thënë se nuk i pranon pasaportat e Republikës së Kosovës, nuk i pranon targat me RKS dhe për t'i pranuar diplomat, nevojitet edhe ndërmjetësimi i palës së tretë dhe nuk i dorëzon regjistrat civilë, por Kosova mund të marrë vetëm kopje të tyre. Atëherë, çka? Ju lutem, të ma thoni dikush, a nuk është kjo politikë? Nëse këto tema nuk janë politike dhe quhen nga dikush teknike, kjo është e pa pranueshme dhe e pa përgjegjshme.

Unë kam një problem me Qeverinë, nuk po e di, a s'po dinë, a s'po donë?

Në hyrje të platformës për bisedime thuhet se Qeveria e Republikës së Kosovës ka obligim ndërkombëtar për të hyrë në dialogun ndërshtetëror midis Republikës së Serbisë dhe Republikës së Kosovës konform Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, në përputhje me kompetencat kushtetuese të Qeverisë për të ushtruar sovranitetin shtetëror në politikën e jashtme të vendit, sipas nenit 93 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Me konkluzionet e arritura, neni 93 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës u shkel, u shkel duke e kthyer Kosovën në kohën e UNMIK-ut. Udhëtimi nëpër Serbi me letër njoftim dhe kthimi i tagrave KS, pranimi i kopjeve të regjistrave civilë, janë shkelje kushtetuese, janë kthim prapa në kohën para shpalljes së pavarësisë.

Po ashtu, domethënë, kemi plot kundërthënie në mes të platformës dhe konkluzioneve të arritura, sikur kur thuhet që do të dialogohet pa e prekur në asnjë rast sovranitetin dhe integritetin territorial, pavarësinë e Kosovës dhe rregullimin e brendshëm. Ne mendojmë se me konkluzionet e arritura, kjo pikë nuk u respektua.

Gjithashtu, në pikën 5 flitet për transparencë të platformës, të cilën e kemi marrë vetëm para një jave, flitet për transparencë dhe raportimin që kryenegociatorja duhet t'i bëjë këtij Kuvendi, kjo nuk ka ndodhur. Qeveria ka dështuar plotësisht dhe Kuvendi më shumë është informuar nga mediat se sa nga zëvendëskryeministrja.

Pika 6 thotë se marrëveshjet do të ratifikohen në Kuvend. Marrëveshjet tani po quhen konkluzione dhe si të tilla i ikën ratifikimit.

Miq të tanë ndërkombëtarë, së bashku me zonjën Tahiri dhe Stafanoviqin shkuan aq larg, sa që zbuluan përdorimin e fjalës konkluzë, në kontekstin që nuk është parë as nuk është dëgjuar më herët. Kjo me qëllim që një dokument i tillë të mos vjen në Kuvend për ratifikim. Konkluzionet janë skica dhe projekte që iu paraprijnë marrëveshjeve, por assesi dokumente që obligojnë një vend për t'i implementuar.

Me transformimin e marrëveshjeve në konkluzione, Serbia ka fituar dy herë. E para, i ka ikur tërësisht elementeve të shtetësisë së shtetit të Kosovës, e dyta, i ka ikur implementimit të këtyre konkluzioneve, ngase ky dialog nuk po rezulton në marrëveshjen në mes dy qeverive, të cilat, në bazë të Kushtetutës do të ratifikoheshin në Kuvend dhe do të zbatoheshin në të mirë të qytetarëve.

Kur jemi te implementimi, nuk mund të lë pa e përmendur çështjen e njohjes së diplomave, me të cilat sot u lavdërua shumë. Të themi se nostrifikimi apo njohja edhe mund të bëhet në prezencën e palës së tretë, po unë pyes kryeministrin dhe ndërkombëtarët dhe zëvendëskryeministrin – a do të jetë pala e tretë prezente në secilën intervistë për punë kur shqiptarët e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit do të vazhdojnë të diskriminohen? Kjo është një çështje krejt praktike dhe ne të gjithë këtu e dimë se për këtë çështje nuk ka zgjidhje.

Ne nuk jemi kundër dialogut, ne nuk jemi kundër miqve ndërkombëtarë, por para se gjithash neve nuk jemi kundër vetes, nuk jemi kundër pavarësisë së Kosovës dhe cenimit të sovranitetit të vendit tonë, pavarësi kjo e cila kushtoi shtrenjtë dhe u fitua me mund e me gjak. Bisedimet e tilla duhet të pezullohen menjëherë, se deri tani në emër të përmirësimit të jetës së qytetarëve po shkatërrohet e ardhmja e tyre, po shkatërrohet ajo që u ndërtua me mund dhe me gjak.

Dhe, për fund, kam diçka tjetër, për dallim do të thotë nga deputetët e Partisë në pozitë, unë nuk habitem nga se energjia e tri partive opozitare për t'u bashkuar kundër këtyre konkluzioneve shumë të dëmshme për Kosovën, por mua më çudit fakti dhe fuqia e pushtetit që i ka ngulfatur deputetët e PDK-së, të cilët edhe pse e dinë se këto konkluzat janë të dëmshme, i përkrahin ato. Të nderuar kolegë, thërrisni ndërgjegjes, nëse votat i keni marrë nga populli, atëherë duhet ta përkrahni popullin dhe t'i dilni në mbështetje atij. Përkrahni, duke votuar pro propozimin tonë për pezullim të këtyre bisedimeve të cilat janë të dëmshme!

Dhe, nuk është e vërtetë që s'po japim alternativa, domethënë një prej alternativave është pezullimi i këtyre diskutimeve, pezullimi i menjëhershëm deri sa Qeveria e Republikës së Kosovës ta ketë një platformë të qartë, një platformë të cilën do ta respektonte, zoti kryeministër, qeshu, por platformën nuk e ke respektuar, me konkluzionet e arritura në çdo pikë është në kundërshtim platforma me konkluzionet e arritura. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës merr z. Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit! Deputeti Ramiz Lladrovci e ka fjalën!

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Debati i sotëm rreth çështjes së shumë përfolur të dialogut Kosovë Serbi mendoj se ishte i domosdoshëm, e mbase është dashur të ndodhë edhe më herët në Kuvendin e Kosovës.

Më duhet t'ua sjell në vëmendje edhe një herë se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i kërkuar nga faktori ndërkombëtar dhe i përcaktuar në Rezolutën e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, të miratuar më 9 shtator të vitit të kaluar, tani ka filluar me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe që po lehtësohet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Opinionin kosovar ka nevojë dhe ka shumë të drejtë të dijë rreth këtyre bisedimeve. Për transparencë të bisedimeve na kanë sugjeruar së fundmi edhe miqtë tanë ndërkombëtarë, që gjatë gjithë kohës na kanë mbështetur në gjitha angazhimet dhe përpjekjet tona për bërjen dhe për ndërtimin e mëtejshëm të shtetit.

Bisedimet Kosovë - Serbi do të duhej të ndodhnin një ditë gjithsesi, dhe është shumë mirë që këto kanë nisur dhe po zhvillohen tashmë për çështje praktike, të cilat kanë të bëjnë

drejtpërdrejt me jetën e qytetarëve të dyja shteteve. Këto bisedime mendoj se duhet t'i marrim seriozisht, në të njëjtën kohë duke pasur kujdes që të mos humbim asgjë nga ajo që është shtetësi dhe sovranitet i Republikës së Kosovës.

Për neve si institucione dhe si të zgjedhur të popullit të Kosovës, edhe ky proces bisedimesh është si edhe proceset e mëhershme, kanë peshë dhe rëndësi të veçantë, sidomos kur e kemi parasysh që ato janë mbështetur dhe inkurajuar nga personalitete të shquara dhe përfaqësues të lartë të mikut tonë të madh, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe nga miqtë tanë evropianë.

Dialogun si të tillë e kanë mbështetur dhe inkurajuar zëvendëspresidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe miku i madh i Kosovës, zoti Xhozef Beiden, Sekretarja e shtetit të SHBA dhe mikja e madhe e Kosovës, zonja Hillari Klinton, ndimëssekretari i Shtetit, zoti Kantrimen e shumë e shumë shtetas tjerë amerikanë.

Pro këtij procesi janë deklaruar edhe miqtë tanë evropianë, e së fundmi edhe përfaqësues të lartë të Britanisë së Madhe, të cilët krahas kësaj e konfirmuan jo më larg se dje edhe mbështetjen dhe garancinë e fuqishme për sovranitetin dhe tërësinë territoriale të Kosovës. Ne assesi nuk duhet t'i injorojmë këto mbështetje, kërkesat e tyre për të ecur bashkë përpara janë e vetmja rrugë e sigurt për Kosovën, kjo për faktin sepse sukseset e Kosovës i atribuojnë substancialisht ndihmës dhe përkrahjes së këtyre shteteve mike që kanë qenë vendimtare dhe të vazhdueshme.

Për më tepër, dialogu me fqinjësi është edhe standard i parë i secilit vend dhe popull që synon hyrjen në Bashkimin Evropian.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në të njëjtën kohë duhet të jemi të vëmendshëm në hapat praktikë të bisedimeve. Këto janë përgjegjësi e jona dhe atyre që janë mandatuar në këtë proces për të dialoguar me Beogradin. Askush nuk ka të drejtë të dalë jashtë kornizave në të cilat janë mandatuar që të bisedojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi, le të përgatitet Idrizi Vehapi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja dhe zotërinj,

Kolegë deputetë,

Në fakt, në qëllimin tonë për këtë seancë të jashtëzakonshme marrim një arsyetim sidomos nga ana e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, një arsyetim shumë të zbrazët dhe njëkohësisht edhe një lexim shumë të dobët të atij arsytimi. Por, sidoqoftë, le ta ritheksojmë edhe një herë, është për t'u vu në pah arsyeja e ballafaqimit tonë me këtë seancë të jashtëzakonshme.

Nuk e di, kolegë deputetë të Partisë Demokratike, a po e dinë arsyen pse ne e kemi sot këtë debat apo nuk po e dinë, dhe insistimi i tyre për të mbrojtur me çdo kusht rezultatin,

sidomos rezultatin e këtyre bisedimeve, po edhe të bisedimeve në tërësi, mendoj që është një tradhti e vullnetit të tyre personal që e kanë. Arsye pse ata bëjnë kështu, është çështje e tyre.

Sidoqoftë, ne po vazhdojmë dhe do të vazhdojmë t'i kundërshtojmë këto bisedime dhe aq më tepër rezultatet e këtyre bisedimeve, si një regres shumë të madh, duke vë në pah edhe degradimin në raportin e Kosovës me Serbinë, sidomos që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 e deri më tani, por edhe një degradim i raportit të Serbisë edhe që nga fillimi të cilin ne e kemi kundërshtuar si proces negociator, deri më tani me marrjen e rezultateve të para të këtyre bisedimeve.

Por, sidoqoftë, le të kthehemi në temë dhe të diskutojmë për atë çfarë neve na është dhënë në konkluzat e dakorduara të 2 korrikut të ashtuquajtur, duke u fokusuar në përgjithësi në lirinë e lëvizjes, në pikën 1 të këtyre konkluzave, te liria e lëvizjes, pra, kur thuhet që qytetarët e Kosovës mund të udhëtojnë lirisht brenda ose përmes territorit të njëra - tjetrës. Dhe po harrojmë faktin që duke u fokusuar se si të udhëtojmë nëpër Serbi, edhe në Serbi, po harrojmë faktin se në çfarë vështirësish dhe sa janë thelluar vështirësitë e qarkullimit të brendshëm të Kosovës dhe të qytetarëve të Kosovës në jug dhe në veri. Mos të harrojmë, ne sot nuk kemi një qarkullim të brendshëm në mes Mitrovicës jugore dhe veriore, ky qarkullim po vazhdon të jetë i atakuar nga banda kriminale në veri dhe mendoj se para se të mendohej se si të shkohej në Serbi, duhet të mendohej si të shkohej në gjithë territorin e vendit tonë.

Në anën tjetër, në strategjinë e Qeverisë së Kosovës, sepse ne mendojmë se Qeveria e Kosovës e tradhtoi edhe strategjinë e vet, e tradhtoi edhe votën e atyre që votuan pro bisedimeve, duke u degraduar kjo strategji, mendoj që nuk e respektoi këtë strategji as në faktin kur thuhet që, në këtë strategji kur thuhej që normalizimi i marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë përfshiu përfundimin e njohjes së pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë, mendoj që Kosova nuk ka shkuar drejt kësaj njohjeje, sepse ka ndodhur një atakim i drejtpërdrejt i sigurisë së vendit, i shtetësisë së vendit dhe i aspiratave të qytetarëve të Kosovës. Pra, mendoj dhe jemi shumë të bindur se ky normalizim ka degraduar dhe është kthyer nga një normalizim në një abnormalizim. Pra, gjendja nuk ka shkuar duke u rregulluar dhe qytetarëve të Kosovës nuk iu është lehtësuar gjendja, përkundrazi iu është vështirësuar dhe u është komplikuar edhe më shumë se sa ishte më herët.

Në platformën mendohet edhe normalizimi apo lehtësimi i punës dhe i jetës së të dy palëve, po harrohet që kjo jetë nuk u lehtësua, nuk u normalizua, përkundrazi qytetarëve të Kosovës vetëm sa iu është komplikuar dhe iu është mohuar shtetësia, të cilën ata e kishin së paku të përshkruar në dokumente të tyre dhe në vend që me pasaporta të shkojnë në një shtet tjetër, ne sot shkojmë me letërnjoftime, jo pse ne kemi arritur marrëdhënie shumë të mira, por për shkak se shteti të cilit ne i referohemi, nuk e njeh fare shtetësinë e Kosovës, përkundrazi me letërnjoftime kemi lëvizur edhe para luftës, edhe gjatë luftës, ata që kanë guxuar, po flas, por me letërnjoftime vazhdohet të lëvizet edhe sot. Qëllimi ynë dhe i qytetarëve të Kosovës nuk është që të vazhdohet me letërnjoftime, dikur të quajtur "liçna karta", por mendoj që qytetarët e Kosovës kanë nevojë që me

shtetet e rajonit fillimisht të lëvizin me pasaporta dhe si rezultat i rregullimit të marrëdhënieve në mes të dyjave, nëse do të ndodhin ndonjëherë, të hiqen reciprokisht edhe pasaportat dhe lëvizjet në kufi si shenjë e lëvizjes së lirë në mes dy shteteve.

Në anën tjetër, i referohem asaj që u tha më herët se në fakt rezultati i këtyre bisedimeve është regres, justifikon edhe vetë fakti i targave, një temë që u shpenzua këtu pak a shumë, por sidoqoftë regresi nga targa RKS në KS dhe legalizimi më ngjanë dhe asocion te mos njohja e një pjese të qytetarëve, në këtë rast edhe qytetarëve serbë të Republikës së Kosovës dhe legalizimi me këto negociata i asaj mosnjohjeje dhe me asocion po ashtu edhe në Policinë e Kosovës, kur një pjesë e madhe apo policët e Kosovës nuk e njohin Republikën e Kosovës, kam thënë edhe më herët, dhe nuk i nënshkruajnë raportet të cilat janë me logon e Republikës së Kosovës. Pra, ne e kemi legalizuar këtë qëndrim të tyre anti-republikë dhe anti-shtetësi të Kosovës.

Por, mendoj që këto bisedime po e sfidojnë edhe Kushtetutën apo kushtetutshmërinë, pavarësisht çfarë lloji niveli është Kushtetuta sot, këto bisedime po e sfidojnë edhe kushtetutshmërinë, po e sfidojnë edhe Republikën, po e sfidojnë edhe pavarësinë, por me të gjitha po e sigurojnë dhe sigurinë e vendit dhe nuk mendoj se po i kontribuojnë sigurisë së vendit këto rezultate të cilat po vijnë njëra pas tjetrës më të degraduara se sa e para.

Sidoqoftë, nuk mund t'i shmangemi edhe një reagimi të asaj çka u fol këtu, pa dashur t'i shmangemi temës, por prapëseprapë ne dëgjuam këtu kundëracuza ndaj opozitës dhe ndaj qasjes tonë për të ditur më shumë dhe për të dhënë mendimin tonë në emër të qytetarëve në lidhje me bisedimet Kosovë – Serbi, bisedime të padrejta deri më tani, të vlerësuara edhe nga qytetarët, por edhe nga pozita.

Një gjë që nuk mund të kapërcehet pa u thënë, është edhe akuza për disa personalitete të Grupit tonë Parlamentar, të cilët akuzohen se iu kanë dorëzuar Serbisë. Nuk mendoj se iu kanë dorëzuar Serbisë, për aq sa mendoj që edhe vetë Ukshin Hoti nuk i është dorëzuar Serbisë. Nëse ju mendoni se edhe Ukshin Hoti iu ka dorëzuar Serbisë, duhet të deklaroni. Unë nuk mendoj se iu kanë dorëzuar as Serbisë, për aq sa edhe Nait Hasani nuk i është dorëzuar Serbisë, për aq sa edhe Xhavit Haziri nuk i është dorëzuar Serbisë, këta njerëz kanë qenë të arrestuar dhunshëm, të maltretuar dhe të dhunuar, por mos të harrojmë që përveç këtyre kanë qenë edhe shumë personalitete të tjera në burg të arrestuar nga Serbia dhe të dënuar, disa prej tyre janë kthyer, disa s'janë kthyer kurrë, nuk guxojmë ta marrim këtë guxim dhe t'i japim vetes të drejtë që t'u themi atyre që ata iu kanë vetëdorëzuar Serbisë, por ata njerëz kanë qenë një pjesë e sakrificës së popullit shqiptar të Kosovës për lirinë e vendit dhe njëkohësisht po ashtu edhe shumë prej tyre nuk janë kthyer më kurrë dhe figurojnë si të zhdukur dhe si të pagjetur.

Në anën tjetër, nuk mund të mbetem pa reaguari edhe ndaj vlerësimeve të kryesueses së delegacionit të saj në bisedime me Serbinë, zonjës Edita, e cila protestat e dikurshme gjithë popullorë të qytetarëve të Kosovës i quan disa defilime demonstratash. Nuk mendoj që duhet t'i përçmojmë kështu ata njerëz të cilët e përkrahën dhe në anën tjetër, paramendojeni, në akuzën e saj se kush është më patriot se tjetri, paramendojeni, po

mundohem ta paramendoj veten diku në Zvicër në kohën kur zonja Edita luftonte si Rambo në Kosovë. Në anën tjetër, kurrkush nuk duhet t'ia jep vetes këtë të drejtë që të kthehet në separacion, t'i ndajë kush janë patriotët e pseudo patriotët, sepse patriotizëm është të luftosh për atdheun dhe është mirë, por patriotizëm është edhe ta mbrosh atdheun çdo minutë, sidomos atëherë kur ke përgjegjësi për vendin, patriotizëm është t'i mbrosh edhe vlerat e asaj lufte çfarë kanë bërë të tjerët apo ju, s'ka rëndësi se kush.

Më shqetëson fakti, po ashtu edhe një arsytim jo shumë dinjitoz i disa nga deputetëve, të cilët ndoshta janë të shtyrë t'i arsyetojnë bisedimet dhe në anën tjetër më intrigon fakti se këtu po ka tendencë t'i shmangemi bisedimeve reale, se sa vërtet janë këto bisedime të nevojshme apo jo për vendin.

Sidoqoftë, në fund për aq sa një opozite i kërkohen alternativa, ne kemi alternativën tonë, alternativa jonë më e drejtë në këtë rast është ndërprerja e menjëhershme e bisedimeve të padrejta dhe të pa frytshme me Serbinë dhe kthimi i krenjtë këtij kapaciteti në ndërtimin e shtetit shumë të brishtë të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Idriz Vehapi e ka fjalën! Le të përgatitet deputetja Time Kadrijaj.

IDRIZ VEHAPI: I nderuar zoti kryesues,
Zoti kryeministër,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Të gjithë ne e dimë këtu në këtë sallë dhe të gjithë qytetarët e Kosovës se vendi ynë, Kosova, ka kaluar nëpër shumë sfida të cilat, për nga natyra dhe vrazhdësia e tyre, pa dyshim paraqesin ndër më të vështirën rrugë për të arritur gjer te pavarësia e një vendi.

Tani, pas pavarësimit të vendit tonë, është dashur të hyjmë në bisedime për të trajtuar e zgjidhur aspekte teknike të shumë çështjeve që kanë të bëjnë me jetën e qytetarëve të të dyja vendeve tona, probleme këto të cilat janë shtresuar dhe kanë zënë fill shumë e shumë vite më parë.

Në këtë kontekst, Kosova mbi bazën e parimeve të demokracisë, barazisë, lirisë nuk do të duhej të reflektonte alternativa tjera, pos atyre që i promovojnë këto vlera universale, bartëse e të cilave është bota e civilizuar. Dhe kjo do të ndodhë për faktin se Republika e Kosovës mëton të jetë pjesë e familjes së madhe të kombeve të lira. E kundërta e kësaj do të na krijonte imazhin e një vendi tekanjor, që promovon logjikën totalitare dhe që nuk njeh teorinë e demokracisë.

Të nderuar deputetë,
Bisedimet teknike të cilat janë në vijim e sipër, padyshim po e trasojnë rrugën e relaksimit dhe të stabilizimit të raporteve ndërfqinjësore Kosovë – Serbi, të cilat në instancë të fundit në një fazë të mëvonshme padyshim do të kulmojnë me njohje reciproke.

Do të ishte e cekët të mendohet që ky dialog në fazën e tij të parë do të sillte mrekullira, ndërkohë që realisht është pritur dhe ndodhi që ky dialog, ashtu siç e kemi thënë në këtë sallë të Kuvendit, në nismën e tij, se do të shënojë fillimin e komunikimit dhe bashkëpunimit të dy shteteve tona të pavarura.

Do të ishte po ashtu mendim i cekët që gjithë ky proces të shihej vetë në koloritin zi e bardh, sepse për të kaluar nga e zeza në të bardhen, kemi një mozaik ngjyrash nëpër dukjen e të cilave duhet kaluar patjetër.

Kolegë të nderuar deputetë,

Ndonëse nuk dua të zgjas, nuk mund të përmbyll fjalën time pa përmendur dhe ndarë bashkërisht me ju disa suksese të këtij dialogu, pjesë e të cilit pa dyshim janë edhe vendet mike të Kosovës, ato që sot konsiderohen prijatë të lirisë dhe demokracisë – Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Bashkimit Evropian, vende këto të cilat ecën me ne gjithë kohën, para luftës, gjatë luftës, pas luftës, vende këto të cilat na shoqëruan në rrugën tonë të shpalljes shtet i pavarur dhe të cilat po na qëndrojnë si garanci dhe përkrah në rrugën tonë për të arritur objektivin e synuar shumë vite më parë, e që është anëtarësimi në BE dhe NATO.

Ne duhet besuar, po ashtu, se pos tjerash në faza të mëvonshme këto bisedime shumë shpejt dhe përfundimisht do i thonë stop anarkisë dhe kaosit në pjesën veriore të Kosovës, do të zhbëjnë strukturat paralele dhe në vend të tyre do të ndërtohen institucione demokratike të zgjedhura nga qytetarët tanë dhe që punën e tyre do e bazojnë në sundimin e rendit dhe ligjit. Kjo padyshim do të ndikojë që varfëria, frika, shantazhet në këtë pjesë të globit të fillojnë të çrrënjosen pas dekada e dekadash përpjekjesh dhe në vend të tyre të vendosen paqja dhe zhvillimi ekonomik.

Nuk duhet mohuar suksesi që qytetarët tanë të kanë mundësi që me dokument të Republikës së Kosovës të kalojnë nëpër territorin e fqinjit tonë verior dhe shumë çështje tjera.

Krejt në fund, të nderuar kolegë deputetë, krijimi i shteteve të reja është proces shumë i ngadalshëm dhe me jo pak barriera. Këtë fat e pati edhe vendi ynë.

Nëse dikush ka menduar se relaksimi i raporteve Kosovë – Serbi, gjegjësisht bisedimet për zgjidhjen e aspekteve teknike të jetës së qytetarëve tanë do të jetë proces i shkurtër, ka gabuar. Ky pa dyshim do të jetë proces i gjatë, por i domosdoshëm.

Rezultatet e para pozitive tashmë janë të dukshme dhe nuk duhet mohuar. Këto sigurisht do të avancohen dhe ridizajnohen, në përputhje me rrethanat të reja. Britanikët në punën e tyre udhëhiqen me parimin - jepi shans paqes. Ndërkaq, ne si popull mik i tyre, po i japim prapë shans paqes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri e ka kërkuar fjalën! Zoti Thaçi, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryesues, zoti Haliti!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të ritheksoj edhe njëherë fuqishëm se Qeveria e Republikës së Kosovës ka parimet e veta të panegociueshme me Serbinë dhe se i ka vijat e kuqe të qarta, të mbështetura edhe nga Parlamenti i Republikës së Kosovës sa iu përket çështjeve teknike, që janë diskutuar dhe po diskutohen.

1. Pra, në asnjë rrethanë dhe është vi e kuqe dhe kjo është një herë e përgjithmonë, pra statusi i Kosovës është zgjidhur – Kosova vend i pavarur, sovran dhe demokratik, me integritet territorial të pa prekshëm, me Kushtetutë moderne, të njohur ndërkombëtarisht.

2. Sovraniteti, dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pa cenueshëm, i pa tjetërsueshëm dhe i pa ndashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

3. Rregullimi i brendshëm i vendit është kompetencë sovrane e institucioneve shtetërore, e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

4. Plani i Ahtisarit është platformë për rregullimin e drejtave dhe garancive për komunitetet.

Gjithashtu, u dëgjuan edhe opinione këtu për ndërprerjen e dialogut. Unë mendoj se shumë më mirë është të flitet shumë drejtpërdrejt edhe para qytetarëve, se sa të flitet tërthorazi e të mos merret qëndrim. Prandaj, shumë lehtë është të bëhet zhurmë politike për gjoja poenë politikë, por zgjedhjet janë vonë dhe fushata s'ka filluar dhe nuk do të fillojë sivjet.

Unë ftoj secilin grup parlamentar të deklarohet botërisht – LDK-ja a është për dialog a është kundër? Po, po botërisht! E tjerët u deklaruan. Edhe Aleanca, a është për a kundër? Shumë drejt!

Ndërsa, sa i përket sulmeve....

(Ndërhyrje)

...Unë e respektoj vetëm vendimin tuaj, ju keni votuar “për” dhe sa të jetë në fuqi ai vendim i Kuvendit të Kosovës, unë jam “për”. Ky është vendim i Kuvendit të Kosovës.

Ndërsa, sa i përket disave, që përsëri dolën nga tema që e keni thirrur si seancë të jashtëzakonshme, unë kam menduar me këtë krenari, mund të them kombëtare, thashë do t'i shpallni luftë Serbisë, zoti Beqiri! Prandaj, unë kisha kërkuar që të jemi shumë të përgjegjshëm në veprimet dhe angazhimet tona.

Unë do ta respektoj Kushtetutën e Republikës së Kosovës në përpikëri, me çdo vendim që e merrni ju. Dhe të tregoheni të zotët, e merrni vendimin, ata që jeni të paqartë në qëndrime.

Ndërsa, sa i përket akuzave, sulmeve, shpifjeve, intrigave apo trillimeve që u dëgjuan nga ndonjë individ këtu, unë mund t'ju them se, natyrisht se ka dallime në kultura, edhe në edukatë, por mund t'ju them në mënyrën më të sigurtë të mundshme juve dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës se nuk mund të ketë vizion euro-atlantik, njerëzit që janë rritur me edukatën..., kanë nostalgji për plejadën e artë të kulturës së rokut jugosllav, të “Bijello dugmes”, apo “YU grupës”, apo që janë rritur me frymëzimin e filmave bombahedhës të Boshko Buhës dhe tash në stilin e tij gjuajnë institucionet legjitime të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Para disa muajsh bisedime në rundin e pestë të bisedimeve të mbajtura në Bruksel, Kosova dhe Serbia kanë rënë në ujdi për arritjen e disa marrëveshjeve. Ndonëse nuk janë nënshkruar zyrtarisht, dy vendet fqinje kanë arritur marrëveshje për lëvizjen e lirë, për regjistrin civil dhe për diplomat universitare. Kjo pako marrëveshjesh është arritur pa ndonjë nënshkrim të të dyja palëve, por vetëm me garanci të Bashkimit Evropian, i cili i obligon të dy shtetet që të iu përmbahen marrëveshjeve.

Po ashtu, u bë e ditur se ky ishte një model i propozuar nga ndërmjetësuesi i BE-së, duke qenë se dy shtetet ende nuk e kanë njohur zyrtarisht njëra-tjetrën.

Sa i përket nisjes së implementimit të këtyre marrëveshjeve, ajo do të ndodhë shumë shpejt. Nga Brukseli u tha se Kosova dhe Serbia do të marrin përgjegjësi për të zbatuar këto marrëveshje, ku më pas do të krijohen edhe mekanizmat që do të mbikëqyrin zbatimin e të arriturave.

Këto bisedime janë të gabuara. Është në rregull nëse dalin gjëra pozitive nga ato, po sa do të ketë gjasa të ndodh kjo? Serbia ende nuk është e gatshme të njohë realitetin në Kosovë.

Ekziston rreziku që Kosova të futet në një proces në të cilin do të komprometohej sovraniteti i Kosovës. Gjatë tërë kohës sa është diskutuar për këto negociata, përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës, përfshirë kreun e saj Hashim Thaçin, patën deklaruar se secila marrëveshje do të vijë në Kuvend për aprovim përfundimtar të saj. Shihet qartë se këto marrëveshje nuk do të jenë marrëveshje në mes të dy shteteve, por do të jenë marrëveshje me shumë elemente të cilat e anulojnë ose zbusin shtetësinë e Kosovës karshi Serbisë.

Serbia ka refuzuar kategorikisht që të ketë marrëveshje të cilat mund të aludojnë në njohjen e shtetësisë së Kosovës nga ana e Serbisë. Ndërkohë, Qeveria e Kosovës e pranoi këtë pozicion, duke humbur edhe atë pak sovranitet të fituar pas shpalljes së pavarësisë.

Të gjitha palët kanë konfirmuar se kufiri në mes të Kosovës dhe Serbisë ose kufiri administrativ, siç e quan Serbia dhe një pjesë e BE-së, do të mund të kalohet me karta

identiteti, ndërsa nuk është kërkuar asnjëherë nga Serbia që të njohë edhe pasaportat me shenjë e Republikës së Kosovës.

Si kompromis për përdorimin e targave, është arritur marrëveshja sipas të cilave në Kosovë do të ketë dy lloj targash, një lloj sikur ato që deri më tash i ka lëshuar UNMIK-u, me shenjë KS, dhe targat e reja me shenjë e Republikës së Kosovës. Rikthimi në tabelat KS është devalvim i plotë i sovranitetit të vendit. Këtu nuk bëhet fjalë për reciprocitet. Një fushë ku Serbia nuk ka lëshuar pe, është ajo që ka të bëjë me origjinalet e regjistrave civilë. Edhe pala serbe dhe ata të BE-së kanë konfirmuar se delegacioni i Kosovës ka insistuar deri më tash tërë kohën që Kosovës t'i kthehen origjinalet, ndërsa pala serbe ka bërë të ditur se nuk e pranon një gjë të tillë sepse kjo do të kuptohej sikur heqje dorë nga sovraniteti ndaj territorit të Kosovës.

Qeveria e Kosovës ka hequr dorë nga disa elemente të shtetësisë, në momentin kur ka marrë zotim për t'i respektuar konkluzionet që kanë dalë nga tri marrëveshjet me palën serbe, të cilat janë arritur këtë fundjavën e kaluar në Bruksel.

Qeveria nuk është dashur të pranonte që qytetarët e Kosovës të lëvizin nëpër Serbi pa pasaporta që mbajnë mbishkrimin e Republikës së Kosovës, ashtu sikur që nuk është dashur të pranonte që kufiri në mes të dy shteteve të cilësohej si kufi administrativ.

Prishtina duhet të udhëheq platformën e bisedimeve mbi të cilat do të kërkohej zbardhja e fatit të peronave të zhdukur, tërheqja e strukturave paralele militare serbe nga veriu i Kosovës dhe njohja pa kusht e shtetit të pavarur të Kosovës nga ana e Serbisë.

Ne kundërshtojmë formën dhe rezultatet e deritashme të paqarta të bisedimeve. Konkluzionet e arritura janë të pa pranueshme dhe përmbajnë në vete elemente të cilat e devalvojnë dhe rrezikojnë sovranitetin dhe integritetin e shtetit të Kosovës.

Ne mendojmë se çdo marrëveshje që arrihet në bisedime, të sillet për ratifikimin në Kuvendin e Kosovës, si organi më i lartë ligjvënës. Ne kërkojmë që bisedimet me Serbinë të suspendohen. Presim që edhe deputetët e partive në pushtet, të votojnë për mocionin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Hydajet Hyseni, le të përgatitet deputeti Sadri Ferati.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Dëshiroj veçanërisht ta përshëndes zëvendësministren, zëvendëskryeministren, më falni! Suksesit të cilit do t'i gëzohesha, sikur të ishte më shumë! E përshëndes këtë debat, të cilin besoj se nuk mund ta fusim dhe s'duhet ta fusim në kallëpe të ndarjeve pozitive – opozitive. Është debat për çështje të interesit të përgjithshëm dhe është dëm që nganjëherë po harrojmë këtë. Po harrojnë madje edhe ata që s'do të duhej të harronin.

Për më tepër, po shoqërohet edhe ky debat me një politizim, që nuk besoj se i ndihmon as njëres, as palës tjetër. Po politizohet një çështje që po thuhet është teknike. Nuk e kuptoj as njëren motiv, as tjetrin.

Për këtë debat është bërë pak zor të flitet, sepse rrezikohet edhe të përdoren kualifikime e diskualifikime, madje edhe të lindin keqkuptime. Megjithatë, pa u frikësuar se mund të bie në kallëpin e do qasjeve tepër servile, që i dëgjova sot, dhe me pështirosje, si të thuash, megjithatë dua t'i referohem asaj që e ka thënë në mënyrë lapidare presidenti Kenedi për çështje të tilla: “Kurrë frikë për të biseduar dhe kurrë bisedime pa frikë”. Është theksuar në këtë sallë edhe herë tjera.

Për fat të keq, më duhet të konstatoj se ne po vazhdojmë të biem në të dy këto gabime. Një palë, që e kundërshton an-blllok procesin e komunikimit, dialogimit, bisedave e tjera dhe në këtë mënyrë rrezikon të marrë fajësinë si vend dhe nuk do të duhej ta lejonim dhe, pala tjetër, që justifikon gjithçka dhe noshalancë ndonjëherë të treguar, pasojat e të cilit kemi pasur rast t'i shohim disa herë.

Ç'është e vërteta, edhe do diskutime, unë s'e kam adet t'i kualifikoj, po pak a shumë ma kanë tollovitur edhe përshtypjen, perceptimin. Po shkohet deri atje sa të thirren në ndihmë edhe ata që s'janë më të gjallë midis nesh. T'u referohemi edhe marrëveshjeve të shumëhershme dhe e kanë tash të zorshme. Ata që dikur, ta zëmë para 20 vitesh gati po bëhen, justifikonin edhe marrëveshjet që koha nuk i ka justifikuar, i festonin ato, edhe më vonë.

Tani dalin edhe kundërshtojnë an-blllok gjithçka. Si ta kuptoj? Madje, ndodh ndonjëherë edhe disa që atëherë ishin të ri, e që na i hanin veshtë – pse po rrini ju me një parti ose me një sallë me ata që po nënshkruajnë marrëveshje të tilla, tash shkojnë e iu referohen atyre marrëveshjeve. Si t'i kuptojmë këto? Ç'është kjo prirje për të shkuar prej në skaji në skajin tjetër dhe pastaj edhe për t'i diskualifikuar të tjerët mbi këto baza. A ka mundësi që të kenë një qëndrim që është më konsistent, më stabil?

Mendoj që referenca te ajo porosia lapidare e presidentit Kenedi, është ai qëndrim që duhet. Po, bisedime, por mënyrën si bisedohet! Dhe, mënyra si bisedohet, mendoj, plus – minus gjendet në Rezolutën e këtij Kuvendi. Ajo Rezolutë ka përcaktuar qartë pro bisedimeve, por të përgatitura mirë. A ishin të përgatitura mirë? Po bisedimeve, por me pjesëmarrje edhe në procesin e hartimit të agjendës. A kemi qenë pjesë e hartimit të agjendës? Dhe nëse kemi qenë, a janë këto çështjet prioritare për Kosovën që duhet t'i bisedonim? Bisedime po, por të barabarta, si shtet, me reciprocitet e tjera, siç thanë. A janë të tilla? A ishin të tilla? Sa ishin të tilla?

Pastaj, është kërkuar që edhe roli i ndërmjetësve të jetë pak më ndryshe. Ç'u bë tash gjithë ajo, tash, eufori për shtetet e Bashkuara të Amerikës? Po ne kishim edhe një sistem që edhe SHBA të jetë pjesë e lehtësimit të këtij procesi.

Megjithatë, s'bëhen të gjitha ato që ne i dëshirojmë në proces. Është proces i dyanshëm, dy palë luajnë shah dhe duhet të jemi realist, gjithë atë që dëshirojmë, s'arrihen.

Edhe platforma mirë, në të shumtën e saj, mendoj që ka përfshirë çështje që do të duhej t'i kishim parasysh, sado që mua s'më del se janë parime ato që janë quajtur parime, por çështja kryesore shtrohet: a janë zbatuar ato parime? Sa janë zbatuar ato parime? Sa kemi qëndruar në ato që janë thënë, se siç do të thoshte populli: “boll mirë tek është, në qoftë se është qashtu qysh është shkruar në atë kartë”! Por, po ta krahasojmë dokumentin që e kemi përpara, si konkluzë, me platformën tonë, pa pretenduar që rezultati të ishte krejtësisht në favor të njërës palë, megjithatë shohim edhe diskrepancë të madhe. Pse të mos e themi hapur këtu dhe ta themi pavarësisht nga ajo – jemi pozitiv apo negativ, megjithatë është fjala për të ardhmen e vendit tonë.

Është thënë pastaj që procesi do të jetë transparent dhe ka qenë deri diku transparent, por po të jemi të sigurtë, nuk ka qenë sa është premtuar. Nuk ka pas as informacion, as raportime siç është premtuar. Madje, edhe institucionet e rëndësishme nuk janë përfshirë në proces, siç është thënë. Le të theksohen këto.

Por ka ndodhur dhe është insistuar në atë që do të jenë marrëveshje, tash na dalin jo marrëveshje, s'di a është mirë a keq, por është insistuar që ato do të ratifikohen, tash ne fare lehtë po pajtohemi që të mos ratifikohen. Përsëri nuk e di a është keq, s'është mirë. Por, një gjë është e sigurt, se nuk kemi qëndruar në procedurën që kemi parashikuar.

Është kërkuar në platformë kthimi i dokumenteve, jo i kopjeve. Është kërkuar kthimi i eksponateve arkeologjike. Tash dilema shtrohet, çka do të marrim nëse eventualisht arrijmë marrëveshje – kopjet apo diçka tjetër?

Çështja e të pa gjeturve! Çka do të marrim, çka do të presim?

Kthimi i fondit pensional! A nuk ishin këto më prioritare për t'i bërë çështje të bisedimeve, por t'i bisedonim ato që i kemi biseduar.

Dhe, po flasim për bisedime, që janë njëfarë pazari politik dhe marifet në këto pazare politike është të shesësh shtrenjtë diçka të lirë, apo të blesh lirë diçka të shtrenjtë. Me të drejtë shtrohet pyetja, çka kemi shitur dhe çka kemi blerë? Çka është ajo që ne e kemi blerë me hesap dhe çka është ajo që e kemi shitur me hesap. Rezultati nuk del për ndonjë eufori, siç po e dëgjoj, as për ndonjë defetizëm, siç po e dëgjoj nga ana tjetër. Prandaj, mos ma merrni për eklektizëm, por mendoj që po na mungon ai pozicioni që sugjeronte presidenti Kenedi me kohë.

Thuhet se në këtë mënyrë lehtësohet njohja e pavarësisë së Kosovës. Uroj që të jetë ashtu! Uroj që ta kenë gabim ata që thonë që pikërisht kjo po e ngadalëson njohjen e pavarësisë së Kosovës. Dhe, më tingëllon logjike!

Një proces që nisë për t'u negociuar, natyrisht që do t'i bëj të gjithë të thonë: presim, të shohim, pastaj edhe vendosim. Fundi i fundit, prej se ka filluar procesi i të ashtuquajtur dialogim, ne kemi një ngecje. Le ta analizojmë, s'ka gjë të keqe edhe nëse e thotë njëra palë ose pala tjetër.

Pastaj, kemi përpara konkluzat të dakorduara, e tha edhe dikush përpara. Konkluzave të dakorduara ndryshe u thonë - marrëveshje. Po brenda tyre nuk kemi ndonjë gjë për të qenë dhe mendoj që asaj mund t'i thuhet ndryshe: "u mbars mali e polli mi"! Edhe për të mirë, edhe për të keq, nuk është i atij dimensionit që po i japim. Ndoshta edhe nuk është keq në fazën në cilën ndodhemi. Por, megjithatë ne duhet të jemi të qartë, çka po shqyrtojmë. Se kjo farë përpjekje për dribluar me forma të tilla, nuk është as serioze, as dinjitoze dhe mendoj se është kundër produktive.

Për të qenë më konkret në vërejtjet e mia, pa mohuar shumë pika për të cilat s'kam vërejtje dhe mendoj mund të konsiderohen suksese dhe unë mendoj se duhet të merren parasysh nga kritikët e këtij dokumenti, do të ndalesha të marrëveshja si është me numër atje – Libri amzë. Është thënë shprehimisht: dy palët bashkërisht do të bëjnë krejt çka është e mundur për të krijuar një regjister

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe dy minuta, Hydajetit!

HYDAJET HYSENI: ... pra një regjistër plotësisht të besueshëm në Kosovë. Pra dypalët një regjistër në Kosovë! Pastaj, thuhet, do të formohet një "komitet i përbashkët trepalësh". Çështja shtrohet: a është kjo në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, edhe të platformës Atje çështje të tilla konsiderohen ekskluzivisht të brendshme dhe nuk mund të bëhen, të ndahen me një shtet tjetër, aq më tepër me një shtet pretendues. Pa e harruar edhe atë në fund, që është fshirë ndoshta rastësisht, por po na ndodhin edhe përsëri këto rastësisht, që të fshihet ajo e Kosovës, EULEX-i jep informacion nga Kosova për çështje të tilla Serbisë! Pse vetëm Kosova?! Mund të japë edhe Serbia?! Ka nevojë Kosova të ketë informacione të tilla edhe nga Serbia, ku kanë ndodhur falsifikimet e çështje tjera.

Prandaj, për ta përfunduar, mendoj se nuk është mirë të insistohet në suspendimin e bisedimeve, as ndërprerjen. Sepse ai që ndërprente bisedimet, humb lojën, në çdo sport është kjo. Kush ndërpret lojën, humb lojën. Kosova nuk guxon të rrezikojë në këtë mënyrë. Por, nuk është mirë edhe të vazhdojmë në këtë mënyrë, siç është negociuar deri tani, sepse sado që mund ta shesim si sukses, nuk do të dëshironim të kemi shumë, shumë suksese të kështilla në të ardhmen.

Ajo që unë do të sugjeroja, është të konsolidohet procesi. Të korrigjohen lëshimet, gabimet. Le të reflektohet aty ku është bërë gabim, s'ka kurrëgjë të keqe të thuhet: - po, e menduam me qëllimin më të mirë, por s'ia qëlluam dhe le të shikojmë të bëjmë më mirë në të ardhmen. Uroj që edhe kështu të ndodh! Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ferati e ka fjalën!

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë,

Duke dëshiruar që pas kësaj maratone të marr sa më pak kohë, do të provoj që të jem teknik, që të shkoj shumë shpejt dhe të fokusohem në një çështje që mua po më intereson më shumë.

Duke marrë parasysh gjithë atë që i ka pri dialogut, edhe vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare, edhe Rezoluta e OKB-së, debatet që janë zhvilluar në Parlament, Platformën e cila na është prezantuar, pas marrjes në dorë të këtij dokumenti, i cili shkruan se janë konkluzione, por unë e di se për konkluzionet që pajtohen, ajo quhet pastaj marrëveshje. Por, sido që të jetë, mendoj se është e mirë kjo iniciativë dhe ky debat që po bëhet sot këtu.

Të gjithë sigurisht pamë një përkushtim dhe diskutime shumë të mira, që do të mund t'i kontribuojnë një teme kaq të rëndësishme.

Pra, unë do të shkoj shumë shpejt në një çështje dhe duke marrë parasysh vetë dokumentet, do të thotë që këtu janë prezantuar, pra tek parimet e përgjithshme, që më tepër janë të karakterit afirmativ, tek parimet e negociatave që e përcaktojnë, do të thotë, fokusin e negociatave dhe parimet e pa negociueshme dhe unë po e lexoj, që të mos parafrazoj, pikën 3, dhe thotë: “Rregullimi i brendshëm i vendit është kompetencë sovrane e institucioneve shtetërore, e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës” që nënkuptohet edhe me ligjet dhe po e lexoj pikën 6 të Marrëveshjes: “Si masë kalimtare e autoriteteve në Kosovë do të vazhdojmë vlefshmërinë e targave KS të automjeteve për një periudhë fillestare prej 5 vitesh, në përfundim të së cilës çështje do të rishikohet nga të dyja palët”.

Pra, ne pas pesë viteve me Beogradin do të jemi palë për të diskutuar për çështje të brendshme, që është - tabelat. Dhe unë mendoj se këto dy pika, së paku, si dokumente vijnë në kundërshtim. Dhe unë mendoj se çështja e tabelave brenda Kosovës është çështje e brendshme, e rregullimit të brendshëm dhe nëse brenda pesë viteve ne po e krijojmë një status-quo dhe ndoshta pas pesë viteve po e lëmë të hapur mundësinë për të dialoguar, jo me qytetarët e Kosovës, jo me institucionet brenda Kosovës, jo vetëm me bashkësinë ndërkombëtare, por drejtpërdrejt me Beogradin, si palë. Dhe unë mendoj se kjo marrëveshje është e keqe dhe pjesën më të rrezikshme dhe më të dëmshme, unë personalisht e shëshoj në fjalinë – palë me Beogradin pas pesë viteve.

Dhe, vërtet është dëshira e gjithëve që ne të kontribuojmë. Unë nuk do të nxitem nga asnjë diskutim që ishte. Ka pasur diskutime që vërtet unë i vlerësoj dhe i çmoj. Por, po provojmë të gjithë bashkë për të dhënë kontributin dhe nëse haset në mirëkuptim pozitiv – opozitiv, qeverisje, legjislacion, sigurisht që secili do të ketë dëshirën që të jetë pjesë e këtij procesi. Dhe unë mendoj se nga të gjitha anët duhet të pritët mirë. Kemi kaluar sistemet kur është diskutuar për hallet e jetës, e t'u ka marrë se je kundër partisë e kundër Titos, kemi kaluar sistemet kur flet për sjelljen e hoxhës, e thuhet je kundër zotit, prandaj ne sot po flasim për Kosovën, po flasim për interesin e Kosovës dhe dëshirojmë që të mirëkuptohemi.

Ne jemi përcaktuar për dialog dhe ai përcaktim dhe ajo qasje nuk është e sotme. Jemi për dialog, por ka një moto që i paraprinë gjithë kësaj dhe ajo është sjellja jonë si institucione të Republikës së Kosovës e përgjegjshme dhe në interes të shtetit dhe të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Dhe nëse dialogu nuk e realizon këtë pikë, atëherë ai duhet të shqyrtohet dhe duhet të jemi shumë të brengosur dhe duhet të jemi shumë serioz në të gjithë këtë.

Dhe prapë po e them, nëse dialogu tash, që në fillim ka siguruar një ndarje të sovranitetit me Beogradin në veri, që pas pesë viteve të diskutojmë për çështje të brendshme, unë mendoj se nuk e dëgjova, do të kisha dëshiruar që me qenë se janë vetëm konkluzione nga zëvendëskryeministrja, nga kryeministri e të tjerë të dëgjojmë vetëm se a ka vend që të bisedohet për këtë çështje, që kjo të duket ndryshe. Nëse kjo ka përfunduar, s'do të na bëhet qejfi. Po, do të kishim dëshiruar që të gjitha fazat tjera të dialogut të mos jenë kaq të dëmshme, por që të bazohen në të mundshmen. Situata është aspak e lehtë, secili duhet t'ia besojmë secilit. Në tri komuna të pjesës veriore të Kosovës vërtet ndodhin procese, të cilat do të donë shumë angazhim, shumë bashkëpunim.

Prandaj, edhe në të gjitha fazat e ardhshme unë mendoj se është i papranueshëm kompromisi i një projekti që ka kaluar nëpër një kompromis. Kjo është sikur të shkurtosh diçka që e kemi shkurtuar njëherë.

Pastaj, në të gjitha fazat që diskutohet, duke marrë parasysh tri parimet e përgjithshme, ato të statusit të negociatave, pra teknike dhe çka nuk është e negociueshme, duhet gjithmonë të kemi parasysh edhe tri objektivat madhore, të cilat i shtron nevoja je bisedimeve dhe dialogu. Pra, gjithçka që duhet të shtrohet, duhet t'i kontribuojë funksionalitetit të shoqërisë kosovare, gjithçka që shtrohet, duhet t'iu kontribuojë bashkëpunimeve regjionale dhe përshpejtimit të ecjes së Kosovës drejt integriteteve evropiane dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Prandaj, në çdo rast, standardet që shtrohen, duhet të jenë të njëjta dhe sigurisht se paraprakisht secili akter, në këtë rast flas për Beogradin, duhet të dëshmohej se ato standarde janë të shpikura për Kosovën apo janë standarde universale që mund të përdoren edhe në Preshevë, edhe në Sanxhak, edhe në Vojvodinë, po edhe për raste të tjera.

Ndërsa, ajo çka unë në këtë rast shpreh edhe një brengosje, ky dokument në pikën 6 dhe partneriteti me Serbinë pas pesë viteve, jep një mesazh të keq që situata në veri, pra në ato tri komuna, është një gjendje e ngrirë. Nuk do të ketë progres, sepse secili do të thotë - prit pak çka do të ndodhë. Ne jemi dëshmitarë të fillimit të një intensifikimi dhe ngritjes së kapaciteteve shtetërore për tejkalimin e situatës atje dhe i kemi mbetur fundi i fundit borxh vetë projektit dhe pakos së Ahtisarit që procesi atje të shënojë progres, për t'u mirëkuptuar dhe për të parë se po realizohet filozofia e pakos së Ahtisarit, që i ka pasur dy komponenta kryesore: e drejta e qytetarëve të Kosovës që të përcaktohet se si dëshirojnë të jetojnë dhe ata e kanë thënë fjalën e vet se dëshirojnë të jetojnë në Republikën e Kosovës dhe primesa tjetër që asnjë qytetar nuk ka nevojë të frikohet se do të majorizohen nga një shumicë, por kemi shpall shtetin e Republikës së Kosovës që do të

garantojë barazi qytetare, mundësi të barabarta dhe perspektivë për të gjithë. Prandaj, ky mesazh, që momentalisht po mungon, unë po mendoj se do të krijojë pasoja edhe jashtë, sepse të gjitha ato shtete që ndoshta më lehtë do ta kishin shtruar çështjen e njohjes së Republikës së Kosovës, eventualisht mund të thonë - do të presim edhe katër vjet, pesë vjet për të parë se kush është sovrani në atë pjesë. Dhe, sigurisht edhe për brenda ky progres do të mungojë.

Por, edhe një herë do të dëshiroj, në fund, dhe do të përfundoj me këtë, do të kisha dëshiruar që ta kuptoj se formulimi “palë” nuk i referohet Beogradit, edhe unë e kam gabim, do të isha gëzuar shumë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi!

NIJAZI IDRIZI: I nderuari kryesues!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar pjesëtarë të Kabinetit qeveritarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Për një shekull të drejtat tona si popull janë nëpërkëmbur nga qeveritë e ndryshme serbe. Edhe tash kur po flasim për raportet Kosovë – Serbi, e kaluara e hidhur historike na del përpara dhe ne e kemi të vështirë që këto raporte t’i shohim me ftohtësi, pa emocione e pa shqetësime, të cilat dashur a pa dashur shoqërohen edhe me një lloj paranoje se mos po na mashtron Serbia.

Këto shqetësime do të na shoqëronin edhe sikur Serbia ta kishte pranuar realitetin e ri të Kosovës, e lëre më tash, kur ajo me sjelljet e veta është bërë pengesë reale për ndërtimin dhe funksionimin e shtetit tonë të ri.

Të nderuar deputetë,

Nga periudha e luftës e këndeje, kjo është marrëveshja e parë në mes Kosovës dhe Serbisë, që është pranuar nga të dyja palët. Ky është edhe shkaku kryesor i rritjes së shqetësimit, dyshimit dhe të interesimit të opinionit të gjerë, i cili do ta shoqërojë këtë dialog deri në fund. Kjo marrëveshje nuk është marrëveshje që është dashur dhe duhet ta entuziazmojë Qeverinë, por nuk është edhe e asaj përmase që të na shqetësojë se Kosova ka humbur shumë, se po heqim dorë nga sovraniteti ynë, se institucionet tona të brishta nuk janë të afta për t’i mbrojtur interesat kombëtare e shtetërore.

Në këto vlerësime duket qartë se po na mungon guximi politik, i cili po e shoqëron madje edhe këtë debat. Kjo marrëveshje dhe marrëveshjet tjera eventuale duhet ta ndryshojnë këtë gjendje të ngrirë në mes të dy vendeve fqinje, nga e cila do të përfitojnë në radhë të parë qytetarët. Kështu mund të përmbushen disa standarde elementare botërore të lirive e të drejtave të njeriut, të cilat janë dhe po bëhen obligime të të gjitha vendeve, pavarësisht a janë apo nuk janë nënshkruese të marrëveshjeve dhe rezolutave. Ndër këto liri padyshim që bie edhe liria e lëvizjes së njerëzve, ndërtimi i dokumentacionit të besueshëm civil, njohja e kualifikimeve të besueshme profesionale dhe akademike.

Të nderuar deputetë,

Vendi ynë, Kosova, nuk është epiqendër e botës dhe nuk duhet të krijojmë bindje se gjithçka e mirë apo e keqe që mund të na vjen, do të varet ekskluzivisht nga qëndrimi që ne do të mbajmë dhe vetëm ne. Këtë marrëveshje të parë e ka përshëndetur i gjithë faktori ndërkombëtar, i cili po bën thirrje për marrëveshje të reja.

Ne nuk duhet të harrojmë se ky faktor politik ndërkombëtar është edhe bashkëspozorues dhe bashkëhartues i shpalljes së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran. Dyshimi se ky faktor ndërkombëtar tash për ta joshur Serbinë po na këshillon që të heqim pak sovranitet nga vetja jonë, nuk ka kuptim, sepse pa vullnetin e këtij faktori, të paktën nuk do të ishim këtu ku jemi sot. Miqtë tanë, po ta kishin pasur këtë mendje, nuk do të na kishin veshur një herë me këtë sovranitet, për të na e marrë prapë si karrem për Serbinë.

Të nderuar deputetë,

Qeverinë duhet ta kritikojmë kur ajo bën gabime. Duhet edhe ta monitorojmë, që të mos bëjë gabime. Por, duhet edhe të pranojmë se konceptet për të ardhmen e vendit edhe mund të mos i kemi të njëjta. Qeveria e Kosovës është përcaktuar për këtë formë të dialogut dhe të ndërtimit të raporteve ndërshtetërore me rajonin dhe botën. Ata të cilët mendojnë se kjo rrugë është krejtësisht e gabuar, duhet të ndërtojnë platformën e tyre me konceptet dhe mendimet politike ndryshe dhe t'i shtrojnë si alternativa, nëse jo para Qeverisë, atëherë t'i shtrojnë ato para qytetarëve të vendit. Kushedi, ndoshta nacionalizmi klasik është e ardhmja e Kosovës, të paktën si opsion, të cilin ndokush do të mund ta proklamojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani!

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Po tentojmë të jem i shpejtë, i hapur dhe i qartë në vlerësimin me notën më negative të kësaj që ka ndodhur në fyerjen e konceptit të ndërtimit të shtetit qytetar në Kosovë dhe po tentojmë të fokusohem vetëm tek tema që quhet - liria e lëvizjes.

Qeveria e Kosovës, për vlerësimin tim, ka shkelur plotësisht frymën e ndërtimit të shtetit të Kosovës, bazuar në planin e Ahtisarit, i cili synon që këtë shtet të komuniteteve që e kemi, ta kthejë në shtet qytetar pas një faze tranzitore të mbikëqyrjes ndërkombëtare.

Qeveria e Kosovës ka filluar realisht të bëjë hapat e parë drejt një rregullimi të ri të brendshëm të Kosovës, rregullim ky që do sjell krijimin e dy entiteteve, atë për komunitetin serb të Kosovës dhe një entitet për të gjithë të tjerët.

Tek e fundit, këtë tendencë dhe këtë qëllim të Qeverisë e kemi vërejtur shumë më herët, qysh në vitin e kaluar, më 8 qershor, ku kryeministri Thaçi në fjalimin e tij, po citoj, ka thënë "Se duhet ide kreative për veri që marrin parasysh natyrën rajonale të Kosovës veriore", përfundim i citatit.

Kjo ka qenë hera e parë që është përdorur termi “Kosovë veriore” dhe që ka një politikë që merr parasysh natyrën rajonale të asaj pjese të Kosovës. Kjo “ide kreative” ka nisur tashmë edhe formën zyrtare dhe nisja e parë e saj është çështja e targave të veturave të qytetarëve të Kosovës, ide që do të thotë Ahtisari plus, e që normalisht është e pa pranueshme për ne. Me këto ide kreative të Qeverisë, është bërë hapi vendimtar për ndarjen e brendshme të Kosovës dhe këtë duhet ta themi qartë. Serbët e Kosovës, një pjesë e tyre do të kenë targat KS me Rezolutën 1244, ndërsa të gjithë ne të tjerët do të kënaqemi me targat RKS të Republikës së pavarur sovrane dhe demokratike.

Sipas pikë vështirimit tonë, janë tri shqetësime kryesore që na shtyjnë të mos pranojmë këto ide kreative të Qeverisë së Kosovës sa i përket çështjes ose temës së lirisë së lëvizjes. Shqetësimi i parë, ka të bëjë pra me ndarjen e brendshme. Tek e fundit, Qeveria na ka thënë prej fillimit se këto nuk janë bisedime politike, por janë vetëm teknike. Atëherë, është thjeshtë pyetja, pse është dashur që të bisedohet me Serbinë, të negociohet me Serbinë, se çfarë targash duhet të mbajnë serbët e Kosovës. Kjo është përzierje direkte e politikës së Serbisë ose Qeverisë së Serbisë në punë të brendshme të Kosovës. Mos harroni, një pjesë e madhe e komunitetit serb në Kosovë nuk i ka refuzuar targat RKS për shkak se s’i ka pëlqyer dizajni teknik, as kualiteti teknik, i ka refuzuar sepse ka motiv politik për t’i refuzuar dhe në këtë motiv politik e ka mbështetjen e Qeverisë së Serbisë. Dhe çka ka ndodhur gjatë këtij procesi ose me këto konkluzatë të para, është se këtë motiv politik, që e kanë mbështetjen edhe të Serbisë, e kanë marrë edhe prej Qeverisë së Kosovës ose thjeshtë të themi, në këto bisedime i është thënë Borkos se si të thoni ju, ashtu ia bëjmë, veç që të jenë njëfarë marrëveshje që ta arrijmë.

Pika 6 e këtyre konkluzave, të pjesës së parë, thotë se kjo periudhë do të zgjasë, është periudhë fillestare dhe do të zgjasë prej pesë vitesh, në përfundim të cilës çështja do të rishikohet nga të dyja palët, me lehtësimin e Bashkimit Evropian, nëse kërkohet. Pra, pesë vjet do të zgjasë kjo situatë, ndërsa pas pesë vjetësh, sërish Prishtina e Beogradi ose të themi ndonjë Editë e Kosovës apo ndonjë Borko i Serbisë do të ulen prapë e të flasin se çfarë targash do të mban komuniteti serb në Kosovë. Pra, s’po bëhet fjalë se me çfarë targash do të kalojnë qytetarët e Kosovës në Serbi, por çfarë targash do të kanë qytetarët e Kosovës që janë serbë.

Kjo normalisht që ndikon në hapjen e derës edhe më të madhe që Serbia të vazhdojë politikën e vet brenda dhe ndikimin e vet.

Shqetësimi i dytë, ka të bëjë me një element tjetër, që nuk e dëgjova deri tash, është bartja e kompetencave ose e një kompetence prej Qeverisë së Kosovës në EULEX. Qeveria e Kosovës, e cila tash sidomos gjatë këtyre muajve të fundit, për çdo ditë po na thotë se EULEX-i duhet të shkojë sa më shpejt prej Kosovës, e ka thye qëndrimin e vet edhe me këtë marrëveshje.

Në pikën 7 të konkluzave, për lirinë e lëvizjes thuhet saktësisht se targat RKS ose KS do të lëshohen nga autoritetet përkatëse në Kosovë dhe do të shpërndahen me ndihmën e EULEX-it, kudo që kërkohet. Pra, Qeveria e Kosovës, me këtë pikë heq dorë nga autoriteti kushtetues dhe ligjor për t’i shpërndarë tabelat ose targat për vetura te

qytetarëve të Kosovës dhe këtë gjë ia delegon EULEX-it. Është normal që kjo periudhë është pesë vjet, do të thotë nuk është as një muaj as dy, por janë pesë vjet për të cilën Qeveria ia bartë një kompetencë, që e ka të veten me Kushtetutë e me ligj, ia bartë EULEX-it.

Përndryshe, ne duhet të pyesim - kush është ekzekutivi i Kosovës, a është Qeveria e Kosovës apo është EULEX-i, apo për shqiptarët dhe tjerët është Qeveria e Kosovës, ndërsa për serbët është EULEX-i?! Kompetencën e shpërndarjes së tagrave nuk e ka EULEX-i, nuk e ka pasur deri tash dhe tash normalisht se është mirë të marrim ndoshta një shishe verë ose ndonjë xhygym çaj, nëse i bie më mirë, e të shkojmë e t'ia bëjmë për hair. T'ia bëjmë për hair një kompetencë të re EULEX-it, që nuk e ka pas deri tash dhe, normalisht, po më duket që arsyeja dihet, sepse kjo është pa aftësi e Qeverisë të përdor ose të zbatojë kompetencat e veta që i ka.

Shqetësimi i tretë, për ne është lëvizja me letërnjoftim. Me Ligjin për dokumentet e udhëtimit, letërnjoftimi nuk parashihet ose nuk përcaktohet si dokument udhëtimi, ndërsa me Ligjin për letërnjoftim, Ligji Numër 03/L/009, neni 3, thuhet se “letërnjoftimi mund të shërbejë si dokument identifikues udhëtimi për kalimin e kufirit shtetëror, në qoftë se kjo është rregulluar me marrëveshjen ndërmjet shteteve”.

Tash prapë po kthehemi te një prej pyetjeve bazë. A është kjo marrëveshje ndërshtetërore dhe po mendoj se është e tepërt të mundohemi ta sqarojmë se me këto konklkua ose me këtë pikë për lëvizje me letërnjoftim, është shkel Ligji për letërnjoftimin dhe është shkel Ligji për dokumentet e udhëtimit.

Përndryshe, nëse duket që është e mirë ose nëse Qeveria dhe kryeministri dhe zëvendësja e tij mendojnë që është e mirë, atëherë besoj se normalisht, parimisht i bie që këtë të mirë po ia bëjnë qytetarëve të Kosovës dhe në atë mirë e shohin veten. Atëherë, a mundeni t'i bëni për hair targat KS dhe letërnjoftimin, të kaloni me letërnjoftim në Serbi dhe të merrni ju vetë të parët targat KS, tash të thoni se kjo është e mirë për krejt qytetarët dhe nëse ne mendojmë që diçka të mirë t'iu bëjmë qytetarëve, atëherë e sjellim prej vetes, e marrim vetë shembullin tonë që kjo është e mirë për mua, është e mirë për krejt qytetarët! Nëse është e keqe për mua, po qenka e mirë për krejt qytetarët, atëherë diçka normalisht se shihet që nuk është në rregull. Është, thjeshtë, shkelje e ligjeve dhe mos të mundoheni që në mënyrë të palogjikshme këtë temë ta krahasoni me lëvizjen ose me qarkullimin në Shqipëri me letërnjoftim, sepse aty ka një marrëveshje ndërshtetërore dhe nuk ka ndërmjetësim ndërkombëtar. Ose rasti i Malit të Zi. Në Malin e Zi shkohet edhe në mënyrë të heshtur me letërnjoftim, po mund të shkohet edhe me pasaportë, ndërsa në Serbi nuk mund të shkohet me pasaportë.

Është thjeshtë kjo, keni shkelur ligjin, udhëheqës të Qeverisë, keni shkelur rregullimin e brendshëm të Kosovës, keni dëshmuar edhe një herë se për ju nuk vlen ligji dhe nuk e dini çka është ligji, nuk e dini çka është respektimi i ligjit. Mos harroni se jeni kundër ligjit dhe ligji do t'ju kapë kurdoherë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Afrim Kasolli e ka fjalën!

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Tashmë në fund, pas procesit të ashtuquajtur të bisedimeve teknike ndërmjet Ekipit negociator të Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë, që u zhvillua në Bruksel, e të ndërmjetësuar nga Robert Cooper, janë arritur disa të ashtuquajtura konkluzë lidhur me çështjet e debatuar.

Këto konkluzë të dakorduara “ndërmjet dy vendeve me kufij administrativë”, siç thotë dokumenti zyrtar, i të ashtuquajturit lehtësues të dialogut, esencialisht më në fund e normativizojnë dhe legalizojnë sistemin ambivalent juridik dhe politik të instaluar në Kosovë gjatë gjithë këtyre viteve dhe atë veçanërisht në periudhën e post - pavarësisë.

Pra, ashtu siç edhe patëm paralajmëruar se këto negociata e patën bazën e tyre pikërisht në dështimin e strukturave politike, institucionale dhe administrative të Kosovës për të shtrirë sovranitetin e shtetit në të gjithë territorin e vendit, tashmë bëhet e qartë se me këto konkluzë synohet pikërisht të legalizohet ky dështim, duke promovuar kështu një gjendje ambivalente në aspektin politik dhe të rrezikshme sa i përket rendit juridik për vitet në vijim.

Në të gjitha dimensionet e mundura, këto marrëveshje jo vetëm që e vulosin përfundimisht mungesën e sovranitetit për Kosovën, çfarë edhe e kemi pasur deri më tani, por ato i zhbëjnë edhe elementet e të ashtuquajturës pavarësi formale, që e kanë karakterizuar shtetin e Kosovës si vend formalisht të pavarur, por përmbajtësisht të varur, të fragmentarizuar dhe të kontrolluar. Me këso marrëveshje apo konkluzë, tashmë Kosova do të jetë edhe formalisht e varur.

Por sidoqoftë, ajo që spikasim më shqetësuese në kuadër të këtyre marrëveshjeve, padyshim se mbetet e ashtuquajtura marrëveshje për pranimin e diplomave universitare. Kjo pikë e marrëveshjes pohon se “të dy palët janë pajtuar në parim për të zgjidhur çështjen e pranimit të diplomave universitare, qoftë përmes një trupi ndërkombëtar të dakorduar reciprokisht, qoftë përmes një institucioni akademik të një pale të tretë”.

Pra, këtu do të kisha dashur të di, në radhë të parë, se pse fillimisht këto diploma nuk pranohen, se ato nuk kanë vlera akademike dhe për këtë arsye nuk pranohen, apo vetëm thjeshtë se në to shkruan logoja e Republikës së Kosovës dhe çka do të verifikohet nëpërmjet kësaj trupe ndërkombëtare, ku zëvendëskryeministrja tha tash se do të jetë një organizatë ndërkombëtare, e cila ende nuk është caktuar se cila do të jetë, por vetëm përjashtoi mundësinë që ai të jetë UNMIK-u, por s’përjashtoi mundësinë që të jetë EULEX-i.

Kështu, pra, nëse këto diploma nuk pranohen për arsyen e parë për shkak se nuk kanë vlera akademike, atëherë kjo marrëveshje fillimisht e përmbys njërin nga broçkullat kryesore mediatike të kësaj Qeverie, se kjo Qeveri ka investuar deri më tani për një shoqëri të dijes dhe ka ndërtuar institucione akademike kualitative. Pra, kjo marrëveshje

tregon se çfarë poshtërimi dhe degradimi i ka bërë Qeveria e Kosovës në radhë të parë institucionit të Universitetit, duke vë në dyshim kriteret e këtij institucioni, pasi duhet të kërkohej verifikim dhe miratim shtesë për të diplomuarit në kuadër të këtyre institucioneve. E nëse këto diploma do të verifikohen pikërisht pse shkruan logoja e shtetit të Republikës së Kosovës dhe ato do të verifikohen me gjasë nga EULEX-i, si mekanizëm verifikues në këtë çështje, atëherë për herë të parë ndoshta do të instalojmë një model të pa parë deri më tani të një policie akademike.

Sidoqoftë, ana tjetër e këtij rrëfimi qëndron në faktin se ajo nuk është reciproke, sepse ajo do të përdoret vetëm për të diplomuarit shqiptarë nga Lugina e Preshevës në Universitetin e Prishtinës. Dhe, kjo Qeveri, në vend që të zgjidhë problemin e arsimimit dhe edukimit të tyre, me anë të kësaj marrëveshjeje vetëm sa e ka vështirësuar edhe më tepër, duke e legalizuar këtë gjendje dhe duke e shndërruar atë në kategori sistematike në sajë të shumëfishimit të procedurave burokratike.

Po ashtu, ajo që është shqetësuese lidhur me këtë marrëveshje, thuhet se këto do të realizohen përmes një trupe ndërkombëtare, por përvoja ka treguar se pikërisht ka pasur edhe marrëveshje të mëhershme, të cilat kanë qenë të dizajnuara dhe sponsorizuara nga faktori ndërkombëtar në atë rajon, por të cilat kanë dështuar. Këtu do të merrnim shembullin e krijimit të policisë multietnike, apo shumëetnike, siç është quajtur në atë kohë dhe e cila ka qenë e sponsorizuar kryesisht nga OSBE-ja. Madje, ajo që është më e tmerrshme, shteti serb ka marrë edhe para të majme për ... e policisë në këtë rajon, por ajo në fund i ka lënë banorët shqiptarë vetëm në rangje të ulëta dhe pa asnjë pozitë relevante dhe, kështu, derisa më në fund u tërhoq edhe vetë OSBE-ja, duke shpallur thuajse se në heshtje këtë projekt të dështuar.

Ky fakt pikërisht tregon se si disa nga projektet më të rëndësishme, që ishin paramenduar të implementohen në atë rajon, kanë dështuar pikërisht se kanë qenë të sponsorizuara nga ndonjë trupë ndërkombëtare.

Gjykuar në bazë të këtyre parametrave, tani ka rrezik që edhe ky projekt i kësaj konkluze të dështojë, sepse nëse thuhet që është dakorduar që në parim të njihen diplomat, këtu nuk përjashtohet mundësia që shteti serb të mos i njohë veç e veç këto diploma.

Dhe, për fund, këtë fjalim do të kisha dashur ta përmbyll me një digresion, në cilësinë e anëtarit të Komisionit parlamentar për Arsim. Pra, nëse do të ishte dashur vërtet që të verifikoheshin diplomat, atëherë do të ishte mirë që këto diploma të ishin verifikuar të shumë personaliteteve politike sot në Kosovë, të cilët e kanë shfrytëzuar pozitën politike për të pajisur veten me tituj akademikë dhe duke e degraduar pafundësisht vet universitetin në këtë segment. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! I fundit është deputeti Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryesues,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Këtë debat e vlerësoj edhe pse mendoj se është thirrur me qëllim të bëhet zhurmë për konsum politik. Këto seanca, interpelanca për të mbledhur nënshkrime, bëhen vetëm për të tërhequr vëmendjen e opinionit publik dhe nuk kanë asnjë interes për qytetarët e Kosovës.

Si duket, roli opozitës është keqkuptuar nga disa njomakë politikë, fatkeqësisht kësaj aventure politike iu kanë bashkëngjitur edhe disa të tjerë të cilët, si duket, i ka mundur kotësia politike apo vendnumërimi.

Kudo në botë, opozita është kritikues dhe mbikëqyrëse e pozitës dhe është gjë normale kjo, vetëm këtu tek ne opozita është bërë stagnuese e proceseve dhe zhvillimeve dhe e ka marrë rolin e njollosjes së shtetit, ngase për të ardhur vetë deri te pushteti, nuk është duke zgjedhur mjete, është duke i ngecur zhvillimet e shtetit për të arritur pushtetin. Për fat të mirë të Kosovës, nuk do ta arrijë asnjëherë.

Të nderuar,

Kur patëm miratuar rezolutën për bisedime me Serbinë dhe disa nga ju të opozitës patët premtuar se si bashkëpërpilues të rezolutës do të mbështesni atë, por për interesa të ngushta politike hoqët dorë. Atëherë deklaroni se mos po janë këto bisedime politike për statusin dhe kur tash dolën këto konkluzione teknike, ju ftuat seancë për marrëveshje, ju tani jeni duke tentuar t'i jepni karakter politik, derisa ato janë të nivelit teknik dhe janë nxjerrë konkluzione për targat, diplomat, lëvizjen e lirë, regjistrat civilë dhe kadastralë.

Andaj, të nderuar qytetarë të Kosovës, këto figura që ... si të vrullshme nga ... të egra, nuk janë gjë tjetër veç se politikanë që mendojnë për vetveten. Këta adoleshentë politikë, si patriotë të vonuar që janë, gojën e kanë plotë bashkim kombëtar dhe nuk e shohin atë, kur shqiptarët si asnjëherë më parë janë më afër tjetrit të bashkuar.

Sot, kur Policia e Kosovës patrullon në Kukës, Milot deri në Bregdetin shqiptar, me letërnjoftim mund të shkosh në Tiranë, Sarandë apo në Ulqin, ku ta do zemra në trojet shqiptare. Marrëveshja e fundit mundëson shkuarjen me letërnjoftim edhe në Preshevë, në Bujanovc dhe në Medvegjë.

Hapni sytë, ju pseudo-nacionalistë, shikojeni gjendjen sot dhe para 15 vitesh. Bashkimi është realitet dhe do të ndodhë edhe në Evropën e Bashkuar. As marrëveshja me Shqipërinë dhe me Malin e Zi për lëvizje me letërnjoftim, nuk është ratifikuar në Parlament, por është realitet.

Koha për të fituar vota në emër të patriotizmit ka kaluar. Jemi tani në shekullin XXI. Kot e mbani flamurin kuq e zi, kur nuk patët guximin ta bartni në ballë kur ishte koha, në demonstratë apo në luftë. Të paktën të dukeshit në fushën e luftës, në mos patët guximin të derdhni gjak për këtë vend, bile të ishit bërë me pluhur a baltë beteje për t'i ofruar ndihmë ndonjë luftëtari që kishte flamurin kuq e zi në ballë, ashtu si bëri i tërë populli.

Andaj, nuk do ta pyes më Albin Kurtin pse ka refuzuar të veshë uniformën e UÇK-ës e ta vë flamurin kuq e zi në ballë. Sigurisht që tani e ka më lehtë. Por, kësaj radhe dua ta pyes Visarin dhe Glaukun, si meshkuj të mëdhenj nga dy metra që janë, pse këta nuk e vendosën flamurin kuq e zi në ballë? Apo po dua ta pyes edhe Liburnin, si patriot i madh që është nga Presheva, pse nuk iu bashkua radhëve të UÇK-së apo të UÇPMB-së, kur po luftohej atje për liri dhe bashkim kombëtar?

Këta janë pseudopatriotë që spirancën e kanë hudhër në pushtet, por nuk do të arrijnë të zbarkojnë aty kurrë.

Me asnjë pikë të marrëveshjes nuk cenohet shtetësia e Kosovës, dhe burrështetasit më të mëdhenj amerikanë e evropianë deklarojnë se shtetësia e Kosovës është e pa prekshme, ndërsa opozita flet të kundërtën. Populli e di më mirë kujt t'i besojë – pozitës, amerikanëve, evropianëve apo opozitës. E ka dëshmuar në zgjedhjet e fundit.

Sikur t'i kishim pritur këta të "Vetëvendosjes", edhe disa tjerë nga opozita, ne ende do të ishim nën Serbi. Në marrëveshjet e fundit thuhet – kufi dhe kufiri administrativ, se kufiri me Serbinë është tamam kufi, apo kufi administrativ e dëshmon realiteti. Në tërë botën zhdoganimi kryhet në kufi në mes shteteve, ashtu siç kryhet në Merdar dhe në pikat 1 e 31. Dorën në zemër, në pikën 1 dhe 31, jo në nivelin e sigurisë, si ne dëshirojmë, por edhe kjo do të arrihet.

Çështja e tabelave KS, Serbia të gjitha që kanë të bëjë me Kosovë, e ka në princip t'i njohë pak me vonesë dhe me vështirësi. As këta regjistrat KS nuk i ka pranuar më përpara, tani po. Librezat e automjeteve të këtyre tabelave lëshohen nga Republika e Kosovës, që në fakt është një pranim teknik i pavarësisë nga ana e Serbisë.

Lëvizja e lirë me letërnjoftim si në Tiranë, si në Preshevë, është një shtet.

Për diplomat besoj se ndani mendimin që janë në interes të qytetarëve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit.

Edhe çështja e regjistrave civilë e kadastralë, edhe me shtetet tjera Serbia ka vepruar njëjtë kur ka dalë nga lufta, por më vonë i ka kthyer arkivat reale të saj, apo të vërtetat dhe kjo çështje besoj se e do një zgjidhje, për shkak se e dini sa qytetarë janë vrarë për çështje pronësie, në mungesë të këtyre regjistrave kadastralë.

Çka po humb Kosova e çka, në fakt, po realizon? Një e drejtë universale e lëvizjes së lirë, një Kosovë shtet i pavarur, i fortë, i hapur ndaj fqinjëve, a nuk ishte ky synim edhe i presidentit Rugova, por ju të LDK-së, që e keni braktisur rrugën... dhe ju të LDK-së që e keni braktisur rrugën e tij, i jeni bashkuar atyre ëndërrimtarëve, aventuristëve politikë, që mohojnë vetveten, a u lodhët nga kotësia dhe i lejuat që një parti dikur me nam dhe me emër do t'i flugni një paradoksi politik dhe të mos jeni pjesë e zhvillimeve dhe proceseve dhe përjashtuat veten nga kjo. Çka fitoi Serbia nga këto konkluzione, kur ato janë më shumë në interes të qytetarëve të Kosovës. U tha - Serbia fiton rrugën për anëtarësim, për të fituar statusin e kandidatit. Po edhe Kosova po e ndjek rrugën në Bashkimin Evropian

dhe Bashkimi Evropian u deklarua qartë se në gjirin e saj dëshiron edhe Kosovën, edhe Serbinë.

Dua të siguroj qytetarët se ata që patën guximin, kanë edhe inteligjencën. Me atë guxim dhe inteligjencë fituam mbështetjen ndërkombëtare, fituam lirinë dhe pavarësinë, fituam në Rambuje, ne nënshkruam Serbia jo, ne u çliruam dhe fituam lirinë, Serbia u bombardua dhe nënshkroi më vonë kapitullimin në Kumanovë, ne pranuan planin e Ahtisarit, Serbia jo, ne u pavarësuan, Serbia vajtoi. Dhe tani po bisedojmë si dy shtete për interesat e qytetarëve të dyja vendeve dhe asnjëri që ka deficit patriotik, nuk mund t'i zhvlerësojë të arriturat e Kosovës duke dalë kundër autostradës, duke djegur flamuj të Kosovës, duke njollosur e hudhë çdo që në Kosovë, çdo të arritur. Është kjo një tendencë e pseudo-nacionalistëve që Kosovën ta paraqesin veç defetizëm dhe veç zi, ngjashëm me politikën serbe ndaj Kosovës. Por, edhe këta pseudo-patriotë, edhe Serbia dështuan dhe prapë do të dështojnë përballë atyre që patën guximin dhe inteligjencën në kohën e duhur dhe këtë populli e vlerësoi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Liburni e ka kërkuar fjalën! Liburn Aliu, replikë!

LIBURN ALIU: Unë nuk po kam qejf që kjo të dalë në personale, unë po kam qejf që debati i sotëm të jetë për pazare, pra, me Serbinë që i keni filluar, po megjithatë po diskutoj, po replikoj për...

U tha që para 15 vitesh, krahasojeni gjendjen e para 15 vitesh. Unë veç po ju them që para 15 vitesh, në Medvegje ka pasur përmbi 5.000 banorë, sot ka më pak se 500. Para 15 vitesh, të gjitha fshatrat e Malësisë së Bujanovcit i kanë pasur shkollat përplot me nxënës, sot nuk ka asnjë njeri atje. Para 15 vitesh, Presheva ka ndihmuar Kosovën ekonomikisht, se ka pasur zhvillim, sot të gjithë po largohen prej saj për shkak të varfërisë. Ky është krahasimi me para 15 vjet.

Për sa i përket Lëvizjes “Vetëvendosje”, unë them kështu. Ti e ke përmendur më herët betimin para 12 vjetësh, ta respektoj, ta çmoj. Nuk është çështja vetëm që 12 vjet. Këtu ka histori edhe para 12 vjetësh, shumëkush, cilido subjekt ka njerëz që kanë vepruar edhe 12 vjet më herët në mënyra të ndryshme dhe ka të tillë që ende nuk e kanë shkelur betimin, a po kupton.

Ndërsa, për sa i përket, tash po nisem nga ana ime personale, unë kam qenë në burg në kohën kur ka vepruar UÇK-ja, në kuptimin me uniformë. Kam rënë në burg më 27 janar të vitit 1997, jam dënuar për, siç i thoshin ata atëherë, terrorizëm, jam liruar në mars të vitit 2001 dhe menjëherë pas asaj, për dy muaj rresht kam qenë në spital, si shumë të burgosur tjerë prej tuberkulozit dhe katër muaj të tjerë pastaj me terapi intensive në shtëpi.

Nëse ti po më shti të them, besoj se tash je i lumtur që e devijove sadopak në çështje personale. Besoj se të kënaq kjo farë përgjigje e imja, po është e vërtetë që ka pas thirrje prej Preshevës dhe unë kam bërë vazhdimisht, kam synuar të jem në kontakt me ta përmes telefonit në spital kur kam qenë. Kjo është e vërteta. Ndoshta ke të drejtë, ndoshta ishte

dashur të ikë prej spitalit e të shkoj, por ndoshta ia kisha ngjitur dikujt TBC-enë, kjo është ajo krejt.

KRYESUESI: Kundër replikë, zoti Haxhiu ka një minutë!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit! Nuk e pata qëllimin të kaloj në temë personale, po ndër ata, nëse ankoresh për shpërnguljen, je ti që je shpërngulur i pari prej atje dhe këtë shembull tëndin e kanë ndjekur edhe tjerët, prandaj do të ishte mirë që ti të qëndroje atje, pastaj të japësh një shembull të mirë për këtë dhe unë e kam potencuar edhe një emision televiziv, në kohën kur ka thirrur Abit Presheva për t'u kthyer në Preshevë, veç mysafir të shkosh atje, ke refuzuar të jesh pjesë e asaj, një mysafir të jesh. Më vjen keq për gjendjen tënde shëndetësore, nëse ka qenë dhe kam respekt për të gjithë të burgosurit shqiptarë politikë, por nuk dua të kaloj në çështje personale, po kur thirrësh në emër të vlerave të mëdha kombëtare nacionale, të paktën te kishe bërë një shërbim, të kishe shkuar për t'iu dhënë atyre vullnet që ishin duke luftuar në Preshevë.

KRYESUESI: Liburni, një minutë!

LIBURN ALIU: Për sa i përket shpërnguljes së familjes time, unë po të them këtu personalisht, kam lindur në Prishtinë. Baba im ka ardhur në Prishtinë si rezultat për të dhënë kontributin e tij këtu, ka konsideruar që duhet të luftohet në Prishtinë për çështjen kombëtare, e jo në Preshevë. Ka ardhur, e ka dhënë kontributin e tij, ka mbajtur burgjet, i ka kryer të gjitha. Nuk e ka bërë mend ai që sot vini ju dhe nuk e qani kokën për Preshevën. Çka të bëjmë? Ky është realiteti. Pra, ai u mundua që të vijë në Prishtinë, sepse është konsideruar që lufta bëhet në Prishtinë për të gjitha trojet shqiptare nën pushtimin e serbëve, malazezve, maqedonëve dhe në Kosovë në atë kohë dhe ka konsideruar që lufta për çlirim bëhet prej Prishtinës, e ka dhënë kontributin e tij në këtë aspekt. Unë jam pasojë e kësaj, kam lindur në Prishtinë, s'kam çka të bëj tash... po sidoqoftë, ata që kanë luftuar, nuk e kanë bërë mend që vjen puna deri këtu, që sot bëhen negociatat dhe nuk flitet për Preshevën, Bujanovcin, Medvegjen, e në anën tjetër popullata prej andej dëbohet.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Zoti Thaçi e ka kërkuar fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari zoti Haliti! Unë dëshiroj edhe një herë që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të gjithë deputetëve të koalicionit qeverisës, por edhe të opozitës t'ju falënderoj për diskutimet tuaja. Gjithashtu, falënderoj edhe Grupin Parlamentar të LDK-së, që hyri me qëndrim kundër dialogut në fillim të seancës dhe ndryshoi gjatë procesit.

Në anën tjetër, falënderoj të gjithë diskutuesit për kontributin e tyre në mbështetje të agjendës për fqinjësi të mirë. I kuptoj edhe ata që janë plotësisht kundër apo që të ndërpritet ky dialog, sepse nuk janë negociata, por ky dialog ndërshtetëror në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Dëshiroj të theksoj edhe një herë me përgjegjësinë më të lartë kushtetuese dhe ligjore dhe askush të mos mendojë këtu se ky dialog është shpërblim për Qeverinë, por është një përgjegjësi e re shtetërore, prandaj Qeveria e Republikës së Kosovës, ju siguroj dhe garantoj, se do të punojë në përputhshmëri të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e saj, do të thotë me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës dhe do të respektojë në përpikëri vijat e kuqe që i ka prezantuar po në këtë Parlament, e që për hir të transparencës dhe përgjegjësisë shtetërore që e kemi, më lejoni t'i përsëris edhe një herë.

1. Parimet e pa negociueshme: Statusi i Kosovës është zgjidhur. Kosova është vend i pavarur, sovran dhe demokratik.
2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pa cenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pa ndashëm.
3. Rregullimi i brendshëm i vendit është kompetencë sovrane e institucioneve shtetërore.
4. Plani i Ahtisarit është platforma për rregullimin e të drejtave dhe garancive për komunitete.

Prandaj, unë ju ftoj të gjithë juve, deputetë të nderuar, që t'i mbështesni këto parime dhe këtë qëndrim që është i harmonizuar plotësisht në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe partnerëve e miqve tanë ndërkombëtarë, edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe me të gjitha vendet e Bashkimit Evropian dhe me NATO-n. Edhe një herë ju falënderoj shumë për mbështetje, për diskutimet. Natyrisht se shpreh keqardhjen për ndonjë devijim në diskutimet tona që i kemi pasur, por ky është Parlament dhe këtu zhvillojmë demokracinë e Kosovës. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Zoti Beqiri, e ka kërkuar fjalën në emër të LDK-së!

ISMET BEQIRI: I nderuari kryesues,

Unë po e përsëris atë që e thashë në fillim, edhe një herë kërkesën tonë që të hedhet në votim rekomandimi i tri grupeve parlamentare për pezullimin e këtyre bisedimeve dhe për mospranimin e tri konkluzave. Ky është propozim dhe kërkesë – rekomandim i tri grupeve parlamentare. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë kam për obligim që t'ju sqaroj që proceduralisht kërkesa është dashur të paraqitet bashkë me kërkesën për debat për t'u votuar dhe nuk është mirë që në fund të debatit të vijë një kërkesë e protokolluar në Kuvend. Megjithatë, e drejta e grupeve parlamentare për mocion është dhe unë e hedh në votim, së pari, a ta miratojmë kërkesën e tri grupeve parlamentare për ta futur në rend të ditës mocionin e dorëzuar pak më parë nga tri grupet parlamentare: Grupi Parlamentar i LDK-së; Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” dhe Grupi Parlamentar i AAK-së.

Si rregull, votohet “për”, domethënë ata që votojnë për propozimin, votojnë “për”, ata që votojnë kundër propozimit për ta futur në votim, votojnë “kundër”. Mirë, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Adem Grabovci e ka kërkuar fjalën!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Unë e kisha ndërmend pikërisht ta them atë për respektimin e procedurave të rregullta dhe mos të lejojmë që të futet asgjë në kontrabandë, sepse deri më tash ishin për respektim të rregullave të ligjeve, prandaj pikërisht këtë... Ndërsa Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është kundër futjes në rend të ditës, gjegjësisht në votim të këtij rekomandimi, që na propozohet këtu për këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gjini e ka kërkuar fjalën, në emër të AAK-së!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se Rregullorja e punës na lejon që propozimi i tri grupeve parlamentare për mocion të votohet menjëherë pas debatit përmbajtjesor, pas mocionit përmbajtjesor për shkak se kërkesa për këtë debat, kërkesa për këtë seancë është kërkuar goxha moti dhe gjithmonë grupet që e kërkojnë një mocion, do ta kenë edhe një propozim në fund seancës. Këtë e thotë Rregullorja e Kuvendit të Kosovës, kështu që nëse do të votojë Kuvendi kundër mocioni, le të votojë kundër mocionit, po nuk ka nevojë të votohet për ta qitur mocionin në votë. Kjo është praktikë e cila deri tani nuk ka ndodhur në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Jo, unë e di Rregulloren e Kuvendit dhe e kam lexuar nja dy-tri herë, po puna është që nuk ka ardhur mocioni në kohë dhe meqenëse nuk ka ardhur në kohë, tani është paraqitur mocioni në fund të seancës dhe ky mocion duhet të qitet në votim, a futet në rend dite a jo? Për mua është çështje krejt e re, nga ajo që është kërkuar debati. Kjo është. Atëherë, diskutim për këtë çështje nuk ka, propozimet tuaja janë të bëra me shkrim. E tha edhe zoti Beqiri. Unë po kërkoj që të votohet, të futet propozimi i të tri grupeve parlamentare në votim, si mocion, në fund të seancës, apo jo. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Nuk kalon mocioni, 46 vota “kundër”, 37 “për”, 2 “abstenime”.

Mirupafshim në seancën e ardhshme!

Përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë e Kuvendit të Kosovës